

**Vlerësimi Strategjik Mjedisor për përgatitjen e
“Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në
Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në
Shqipëri”**

- Studimi Përfundimtar i VSM -



25 Janar 2019

IU INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

Julius-Reiber-Strasse 17
64293 Darmstadt
Germany

www.iu-info.de

COWI

Parallevej 2
2800 Kongens Lyngby
Denmark

www.cowi.com

FLAG

Brigada 8, P. 6/2, K IV
Tirana
Albania

www.flag-ab.org



Vlerësimi Strategjik Mjedisor për "Studimin e Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri"

Studimi Përfundimtar i VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për "Studimin e Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri" është përgatitur në përputhje me legjislacionin shqiptar, veçanërisht bazuar në Ligjin 91/2013 për VSM dhe me kërkesat e legjislacionit europian për këtë lloj vlerësimi.

Studimi i VSM është përgatitur nga

INFRASTRUKTUR & UMWELT Professor Böhm und Partner
Julius-Reiber-Straße 17
64293 Darmstadt
Gjermani

Foundation for Local Autonomy and Governance (FLAG)
Rr. "Brigada 8", P. 6/2, K IV
Tiranë
Shqipëri

Me pjesëmarrjen e

Dr. Alfred Lako, i pajisur me Certifikatën mjedisore Nr. 136 Prot. datë 12.05.2005 me vendim Nr. 4, Nr. 127 Regj.

I bashkangjiten këtij raporti kopje të certifikatës mjedisore dhe të licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit.

Alfred Lako

Dr. Alfred Lako
Tiranë, 23 Janar 2019







**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 136 Prot.

Tirane, me 12.05. 2005

Vendimi Nr.4, Nr.127 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Alfred LAKO

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHqipërisë
Ministria e Tregëtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-7564-03-2014	NUIS/NIPT: K91424007C
Subjekti: Alfred Lako	
Adresa: Tiranë, TIRANË, Tiranë, Rruga Medar Shtylla, Pallati 142, Shkalla 4, Apartamenti 53, 50 metra përballë KMY	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 03/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
Nënkategoria	Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis
Veprimtari specifike	1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Auditim mjedisor. Vlerësim i ndikimit në mjedis.

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislativin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislativin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshtkrimi i sportelit:

Dajana *Stoja*



TABELA E PËRMBAJTJES

0	Përmbledhje jo-teknike	- 1 -
0.1	Hyrje si edhe Plani e Objektivat e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" (Plani i Investimeve MIMN)...	- 1 -
0.2	Baza mjedisore dhe problemet kyçe, përfshirë zhvillimin e mundshëm të mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN.....	- 2 -
0.3	Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm të ndikimeve mjedisore të Planit të Investimeve MIMN.....	- 10 -
1	Hyrje	1
1.1	Qëllimi i Studimit të VSM.....	1
1.2	"Studimi i Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta" (Plani i Investimeve MIMN) dhe konteksti i tij	2
1.2.1	Plani dhe objektivat e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta".....	2
1.2.2	Lidhja me Planet, Programet, Strategjitë dhe objektivat e tjera mjedisore	5
1.3	Aktivitete të zhvilluara për VSM.....	12
1.4	Fusha e Mbulimit e Studimit VSM	17
1.4.1	Shtirja gjeografike	17
1.4.2	Kohështrirja.....	17
1.4.3	Pjesët e Studimit të Sektorit që duhet të vlerësohen	18
1.4.4	Aspektet mjedisore kyçe që duhet të trajtohen në Studimin VSM	19
1.4.5	Burimet e të dhënave dhe shkalla e vlerësimit	20
2	Objektivat mjedisore, synimet dhe indikatorët.....	23
2.1	Objektivat mjedisore në Shqipëri.....	23
2.2	Marrja parasysh e objektivave mjedisore në procesin e planifikimit.....	25
3	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç, përfshi zhvillimin e mundshëm të mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN.....	26
3.1	Përshkrimi i zonës gjeografike dhe parashikimi i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve.....	26
3.1.1	Kushtet gjeografike	28
3.1.2	Popullsia dhe mbetjet.....	28
3.1.2.1	Parashikimi i popullsisë.....	28



3.1.2.2	Parashikimi i gjenerimit dhe grumbullimit të mbetjeve	29
3.1.2.3	Përbërja e mbetjeve	33
3.1.2.4	Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet/ Mbetjet inerte	33
3.2	Popullsia dhe shëndeti i njerëzve	33
3.2.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	33
3.2.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	37
3.3	Biodiversiteti, flora dhe fauna	39
3.3.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	39
3.3.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	42
3.4	Përdorimi i dheut dhe tokës si edhe asetëve materiale	43
3.4.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	43
3.4.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	45
3.5	Uji	45
3.5.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	45
3.5.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	47
3.6	Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	47
3.6.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	47
3.6.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	50
3.7	Peizazhi	51
3.7.1	Gjendja mjedisore dhe problemet kyç	51
3.7.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve	52
3.8	Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore	52
3.8.1	Gjendja mjedisore dhe probleme kyç	52
3.8.2	Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN	54
4	Vlerësimi i ndikimeve mjedisore	54
4.1	Vlerësimi i alternativave	54
4.2	Qasja metodike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	56
4.3	Profilët e VSM të masave të propozuara	58
4.3.1	Përcaktimi i Zonave të Mbetjeve	59
4.3.1.1	Justifikimi për përcaktimin e Zonave të Mbetjeve	59
4.3.1.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative	61
4.3.2	Komponentët rajonale të menaxhimit të mbetjeve	64
4.3.2.1	Transferimi dhe transporti në distancë të largët	64



4.3.2.1.1	Përshkrimi i teknologjisë	64
4.3.2.1.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	65
4.3.2.2	Trajtimi mekanik.....	67
4.3.2.2.1	Përshkrimi i teknologjisë	67
4.3.2.2.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	68
4.3.2.3	Trajtimi mekanik-biologjik (TMB, Rikuperimi i materialit dhe/ose energjisë).....	70
4.3.2.3.1	Përshkrimi i teknologjisë	70
4.3.2.3.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	71
4.3.2.4	Tretja anaerobike (Rikuperimi i materialit dhe energjisë).....	74
4.3.2.4.1	Përshkrimi i teknologjisë	74
4.3.2.4.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	74
4.3.2.5	Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)	76
4.3.2.5.1	Përshkrimi i teknologjisë	76
4.3.2.5.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	78
4.3.2.6	Vend depozitimi sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve)	79
4.3.2.6.1	Përshkrimi i teknologjisë	82
4.3.2.6.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	83
4.3.3	Komponentët vendorë të menaxhimit të mbetjeve.....	85
4.3.3.1	Pastrimi i rrugëve	85
4.3.3.1.1	Përshkrimi i teknologjisë	85
4.3.3.1.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	86
4.3.3.2	Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar).....	87
4.3.3.2.1	Përshkrimi i teknologjisë	87
4.3.3.2.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	88
4.3.3.3	Kompostimi (Rikuperim i materialit)	91
4.3.3.3.1	Përshkrimi i teknologjisë	92
4.3.3.3.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	93
4.3.3.4	Menaxhimi i mbetjeve inerte	95
4.3.3.4.1	Përshkrimi i teknologjisë	95
4.3.3.4.2	Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative.....	96
4.4	Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm të ndikimeve mjedisore të Planit të Investimeve MIMN.....	98



5	Monitorimi	102
6	Hapat e ardhshëm	102
7	Shtojcat	105
7.1	Shtojca 1: Përmbledhje ekzekutive e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri"	106
7.2	Shtojca 2: Raporti Hulumtues Përfundimtar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Përgatitjen e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri"	107



LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Faktet kyçe që lidhen me Planin e Investimeve MIMN.....	2
Tabela 2	Fazat e planit të investimeve.....	5
Tabela 3	Planet, programet dhe strategjitë përkatëse dhe objektivat e mbrojtjes mjedisore, lidhja e tyre me Planin e Investimeve MIMN dhe kërkesat/ objektivat kyç që rrjedhin prej tyre.....	7
Tabela 4	Aktivitetet e zhvilluara për VSM.....	14
Tabela 5	Elementët e Studimit të Sektorit që propozohen për vlerësim.....	18
Tabela 6	Komponentët mjedisorë dhe efektet e mundshme.....	19
Tabela 7	Burimet e të dhënave bazë dhe shkalla e vlerësimit.....	21
Tabela 8	Objektivat mjedisorë të VSM.....	24
Tabela 9	Parashikimi i popullsisë sipas qarqeve.....	28
Tabela 10	Sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit.....	29
Tabela 11	Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve sipas qarqeve.....	30
Tabela 12	Norma e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit.....	31
Tabela 13	Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve sipas qarqeve.....	32
Tabela 14	Përmbledhje e parashikimeve për gjenerimin dhe grumbullimin e mbetjeve.....	32
Tabela 15	Mangësitë mjedisore të sistemit të tanishëm MMN sa i përket popullsisë dhe shëndetit të njerëzve.....	37
Tabela 16	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket biodiversitetit, florës dhe faunës.....	42
Tabela 17	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket përdorimit të dheut dhe tokës.....	44
Tabela 18	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket ujit.....	46
Tabela 19	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket cilësisë së ajrit dhe faktorët klimatikë.....	50
Tabela 20	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual sa i përket peizazhit.....	51
Tabela 21	Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket peizazhit.....	54
Tabela 22	Alternativat e marra në konsideratë.....	55
Tabela 23	Masat e marra në konsideratë në profilet e VSM.....	57
Tabela 24	Klasifikimi i ndikimeve mjedisore.....	58
Tabela 25	Vlerësimi mjedisor për përcaktimin e zonave të mbetjeve.....	63



Tabela 26	Vlerësimi mjedisor për transferimin dhe transportin në distancë të largët të mbetjeve	66
Tabela 27	Vlerësimi mjedisor për trajtimin mekanik (IRM)	69
Tabela 28	Vlerësimi mjedisor për trajtimin mekanik-biologji (TMB).....	72
Tabela 29	Vlerësimi mjedisor për tretjen anaerobike	75
Tabela 30	Vlerësimi mjedisor për incinerimin e mbetjeve (me rikuperim energjie)	78
Tabela 31	Vlerësimi mjedisor për vend depozitimin sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve).....	83
Tabela 32	Vlerësimi mjedisor për pastrimin e rrugëve	86
Tabela 33	Vlerësimi mjedisor për grumbullimin e mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)	89
Tabela 34	Vlerësimi mjedisor për kompostimin (rikuperimi i materialit)	94
Tabela 35	Vlerësimi mjedisor për menaxhimin e mbetjeve inerte	97
Tabela 36	Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm mjedisor	99
Tabela 37	Parashikimi i përgatitjes së Planit të Investimeve MIMN dhe statet kryesore të VSM	104



LISTA E FIGURAVE

Figura 1	Fazat dhe raportet e Studimit të Sektorit.....	4
Figura 2	Qasja bazë dhe hapat e punës për Studimin VSM.....	13
Figura 3	Pamje e Shqipërisë me rajonet administrative (qarqet).....	27
Figura 4	Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri (%).....	33
Figura 5	Mbetje të hedhura të pakontrolluara që përhapen në anët e rrugës (majtas), kontenier mbetjesh i dëmtuar dhe mbetje të përhapura që digjen (djathtas).....	35
Figura 6	Shembuj të vendgrumbullimeve në dy qytete kryesore shqiptare: vendgrumbullimi i mbetjeve i qytetit të Beratit i ndodhur në lumin Osum (majtas), vendgrumbullimi i qytetit të Vlorës me lëngun kullues të mbetjeve dhe endjen e lirë të derrave (djathtas).....	36
Figura 7	Harta e zonave të mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri.....	41
Figura 8	Mbulimi i tokës shqiptare në 2012 [% e totalit].....	44
Figura 9	Përqendrimi mesatar i SO ₂ , NO ₂ , O ₃ dhe PM 10 në Shqipëri krahasuar me vlerat limit të rekomanduara nga OBSH dhe ato të caktuara nga BE [2016].....	48
Figura 10	Përqendrimi mesatar vjetor i PM 10 në disa qytete të përzgjedhura [2016].....	49
Figura 11	Emetimet CO ₂ eq. nga të gjithë sektorët ekonomikë për vitin 2005 [%].....	50
Figura 12	Vendet (sitet) e trashëgimisë botërore të UNESCO-s në Shqipëri (majtas: Butrinti, në mes: Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, djathtas: Pyjet e Ahut Primar të Karpateve).....	53
Figura 13	Zonat e ardhshme të mbetjeve.....	60
Figura 14	Skema bazë e Instrumentit për Planifikimin e Investimeve MIMN.....	63
Figura 15	Parimet e ngarkimit të drejtpërdrejtë me dhe pa ngjeshje në stacionet e transferimit.....	65
Figura 16	Elementët e IRM: Bunkerit/ hapësi i qeseve, ndarja me dorë, sita, presa.....	68
Figura 17	Hapat e procesit dhe produktet e impianteve të TMB.....	71
Figura 18	Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve.....	77
Figura 19	Shtresat e sistemit izolues fundor të vend depozitimit sipas standardeve të BE.....	82



Figura 20	Shembuj të pastrimit të rrugëve në mënyrë manuale (majtas) dhe mekanike (djathtas).....	85
Figura 21	Shembuj të koshave me rrota që përdoren për grumbullimin derë-mëderë (majtas) dhe kontenerët për grumbullim kolektiv në Maliq / Shqipëri (djathtas).....	88
Figura 22	Shembull i një impianti kompostimi me ajrosje artificiale: materiali i sjellë, mbushja e kontenerëve me ajrosje, kompostimi në kontenerë, komposti i situar.....	93
Figura 23	Shembull i një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP.....	96



SHKURTIME

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BE	Bashkimi Europian
cap	person
CO ₂	dioksid karboni
d	ditë
DeNOx	Denitrifikim
Direktiva IM	Direktiva për incinerimin e mbetjeve
DLDP	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor
eq.	ekuivalent
FLAG	Fondacioni Shqiptar për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
MBB	Mbetje bashkiake të biodegradueshme
MNP	Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet
VKM	Vendimet e Këshillit të Ministrave
KE	Komisioni Europian
GDP	Prodhimi i brendshëm bruto
GHG	gazi serrë
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH)
GNP	Prodhimi kombëtar bruto
HEC	Hidrocentral
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPPCD	Direktiva për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
IRM	Impiant për rikuperimin e materialit



IU	INFRASTRUKTUR & UMWELT
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (KfW Entwicklungsbank)
kg	kilogram
LDPM	Lëndë djegëse me prejardhje nga mbetjet
Mg	Megagram, ton
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
MM	Menaxhimi i mbetjeve
MMN	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta
MNB	mbetje të ngurta bashkiake
MPEE	Mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NO ₂	dioksid azoti
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
O ₃	ozon
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OJQ	Organizata jo-qeveritare
PM	lëndë e grimtuar
PPS	Plane, Programe dhe Strategji
PRTR	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
RGJM	Raporti i Gjendjes së Mjedisit
RTO	oksidimi termik rigjenerues
SCR	reduktimi selektiv katalitik
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim
SO ₂	dioksid sulfuri
t	ton
TA	Tretje anaerobike
TMB	Trajtim mekanik-biologjik
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën



UTS	Universiteti i Teknologjisë, Sidnej
v	vit
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
WID	Të dhënat botërore mbi pabarazinë
ZeM	Zona e mbetjeve
ZM	Zonat e mbrojtura



0 Përmbledhje jo-teknike

0.1 Hyrje si edhe Plani e Objektivat e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" (Plani i Investimeve MIMN)

Vitet e fundit, ka patur përparime të konsiderueshme në Shqipëri lidhur me hartimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Europian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë zbatimi në nivel rajonal apo vendor dhe arritja e objektivave të rëna dakord ka mbetur prapa. Pika kyçe midis planifikimit dhe zbatimit është gjendja/ kapaciteti i mjaftueshëm i burimeve. Rrjedhimisht, objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN,
- të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura,
- të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm prioritetesh për investimet në infrastrukturën e MIMN,
- të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si edhe impiantet e trajtimit dhe/ose depozitimit të mbetjeve,
- të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale,
- të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Studimi i Sektorit udhëhiqet nga objektivat e Sektorit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta (MMN), përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve në gjithë vendin, reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, uljen e numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike, si edhe mbrojtjen e mjedisit.

Pjesa kryesore e Studimit të Sektorit është një Plan Investimesh MIMN i ndarë në faza, i cili u jep mundësinë autoriteteve të marrin vendimet e duhura¹ duke marrë në konsideratë zhvillimet afatgjata. Fazat e planit të investimeve janë përcaktuar siç tregohen në tabelën e mëposhtme.

¹ Vendimarrja mbështetet nga një Instrument për Planifikimin e Investimeve MIMN në format Excel dhe baza e të dhënave GIS.

Fazat e planit të investimeve

Faza	Periudha
Faza 1 (afatshkurtër)	2018 – 2022
Faza 2 (afatmesme)	2023 – 2027
Faza 3 (afatgjatë)	2028 – 2032

Përmbledhja ekzekutive e Studimit të Sektorit është përfshirë në kapitullin 7.1 si Shtojca 1.

0.2 Baza mjedisore dhe problemet kyçe, përfshirë zhvillimin e mundshëm të mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Baza mjedisore dhe problemet kyçe

Shqipëria zë një sipërfaqe prej 28,748 km². Vija bregdetare e vendit përgjatë deteve Adriatik dhe Jon ka një gjatësi prej 362 km. Shqipëria kufizohet me Malin e Zi, Kosovën, Greqinë dhe Maqedoninë.

Rreth gjysmën e territorit shqiptar e zënë zonat malore. Një pjesë e vogël e tyre janë rajone të larta malore. Nga liqeni i Shkodrës në veri deri në Vlorë në jug, shtrihen toka aluviale vetëm pak kilometra të gjera përgjatë bregdetit, të cilat në Shqipërinë qendrore zgjerohen për të formuar fushën e madhe të Myzeqesë. Në bregdet ka një numër lagunash dhe ligatinash.

Vetëm luginat, kodrat, disa pjesë të fushave bregdetare dhe disa pllaja lejojnë përqendrimin e zonave të banuara. Aty, dendësia e popullsisë është relativisht e lartë, ndërkohë që pjesë të tjera të vendit janë pak të populluara.

Shumica e popullsisë shqiptare jeton në qytete. Qytetet më të mëdha shqiptare ndodhen në ultësirën perëndimore bregdetare. Ato janë rritur në mënyrë domethënëse në dekadat e fundit, ndërsa vendbanimet më të vogla i kanë humbur banorët. Veçanërisht Tirana është zgjeruar në mënyrë drastike dhe sot formon një zonë metropolitane së bashku me periferitë e saj dhe me qytetin e Durrësit.

Të dhënat për popullsinë dhe zhvillimin e popullsisë janë baza për llogaritjen e sasive aktuale dhe të ardhshme të mbetjeve, si për mbetjet e gjeneruara edhe për ato të grumbulluara. Këto më pas formojnë bazën për planifikimin e sistemeve të qendrueshme të përshtatura të menaxhimit të mbetjeve të ngurta.



Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e numrit të popullsisë sipas qarqeve, duke treguar popullsinë e supozuar për 2018 si edhe për vitet e fundit të Fazave 1 – 3.²

Parashikimi i popullsisë sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i popullsisë			
	2018	2022	2027	2032
Berat	159,629	151,851	143,087	135,283
Dibër	139,090	131,304	122,467	114,525
Durrës	334,298	348,156	366,324	385,480
Elbasan	329,358	321,261	311,871	303,252
Fier	360,686	354,527	347,408	340,909
Gjirokastrë	90,379	85,687	80,846	77,101
Korçë	253,456	245,634	236,438	227,849
Kukës	87,290	83,206	78,524	74,272
Lezhë	155,560	152,568	149,150	146,072
Shkodër	245,350	239,796	233,491	227,859
Tiranë	944,494	1,007,636	1,092,782	1,185,418
Vlorë	247,774	250,328	254,065	258,418
SHQIPËRIA	3,347,364	3,371,954	3,416,451	3,476,438

Në tabelën e mëposhtme, jepet në mënyrë të përmblodhur parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në nivel qarku duke pasur si referencë të njëjtët vite si në parashikimin e popullsisë.³



² Shqipëria ka disa burime zyrtare që japin të dhëna mbi popullsinë. Të dhënat më të përdorura janë ato nga INSTAT (bazuar në Census) dhe nga Zyra e Gjendjes Civile; megjithatë, shifrat e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Të dhënat e popullsisë nga Zyra e Gjendjes Civile në përgjithësi janë shumë më të larta sesa shifrat sipas INSTAT. Për këtë arsye, Ministria e Financave e Shqipërisë ka krijuar një faktor korrigjimi, i cili është përdorur për të llogaritur numrin e popullsisë bazuar në të dhënat e të djave, si të INSTAT edhe të Zyrës së Gjendjes Civile: $Census + (Gjendja Civile - Census) * 30\%$.

³ Bazuar në parashikimin e popullsisë dhe të sasive të supozuara specifike të mbetjeve që gjenerohen në tipe të ndryshme vendbanimesh është llogaritur sasia e mbetjeve që pritet të gjenerohet gjatë periudhës së projektit.

Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve [Mg/v]			
	2018	2022	2027	2032
Berat	39,503	37,616	35,491	33,601
Dibër	26,585	25,097	23,408	21,891
Durrës	105,626	110,081	115,924	122,088
Elbasan	76,175	74,350	72,239	70,309
Fier	84,624	83,197	81,549	80,046
Gjirokastrë	21,376	20,263	19,102	18,184
Korçë	62,575	60,733	58,571	56,558
Kukës	18,178	17,322	16,340	15,449
Lezhë	35,864	35,182	34,403	33,704
Shkodër	62,307	60,910	59,325	57,911
Tiranë	334,049	356,517	386,815	419,778
Vlorë	73,512	74,551	76,005	77,641
SHQIPËRIA	940,376	955,819	979,173	1,007,159


Tabela e mëposhtme tregon parashikimin për sasi të grumbulluara të mbetjeve në nivel qarku, duke iu referuar të njëjtëve vite si në parashikimet e popullsisë dhe të gjenerimit të mbetjeve.⁴

⁴ Në Shqipëri, sasi të mbetjeve të grumbulluara ndryshojnë nga sasi të që janë gjeneruar, sepse shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk i mbulojnë të gjitha zonat, sidomos në zonat bujqësore. Për këtë arsye, për parashikimin e sasive të grumbulluara të mbetjeve, nivelet e grumbullimit të mbetjeve janë supozuar sipas tipit të vendbanimit. Përveç kësaj, mbulimi me shërbim pritet të rritet çdo vit me 3 % në zonat bujqësore dhe me 1% në zonat e tjera.

Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve sipas qarqeve

Qarku	Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve			
	2018	2022	2027	2032
	[t/v]	[t/v]	[t/v]	[t/v]
Berat	26,516	28,010	29,679	30,874
Dibër	15,212	16,627	18,151	19,263
Durrës	84,703	92,839	103,772	115,614
Elbasan	49,120	53,542	58,817	63,430
Fier	54,557	59,809	66,187	71,992
Gjirokastrë	14,674	15,398	16,269	16,934
Korçë	42,391	45,418	48,941	51,828
Kukës	11,114	11,968	12,915	13,678
Lezhë	24,016	26,495	29,500	31,768
Shkodër	42,490	45,847	49,899	53,348
Tiranë	278,345	312,167	359,150	411,808
Vlorë	54,544	59,603	66,147	72,659
SHQIPËRIA	697,681	767,723	859,428	953,196

Për përbërjen e mbetjeve është supozuar kompozimi siç tregohet në grafikun më poshtë.



Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri (%)

Shqipëria ka një biodiversitet të pasur dhe në të njëjtën kohë përballet me një sërë problemesh mjedisore, përfshi mbipërdorimin e kullotave, prerjet e paligjshme, gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm. Shqipëria bën pjesë në Brezin e Gjelbër të Europës dhe shtrihet në Zembrën Blu të Europës.

Vendi ndodhet në një rajon të pasur në specie, i cili kryesisht karakterizohet nga një florë e pasur me më shumë se 3,200 specie. Nga këto, më shumë se 15 % janë endemike në Gadishullin e Ballkanit dhe rreth 40 specie gjenden vetëm në Shqipëri. Në veçanti janë tipike pyjet e dushkut që përbëjnë një të pestën e pyjeve shqiptare.

Duke pasur shumë zona të pazhvilluara, vendi ofron habitate për një shumëllojshmëri specimesh të rralla shpendësh dhe kafshë të tjera, si ujku, rrëqebulli, dhelpra dhe madje ariu i murrmë. Shqipëria ka më shumë se 350 specie shpendësh vendase. Ligatinat në bregdet dhe liqenet janë ndalesa të rëndësishme për shumë shpendë migrues. Në trupat ujorë të Shqipërisë ka rreth 260 specie peshqish të ujërave të kripura dhe të ëmbla, si edhe breshka. Megjithatë, biodiversiteti ka pësuar rënie në Shqipëri gjatë dekadave të fundit.

Në Shqipëri ka 14 parqe kombëtare, që zënë rreth 6.9% të territorit të vendit dhe rezerva detare Karaburun-Sazan. Parqet janë strehë për shumë bimë dhe kafshë dhe përmbajnë peizazhe të virgjëra. Disa parqe kombëtare janë destinacione të njohura turistike.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në Shqipëri. Rreth një çerek e sipërfaqes totale të vendit mund të përdoret për bujqësi. Megjithatë, cilësia e tokës është e ndryshme sipas zonave dhe vendndodhjeve. Dominon blegtoaria.

Aktivitetet bujqësore kontribuojnë në mënyrë domethënëse në GDP shqiptare. Më shumë se gjysma e popullsisë aktive për punë është e angazhuar në bujqësi, por më shumë kultivimi shërben si mjet jetese.

Shqipëria ka shumë lëndë të para/ burime minerare: Kromi është një nga lëndët e para më të rëndësishme të vendit. Përveç tij, ka depozita të mëdha nikeli, bakri, qymyrguri, gipsi, guri gëlqeror, torfe, bazalti, gur shtufi dhe argjile. Megjithatë shumë nga këto lëndë të para nxirren rrallë. Shqipëria ka po ashtu burime gazi dhe naftë shumë pak të zbuluara.

Të gjithë lumenjtë kryesorë të Shqipërisë derdhen në detin Adriatik. Drini është lumi më i gjatë i vendit me një gjatësi prej 282 km. Lumenj të tjerë kryesorë janë Mati, Shkumbini, Semani me Devollin dhe Vjosa. Lumi i shkurtër i Bunës derdh ujën e liqenit të Shkodrës në detin Adriatik dhe formon një pjesë të kufirit me Malin e Zi.

Në Shqipëri, ka një klimë mesdhetare me një temperaturë mesatare vjetore prej 16°C dhe rreshje vjetore prej më pak se 1,200 mm. Dimri është i ashpër në rajonet malore veriore dhe lindore. Në dimër, shumë vende në këto zona janë të izoluar nga bota e jashtme për muaj të tërë për shkak të dëborës. Në jug pranë detit Jon, klima është shumë më e butë. Gjithsesi, edhe në rajonet bregdetare rreshjet janë relativisht të larta në dimër.



Arkitektura shqiptare është e pasur me kontraste. Aty ku mund të ruheshin qendrat historike të qyteteve, janë ruajtur arritjet arkitekturore nga kohët otomane dhe veneciane. Qytetet shqiptare jugore të Beratit dhe Gjirokastrës janë shpallur si Vende të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s falë arkitekturës së tyre që daton nga epoka otomane. Forma shumë arkaike të arkitekturës (si p.sh. kalatë dhe sidomos rrënojat e kalave) mund të gjenden veçanërisht në rajonet malore.

Shqipëria konsiderohet si një nga vendet me ndotjen më të madhe në Europë. Emetimet dhe vendet e kontaminuara ndotin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokën dhe ajrin, sidomos në zonat më të populluara. Ndër të tjera, kjo vjen edhe për shkak të grumbullimit të papërshtatshëm të mbetjeve dhe hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve në natyrë.

Teksa qendrat e qyteteve përgjithësisht paraqiten të pastra, përgjatë rrugëve dhe në periferi shpesh shikon mbeturina të shpërndara, pirgje të grumbulluara mbetjesh dhe sidomos rrënoja nga prishjet e ndërtesave. Arsytet për këtë situatë të pakënaqshme, sidomos jashtë qendrave kryesore, janë të shumëfishta. Bashkitë i referohen mungesës së financimit si arsye kryesore për nivelin e dobët të grumbullimit të mbetjeve. Gjithashtu, shpesh ka vonesa në pagesat e kontraktorëve privatë për shkak të mungesës së fondeve,⁵ gjë e cila ndikon në mënyrë negative motivimin e kompanive të kontraktuara për ta kryer siç duhet punën e tyre.

Ndikimet mjedisore të sistemit të tanishëm MMN në Shqipëri janë përshkruar në mënyrë kualitative në tabelën e mëposhtme lidhur me aktivitetet të ndryshme MMN.

Mangësi mjedisore dhe sociale të sistemit të tanishëm MMN

Tema	Mangësi mjedisore dhe sociale
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Përhapja e mbetjeve dhe depozitimi i parregullt sidomos në zonat që deri tani nuk përfitojnë shërbim nga sistemi i grumbullimit të mbetjeve ndikojnë negativisht situatën higjienike në zonat përkatëse Përhapja e mbetjeve dhe depozitimi i parregullt ndotin tokën, ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, si edhe peizazhin (përfshi ndikimin negativ në turizëm) Mbetjet merren nga ujërat e lumit, shkaktojnë bllokime dhe në fund grumbullohen në det Përdorimi i ujit të kontaminuar sipërfaqësor apo nëntokësor si ujë të pijshëm ose ujë për vaditje shkakon futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njeriut dhe/ose kafshëve

⁵ Komisioni i Komuniteteve Europiane, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë, Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL: Strategjia Kombëtare Shqiptare e Mbetjeve; Prill 2010; p. 28

Tema	Mangësi mjedisore dhe sociale
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i burimeve natyrore • Ndikimi negativ në klimë (potenciali për të shmangur emetimet e gazrave serrë nëpërmjet riciklimit, emetimet e metanit nga mbetjet organike) • Sasi më të mëdha mbetjesh për t'u depozituar
Depozitimi në vendgrumbullime të menaxhuara keq ose të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> • Emetimet e gazit metan nga vend depozitimet dhe vendgrumbullimet e mbetjeve (emetimet e gazit serrë) • Emetimet e lëngut kullues nga vend depozitimet ndotin tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore (me ndotës organikë të qëndrueshëm dhe komponentë të tjerë organikë, metale të rënda dhe kripërat e tyre) • Tërheqja e vektorëve që mund të transmetojnë sëmundje tek njeriu dhe kafshët • Emetimet e pluhurit dhe aromave të rënda që ndikojnë receptorët e ndjeshëm në afërsi • Pjesët e lehta të mbetjeve të depozituara që ngrihen nga era dhe ndotin zonat përreth • Zjarret në vend depozitim shkaktojnë ndotje të ajrit si pasojë e djegies të paplotë (formimi i substancave toksike) • Ndotja dhe ndikimi shëndetësor nga depozitimi jo i duhur i mbetjeve të rrezikshme dhe infektive • Veprimtari informale për ndarjen e mbetjeve në kushte pune shumë të këqija • Në mungesë të një rrethimi dhe porte, hyrja e kafshëve shtëpiake që ushqehen me lëndën e mbetjeve (përfshirë letrën dhe plastikën) • Kundërvënie të mëtejshme që lidhen me përzgjedhjen jo të mirë të vendeve për të kryer depozitimin e mbetjeve

Në përgjithësi mund të thuhet se depozitimi jo i duhur i mbetjeve është problemi mjedisor më serioz i menaxhimit aktual të mbetjeve në Shqipëri. Problemet kryesore kanë të bëjnë me përzgjedhjen e gabuar të vendeve (p.sh. në shtretërit e lumenjve, brenda qendrave të banuara), me mungesën e masave për të kufizuar emetimet (p.sh. nuk mbulohen, digjen), me hedhjen e mbetjeve nëpër lumenj dhe burime të rëndësishme ujore, përdorimi i keq i vendgrumbullimeve, aty ku ekzistojnë të tillë (nuk ka buxhet, nuk ka pajisje). Edhe atje ku bashkitë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, situata e vendgrumbullimeve në shumicën e rasteve neglizhohet. Përveç fondeve të pakta, mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit tek popullsia dhe tek vendimmarrësit duket se është një arsye e rëndësishme për këtë neglizhencë. Madje edhe në disa vend depozitime të ndërtuar sipas standardeve të vend depozitimeve sanitare, funksionimi nuk

bëhet në përputhje me standardet e direktivës së BE për vend depozitimet, duke humbur për pasojë përfitimet nga investimi i kryer.

Për më tepër, ndotja nga vendgrumbullimet e mbetjeve mbetet një rrezik mjedisor madhor në vend, edhe pas mbylljes së tyre. Megjithëse rehabilitimi mund të reduktojë në mënyrë thelbësore ndotjen mjedisore dhe janë përgatitur studime fizibiliteti të ndryshme, zbatimi aktual i masave të propozuara në shumicën e rasteve ka mbetur pezull. Një inventar i plotë i vendgrumbullimeve mbahet nga MIE. Ndërsa MTM së bashku me DLDP po kujdeset për masat e investimit për rehabilitimin e vendgrumbullimeve të mbetjeve.

Zhvillimi i mundshëm mjedisor pa Planin e Investimeve MIMN

Meqë nuk ka grumbullim, trajtim dhe depozitim modern gjithëpërfshirës dhe mbarëkombëtar të mbetjeve në Shqipëri, pasojat për higjienën publike, shëndetin publik dhe mjedisin janë serioze. Nëpërmjet parandalimit, rikuperimit dhe përmirësimit të depozitimit të mbetjeve, kursehen burime dhe energji dhe reduktohet emetimi i gazrave serrë.

Shqipëria kërkon të anëtarësohet në BE dhe për rrjedhojë është në procesin e adoptimit të standardeve të BE si standarde kombëtare. Për këtë arsye, për Qeverinë Shqiptare ka prioritet të lartë realizimi i grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve në mënyrë të sigurt higjienike, të mundur ekonomikisht dhe miqësore ndaj mjedisit. Për ta përshpejtuar procesin, Shqipëria kërkon mbështetje nga donatorë ndërkombëtarë.

Rrjedhimisht mund të supozohet se edhe pa Planin e Investimeve MIMN, menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri do të vazhdonte të zhvillohej dhe të modernizohej. Gjithsesi, nëpërmjet hartimit të Planit të Investimeve MIMN do të vendoset një bashkërendim i ngushtë i investimeve afatgjata dhe planifikimit për financime midis Qeverisë Shqiptare, njësisive të qeverisjes vendore dhe donatorëve, çka do të lejojë monitorimin e investimeve dhe financimit afatgjatë.

Në këtë drejtim Plani i Investimeve synon të eliminojë investimet spontane, të cilat nuk janë të bazuara në studime, apo nuk janë të miratuara nga politikëbërësit, në mënyrë që të parandalohet përdorimi i fondeve publike në mënyrë jo efektive dhe krijimi i pikave të prehta mjedisore që do të kërkonin akoma më tepër fonde dhe burime për t'u kthyer në kushte të pranueshme normale. Plani i Investimeve MIMN synon të garantojë zhvillimin e një sistemi kombëtar dhe realist për MIMN, i cili të përditësohet rregullisht.

Pa këtë plan, ekziston një risk që investimet të mos bashkërendohen në nivel kombëtar dhe/ ose të mos bazohen në financim të qëndrueshëm. Për pasojë, risqet e përshkruar



më sipër do të vijonin të ekzistonin ose nuk do të mund të përjashtoheshin në term afatgjatë.


0.3 Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm të ndikimeve mjedisore të Planit të Investimeve MIMN

Për gjithë Shqipërinë, janë përcaktuar zonat e mbetjeve në mënyrë që secila bashki t'i caktohet një impianti rajonal specifik për menaxhimin e mbetjeve.

Aspektet thelbësore për përcaktimin e zonave të mbetjeve ishin struktura hapësinore dhe mundësia e qarkullimit, numri i popullsisë dhe zhvillimi i saj, sasi të mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara. Sasia gjithsej e mbetjeve që do të grumbullohen dhe do të dorëzohen në një impiant MMN brenda zonës së mbetjeve duhet të jetë në masën 100 Mg/d për të siguruar funksionimin e tij ekonomik.

Bazuar në këto konsiderata, në Shqipëri janë përcaktuar kufijtë e dhjetë zonave të mbetjeve, siç tregohen në figurën e mëposhtme.





Zonat e ardhshme të mbetjeve

Identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor është kryer bazuar në profilet e VSM për masat e përzgjedhura. Ndikimet dhe rëndësia e tyre paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Përmbledhje e vlerësimit mjedisor të përgjithshëm

Lloji i masave/ shkurtime	Përshkrimi	Vlerësimi mjedisor i përgjithshëm
ZeM	Ndarja e Zonave të Mbetjeve	+
R	Komponentët rajonalë të menaxhimit të mbetjeve	
R01	Transferimi dhe transporti në distancë të largët i mbetjeve	
R01-01	Stacion transferimi me rampë	+
R01-02	Stacion transferimi me rampë dhe njësi kompaktore	++
R02	Trajtimi mekanik (IRM)	
R02-01	IRM e papastër (mbetje të përziera)	+
R02-02	IRM e pastër (mbetje të riciklueshme të ndara)	++
R03	Trajtimi mekanik-biologjik (TMB)	
R03-01	TMB me tretje anaerobike	++
R03-02	TMB me stabilizim	++
R03-03	TMB me kompostim	0
R04	Tretje anaerobike	++
R05	Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)	
R05-01	Incinerim me skarë të lëvizshme	0
R06	Vend depozitim sanitar (depozitim i sigurt i mbetjeve)	
R06-01	Vend depozitim sanitar	0
R06-02	Rehabilitimi i vend depozitimeve	+
L	Komponentët lokalë të menaxhimit të mbetjeve	
L01	Pastrimi i rrugëve	
L01-01	Fshirja manuale e rrugëve	++
L01-02	Fshirja mekanike e rrugëve	+
L02	Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)	
L02-01	Grumbullimi i mbetjeve të përziera	+
L02-02	Grumbullimi i mbetjeve organike	+
L02-03	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata	++
L03	Kompostimi (rikuperim material)	



Lloji i masave/ shkurtime	Përshkrimi	Vlerësimi mjedisor i përgjithshëm
L03-01	Impiant kompostimi në kavaleta	+
L03-02	Impiant i mbyllur i automatizuar plotësisht	++
L04	Menaxhimi i mbetjeve inerte	
L04-01	Trajtimi me pajisje të lëvizshme	+
L04-02	Trajtimi me pajisje stacionare	++
L04-03	Depozitimi i mbetjeve	0

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, masat e Planit të Investimeve MIMN kanë një ndikim pozitiv ose jo domethënës në shumicën e temave të mbrojtjes së VSM. Megjithatë, masat nuk mund të vlerësohen vetëm të veçanta, por duhet të marrim parasysh edhe ndërveprimet sistemike në një sistem të integruar të MIMN.

Gjithashtu, përzgjedhja e vendndodhjeve luan një rol të rëndësishëm, veçanërisht në zbatimin e komponentëve rajonalë të menaxhimit të mbetjeve. Një përzgjedhje e detajuar e vendndodhjeve duhet të kryhet rrjedhimisht si pjesë e planifikimit dytësor dhe procedurave të miratimit, gjithashtu duke marrë në konsideratë ndikimet mjedisore përkatëse.



1 Hyrje

Banka Gjermane për Zhvillim KfW Entwicklungsbank e mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të përmirësuar gjendjen e menaxhimit të mbetjeve në vend. Ndër të tjera është rënë dakord të përgatitet një "Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri", i quajtur ndryshe Plani i Investimeve MIMN. Partneri shqiptar i Projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Në kuadër të hartimit të Planit të Investimeve MIMN do të përgatitet një Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM).

INFRASTRUKTUR & UMWELT si Konsulent udhëheqës në bashkëpunim me COWI dhe FLAG është ngarkuar me zbatimin e shërbimeve të konsulencës për VSM.^o

1.1 Qëllimi i Studimit të VSM

Si pjesë të përgatitjes së Planit të Investimeve MIMN, MIE është duke kryer një VSM për të marrë parasysh ndikimet e mundshme mjedisore të tij. VSM synon

- Të integrojë faktorët mjedisorë në përgatitjen e Planit të Investimeve MIMN
- Të përmirësojë Planin e Investimeve MIMN dhe të forcojë mbrojtjen mjedisore
- Të rritë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe
- Të lehtësojë hapjen dhe transparencën e vendimmarrjes.

Qëllimi i Raportit Mjedisor është

- Të japë informacion rreth Planit të Investimeve MIMN;
- Të identifikojë, përshkruajë dhe të vlerësojë efektet e mundshme domethënëse të Planit të Investimeve MIMN dhe alternativat e tij të arsyeshme;
- T'u japë një mundësi paraprake dhe efektive Autoriteteve të Konsultimit dhe publikut për të dhënë mendime rreth çdo aspekti të këtij Raporti Mjedisor.

Faktet kyçe që lidhen me Planin e Investimeve MIMN parashtrohen në tabelën e mëposhtme.

^o Legjislacioni përkatës për VSM shpjegohet në kapitullin 1.1 të Raportit Hulumtues. Raporti Hulumtues është bashkangjitur në kapitullin 7.2 si Shtojca 2.



Tabela 1 Faktet kyçe që lidhen me Planin e Investimeve MIMN

Emërtimi i autoritetit përgjegjës	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)
Titulli i planit	"Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Shqipëri (Plani i Investimeve MIMN)"
Informacion i përgjithshëm	Plani i Investimeve MIMN udhëhiqet nga politikat kombëtare shqiptare të sektorit MMN, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të qendrueshme MMN në të gjithë vendin, për reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, reduktimin e numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike, si edhe për mbrojtjen e mjedisit.
Tema	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake
Kohëzgjatja	Fazat e Planit të Investimeve MIMN janë si më poshtë <ul style="list-style-type: none"> • Faza 1 (afatshkurtër): 2018 – 2022 • Faza 2 (afatmesme): 2023 – 2027 • Faza 3 (afatgjatë): 2028 – 2032
Zona e mbulimit	Shqipëria
Qëllimi dhe/ose objektivat	Objektivat specifike të Planit të Investimeve MIMN janë: <ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN në Shqipëri • Të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura • Të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm prioritetesh për investimet në infrastrukturën e MIMN • Të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si edhe impiantet e trajtimit dhe/ ose depozitimit të mbetjeve • Të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale • Të propozojë masa të tjera shoqëruese

1.2 "Studimi i Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta" (Plani i Investimeve MIMN) dhe konteksti i tij

Qëllimi i kësaj pjese të raportit është të shpjegojë natyrën, përmbajtjen, objektivat dhe afatet kohore të Planit të Investimeve MIMN.

1.2.1 Plani dhe objektivat e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta"

Vitet e fundit ka pasur arritje të konsiderueshme në Shqipëri lidhur me hartimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Europian (EU) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë zbatimi në nivel rajonal ose vendor dhe arritja e synimeve për të cilat është rënë dakord ka mbetur prapa. Pika më e rëndësishme midis planifikimit dhe



zbatimit është gjendja/ kapacitetet e mjaftueshme të burimeve. Ndaj objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin MMN,
- të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura,
- të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm prioritetesh për investimet në infrastrukturën e MIMN,
- të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë në faza afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin, si edhe impiantet e trajtimit dhe/ose depozitimit të mbetjeve,
- të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale,
- të propozojë masa të tjera shoqëruese.

Studimi i Sektorit udhëhiqet nga objektivat kombëtare të sektorit MMN, përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të qendrueshme MMN në të gjithë vendin, për reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, reduktimin e numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike, si edhe për mbrojtjen e mjedisit

Figura e mëposhtme tregon hapat kryesore të punës për Studimin e Sektorit, si edhe raportet e projektit që janë dorëzuar në fund të secilës fazë përkatëse.






Figura 1 Fazat dhe raportet e Studimit të Sektorit

Dokumenti strategjik që duhet t'i nënshtrohet VSM është rezultat i Fazës Përfundimtare të Studimit të Sektorit. Ai bashkon rezultatet e fazave të mëparshme. Pjesa kryesore e Studimit të Sektorit është një plan investimi i ndarë në faza, i cili u jep mundësinë



atuoriteteve të marrin vendime të sigurta në lidhje me zhvillime afatgjata. Fazat e planit të investimeve janë përcaktuar siç tregohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2 Fazat e planit të investimeve

Faza	Periudha
Faza 1 (afatshkurtër)	2018 – 2022
Faza 2 (afatmesme)	2023 – 2027
Faza 3 (afatgjatë)	2028 – 2032

Përmbledhja ekzekutive e Studimit të Sektorit është përfshirë në kapitullin 7.1 si Shtojca 1.

1.2.2 Kuadri Rregullator dhe i Politikave për MMN në Shqipëri

1.2.2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar për mjedisin në përgjithësi dhe për menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka përparuar nëpërmjet transpozimit të direktivave të BE në legjislacionin e vendit. Vendi ka arritur progres të konsiderueshëm në pak vitet e fundit në përafrimin ligjor. Kuadri është forcuar dhe është përmirësuar bashkërendimi i politikave në nivel qendror.

Në Shqipëri, legjislacioni përbëhet nga ligjet e krijuara nga Parlamenti, Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM), Udhëzimet dhe Rregulloret e ministrive. Me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve janë ligjet e mëposhtme:

- Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
- Ligji për Vetëqeverisjen Vendore
- Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore
- Ligji për Lejet Mjedisore
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Ndër VKM me rëndësi të veçantë përmenden:

- VKM për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
- VKM për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave për Mbetjet
- VKM për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim
- VKM për Lendfillet e Mbetjeve
- VKM për Incinerimin e Mbetjeve



1.2.2.2 Politikat dhe Planet në nivel kombëtar

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta Bashkiake në Shqipëri orientohet kryesisht nga detyrimet e bazuara në synimet dhe afatet kohore të përcaktuara në Direktivat e BE-së (si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Anëtarësimit), si edhe si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve. Strategjia e MM dhe Plani i Veprimit është duke u përgatitur nga MTM, e cila është në proces të përgatitjes së draftit përfundimtar të strategjisë për t'u kthyer në VKM. Objektivat specifike të strategjisë janë të sigurojë zgjidhje praktike për:

- Përbushjen e detyrimeve të veçanta të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve
- Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) në lidhje me sektorin e mbetjeve.
- Trajtimi në mënyrë të bashkërenduar dhe të integruar i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat përballet vendi.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) artikulon ambicjen e Shqipërisë për integrimin në BE dhe vendos objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Arritja e këtyre synimeve raportohet nëpërmjet një sërë raportesh vjetorë të BE-së për Shqipërinë. Zotimet në kuadër të MSA janë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020 ose në Projekt Strategjinë Ndër-Sektoriale të Mjedisit (2015-2020).

1.2.3 Lidhja me Planet, Programet, Strategjitë dhe Objektivat e tjera Mjedisore

Kjo pjesë e raportit përshkruan kontekstin e politikës brenda të cilit vepron Plani i Investimeve MIMN dhe kufizimet e synimet që ky kontekst i imponon Planit të Investimeve MIMN.

Tabela më poshtë paraqet të përmblodhur se si Plani i Investimeve MIMN ndikon dhe ndikohet nga planet, programet dhe strategjitë e tjera (PPS) dhe objektivat e mbrojtjes mjedisore.



Tabela 3 Planet, programet dhe strategjitë përkatëse dhe objektivat e mbrojtjes mjedisore, lidhja e tyre me Planin e Investimeve MIMN dhe kërkesat/ objektivat kyç që rrjedhin prej tyre

Emërtimi i planit, programit ose strategjisë/ objektivi i mbrojtjes mjedisore	Si ndikon apo ndikohet nga Planin e Investimeve MIMN sa u përket çështjeve të VSM ⁷	Kërkesat/ objektivat kyç që dalin prej PPS
Planifikimi gjithëpërfshirës (Planifikimi hapësinor/ territorial)		
SHQIPERIA 2030, Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPK) – Dokumenti i parë Kombëtar për Planifikimin e Territorit 2015 – 2030, publikuar nga ish-Ministria e Zhvillimit Urban (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave N° 881, datë 14/12/2016	Jep kuadrin strategjik të referimit për zhvillimin e qendrueshëm territorial deri në vitin 2030, duke u kujdesur të sigurojë një zhvillim ekonomik dhe social kombëtar të balancuar, menaxhim të shëndoshë të burimeve të tij natyrore, mbrojtje mjedisore, ndërkohë që garanton përdorimin racional të tokës. Plani i Investimeve MIMN duhet të marrë në konsideratë parimet dhe objektivat e këtij plani.	<ul style="list-style-type: none"> • Caktimi i vendndodhjeve të veçanta për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve të ngurta bashkiake
Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar, publikuar nga ish-Ministria e Zhvillimit Urban (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit N° 2, datë 14.06.2016	Plani paraqet vizionin për zhvillimin e qendrueshëm të Brezit Bregdetar Shqiptar deri në 2030, duke parashtruar një kuadër të integruar të zhvillimeve territoriale dhe duke prezantuar një model zhvillimi cilësor afatgjatë për bregdetin shqiptar, veçanërisht duke pasur në vëmendje sektorët e turizmit, mjedisit, transportit, energjisë, bujqësisë, etj. si edhe zhvillimin urban. Ai përpiqet të harmonizojë kërkesat për investime ekonomike me qëllimet/ nevojat e zhvillimit të qendrueshëm duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë historike dhe kulturore, zonat e mbrojtura si edhe të parandalojë investimet në zonat me rrezikshmëri të lartë për jetën e njerëzve, natyrën dhe mjedisin.	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e rrjeteve për menaxhimin e mbetjeve bazuar në distancat dhe kapacitetet në dispozicion dhe duke iu referuar një hierarkie të menaxhimit të integruar që synon mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në çdo lokalitet • Zhvillimi i zonave të menaxhimit të mbetjeve dhe zbatimi i menaxhimit të mbetjeve urbane dhe industriale • Mbrojtja e burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore nga mbetjet e ngurta dhe ndërprerja e depozitimit të mbetjeve në rrjetet kulluese

⁷ Biodiversiteti, flora, fauna, popullsia, shëndeti i njerëzve, toka, uji, ajri, faktorët klimatikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore (përfshi trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike), peizazhi, lidhja e ndërsjellë midis këtyre çështjeve, efektet dytësore dhe kumulative.

Emërtimi i planit, programit ose strategjisë/ objektivi i mbrojtjes mjedisore	Si ndikon apo ndikohet nga Plani i Investimeve MIMN sa u përket çështjeve të VSM?	Kërkesat/ objektivat kyç që dalin prej PPS
<p>Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën Tiranë - Durrës, publikuar nga ish-Ministria e Zhvillimit Urban (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit N° 3, datë 14.06.2016</p>	<p>Shpreh vizionin për zhvillimin e rajonit metropolitan Tiranë - Durrës deri në vitin 2030, për të arritur objektivat e zhvillimit cilësor mjedisor rajonal nëpërmjet bashkërendimit të planeve hapësinore dhe strategjive të tjera të rëndësishme mjedisore, si ajo për mbetjet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të realizohet trajtimi i mbetjeve të ngurta në skemat rajonale, si edhe qasje më efikase në skemat e riciklimit të mbetjeve • Mbrojtja e mjedisit nga mbetjet e ngurta, si brenda edhe jashtë zonave urbane
<p>Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2018 – 2020 Miratuar me VKM N° 246, datë 09.05.2018</p>	<p>Ky plan përfshin masat afatshkurtra dhe afatmesme që duhet të ndërmarrë Shqipëria deri në vitin 2020 për të transpozuar plotësisht kuadrin ligjor me legjislationin në fuqi të BE.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtimi i kuadrit ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve sipas kërkesave të BE.
<p>Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor Miratuar me VKM N° 709, datë 29.10.2014</p>	<p>Strategjia synon të krijojë një kuadër strategjik për të përballuar sfidat e sektorit bujqësor dhe të agropërpunimit, si edhe për zhvillimin e qendrueshëm të zonave rurale, duke pasur parasysh aspektet ekonomike, mjedisore dhe sociale. Një temë e rëndësishme e strategjisë është të sigurojë cilësinë dhe sigurinë e ushqimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Masat për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve nga sektori bujqësor dhe ai agro-përpunues
Planifikimi Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve		
<p>Strategjia Kombëtare Shqiptare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit, përgatitur nga një ekip ekspertësh vendas dhe nënkombëtarë për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Asistencë Teknike nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim</p>	<p>Strategjia Shqiptare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani i Veprimit është një nga dokumentet udhëzues për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri. Ky dokument është përgatitur nga MTM duke synuar të japë zgjidhje praktike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për të përmbushur detyrime specifike të legjislationit të KE për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kornizë për menaxhimin e integruar të mbetjeve • Për të zbatuar Vendimet e 	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i grumbullimit të rrymave të ndryshme të mbetjeve, për të arritur norma të larta grumbullimi • Të sigurohet funksionimi i një rrjeti të integruar impiantesh për grumbullimin, ndarjen, riciklimin, rikuperimin dhe depozitimin e mbetjeve • Të sigurohet funksionimi i impianteve sipas praktikave të mira mjedisore. Ato duhet të marrin lejet dhe të plotësojnë kërkesat bazë për të siguruar një

Emërtimi i planit, programit ose strategjisë/ objektivi i mbrojtjes mjedisore	Si ndikon apo ndikohet nga Plani i Investimeve MIMN sa u përket çështjeve të VSM'	Kërkesat/ objektivat kyç që dalin prej PPS
	<p>Këshillit të Ministrave (VKM) që lidhen me sektorin e mbetjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Për të trajtuar problematikat kryesore të menaxhimit të mbetjeve që hasen në vend në një mënyrë të bashkërenduar dhe të integruar <p>Objektivat që duhet të arrihen duhet të mbështeten edhe nga dokumente të tjerë planifikues, si Plani i Investimeve MIMN.</p>	<p>menaxhim të sigurt nga ana mjedisore të mbetjeve, siç përcaktohet në lejet e tyre. Duhet të monitorohet përputhshmëria me kushtet e lejes dhe të detyrohet zbatimi i tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Të sigurohet që mbajtësit e mbetjeve t'ia dorëzojnë ato vetëm impianteve të autorizuara. Të mblidhen dhe të përpunohen të dhënat e nevojshme për investime dhe politikëbërje të bazuar në evidenca. Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve kryesorë të përfshirë rreth kërkesave të menaxhimit të sigurt mjedisor dhe rreth masave dhe infrastrukturës në dispozicion për të mbështetur menaxhimin. Planifikimi dhe menaxhimi i integruar MMN në zonat e mbetjeve. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet prezantimit të metodave për trajtimin e mbetjeve që janë në përputhje me standardet e BE



Emërtimi i planit, programit ose strategjisë/ objektivi i mbrojtjes mjedisore	Si ndikon apo ndikohet nga Plani i Investimeve MIMN sa u përket çështjeve të VSM?	Kërkesat/ objektivat kyç që dalin prej PPS
<p>Zbulja e Riskut në Vend depozitime/ Raporti Përfundimtar, përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), me mbështetjen e Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (DLDP), nëpërmjet Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC) dhe me mbështetjen teknike të Konsulentit UTS-01 Raporti Përfundimtar u prezantua në 2018</p>	<p>Raporti paraqet një përmbledhje të punës së kryer nga grupi i punës i MTM për "Zbuljen e riskut në vend depozitime". Ai përfshin një inventar të vendgrumbullimeve ekzistuese dhe propozon masa për rehabilitimin e tyre, bazuar në vlerësimin e parë të riskut. Masat për rehabilitimin e vendgrumbullimeve janë përfshirë në Planin e Investimeve MIMN. Objektivat që duhet të arrihen duhet të mbështeten edhe nga dokumente të tjerë planifikues, si Plani i Investimeve MIMN.</p>	<p>Renditja e vendgrumbullimeve që duhet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të rehabilitohen (me synimin për t'i përdorur për një periudhë të ndërmjetme, 3 – 5 vjet) • Të mbyllen/ kapsulohen (sipas masave të specifikuar në raportin e e Metodologjisë për Zbuljen e Riskut) • Të largohen (mbetjet duhet të zhvendosen në vendgrumbullimin më të afërt të rehabilituar ose në vend depozitimin sanitar më të afërt)
Planifikime të tjera sektoriale		
<p>Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015 – 2030 Dokument draft</p>	<p>E përkufizon Shqipërinë si një vend me zhvillim të qendrueshëm social dhe ekonomik, që mbron burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të tyre të integruar dhe promovon vlerat mjedisore duke i përdorur ato në të mirë të përparimit ekonomik. Objektivat që duhet të arrihen duhet të mbështeten edhe nga dokumente të tjerë planifikues, si Plani i Investimeve MIMN.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e sasisë së mbetjeve që shkon në vend depozitime deri në 45 % • Riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane në masën rreth 55 % • Zbatimi i planeve të rehabilitimit për nëntë pika të nxehta prioritare dhe përgatitja e draft planeve për pikat e tjera të nxehta mjedisore



Emërtimi i planit, programit ose strategjisë/ objektivi i mbrojtjes mjedisore	Si ndikon apo ndikohet nga Plani i Investimeve MIMN sa u përket çështjeve të VSM?	Kërkesat/ objektivat kyç që dalin prej PPS
Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin	<p>Shqipëria konsiderohet një vend me shumëllojshmëri habitatesh dhe specimesh shtazore. Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Shqipërisë gjatë viteve të fundit ka qenë përcaktimi i zonave të reja të mbrojtura (ZM), çka shprehet edhe në Strategjinë Kombëtare për Biodiversitetin. Kjo ka ndikuar në mënyrë pozitive në ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit megjithëse ZM ende përballen me probleme dhe sfida të ndryshme.</p> <p>Objektivat që duhet të arrihen duhet të mbështeten edhe nga dokumente të tjerë planifikues, si Plani i Investimeve MIMN.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Infrastruktura MMN nuk duhet të zbatohet në zonat e mbrojtura dhe në zonat e tyre buferike. • MIMN i duhur duhet të mbrojë natyrën dhe biodiversitetin nga ndikimet negative.
Master Plani i Ujësjellës Kanalizimeve për Shqipërinë; përgatitur nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, financuar nga KfE; Janar 2013	<p>Master Plani i Ujësjellës Kanalizimeve synon</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të zgjerojë dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve • T'i orientojë ndërmarrjet e ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit të kostove dhe rikuperimit të plotë të kostos • Të përmirësojë aspektin rregullator dhe qeverisës në këtë sektor • Të investohet për të zhvilluar kapacitetet e fuqisë punëtore të sektorit • Të shkohet drejt konvergimit të ligjit shqiptar me Direktivat e BE për Ujin <p>Objektivat që duhet të arrihen duhet të mbështeten edhe nga dokumente të tjerë planifikues, si Plani i Investimeve MIMN</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxhimi i duhur i mbetjeve të ngurta duhet të ndihmojë edhe në mbrojtjen e burimeve ujore në Shqipëri.
Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Turizmit 2018 – 2022 Dokument draft	Strategjia do të promovojë zhvillimin e sektorit të turizmit.	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i duhur i infrastrukturës MMN për grumbullimin dhe trajtimin/ depozitimin përfundimtar të mbetjeve të ngurta bashkiake.



1.3 Aktivitete të zhvilluara për VSM

MIE⁸ po drejton përgatitjen e Planit të Investimeve MIMN. Meqë Ministria është një nga dy ministritë e linjës përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, MTM dhe Koordinatorin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Zyrën e Kryeministrit është gjithashtu i përfshirë ngushtë në procesin përgatitor. Aktorë të tjerë kryesorë të përfshirë janë Agjencia Kombëtare e Ujësullës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), gjithashtu autoriteti për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT).

Përfshirja e këtyre institucioneve ka qenë nëpërmjet takimeve të rregullta, në të cilat janë prezantuar dhe diskutuar përmbajtja kryesore dhe sugjerimet për secilën fazë të Planit të Investimeve MIMN. Në këtë mënyrë, është komentuar dhe është mbështetur miratimi i rezultateve të ndërmjetme dhe janë përgatitur bashkarisht vendimet e nevojshme (shihni gjithashtu Tabela 4). Pjesëmarrës të tjerë të shpeshtë në këto takime kanë qenë edhe stafi i GIZ, pasi ata janë duke punuar për strategjinë e re kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planin e veprimit me porosi të MTM, si edhe KfW Entwicklungsbank, si donatori që e financon këtë projekt.

Procesi për përgatitjen e Studimit të Sektorit filloi në Mars 2017. Që atëhere janë zhvilluar takime në intervale të rregullta, veçanërisht me aktorët kryesorë të përmendur më lart. Për shkak të ristrukturimit të qeverisë, pati gjithsesi një ndërprerje në përgatitjen e Studimit të Sektorit në periudhën Gusht – Tetor 2017. Pas rifillimit të punës për Studimin e Sektorit në Nëntor 2017, u organizua një seminar dy-ditor në Janar 2018, gjatë të cilit aktorët kryesorë të lartpërmendur patën mundësinë të diskutonin dhe të hartonin propozime për zonat e mbetjeve (zonat e mbulimit), të identifikonin masat MIMN për zonat e mbetjeve dhe të diskutonin rreth sistemit të prioriteteve dhe kritereve të përdorura. Takime të rregullta me aktorët kryesorë kanë vazhduar që prej seminarit të Janarit e deri sot.

Në një fazë të mëtejshme të procesit të përgatitjes së Studimit të Sektorit janë zhvilluar takime nëpër zonat e mbetjeve me bashkitë përkatëse, me qëllim marrjen e rezultateve dhe konkluzioneve të administratave përkatëse të bashkive dhe qarqeve lidhur me përfshirjen e tyre në zonat specifike të mbetjeve, si edhe lidhur me masat e propozuara në Studimin e Sektorit për nivelin bashkiak. Përveç takimeve në zonat e mbetjeve me përfaqësues të administratës së bashkive dhe qarqeve, u mbajt edhe një takim i ngjashëm me organizatat jo-qeveritare.

⁸ Para ristrukturimit të Qeverisë në vjeshtën e 2017, ishte Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU).

Po kështu, Drafti i Studimit të Sektorit u është shpërndarë si dokument për komente të 61 bashkive të vendit.

Më tej, një takim me donatorin u zhvillua në datën 13 Shtator 2018, në të cilin u prezantua dhe u diskutua Studimi i Sektorit. Donatorët kishin mundësinë të paraqisnin komentet e tyre rreth Studimit të Sektorit.

Pasi u dorëzuan të gjitha komentet, u mbajt një seminar me grupin ndërmënytor të punës për prezantimin dhe diskutimin e komenteve të marra rreth Studimit të Sektorit si edhe për marrjen në konsideratë të këtyre komenteve në Studim.

Vetë Studimi i VSM është përgatitur duke mbajtur parasysh standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, pra Direktivën Europiane për VSM (Direktiva 2001/42/EC për vlerësimin e ndikimeve të disa planeve dhe programeve në mjedis) si edhe Ligjin shqiptar N° 91/2013 për "Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Për rrjedhojë, Konsulenti është porositur të kryejë Studimin e VSM bazuar në qasjen e thjeshtë dhe hapat e përgjithshëm të punës të paraqitur në figurën e mëposhtme.




Figura 2 Qasja bazë dhe hapat e punës për Studimin VSM

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblendhur aktivitetet e zhvilluara për VSM lidhur me Planin e Investimeve MIMN.



Tabela 4 Aktivitetet e zhvilluara për VSM

Veprimi/ aktiviteti VSM	Datë	Përshkrimi
Takim inauguroes me Grupin Ndërmintor të Punës	07 Mars 2017	Takimi inauguroes u mbajt në Ministrinë e Zhvillimit Urban në Tiranë. Çështjet kryesore që u paraqitën dhe u diskutuan në takim ishin: <ul style="list-style-type: none"> • Konsulenti dhe ekipi i projektit • Objektivat e projektit • Qasja e Projektit • Grafiku kohor • Strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve paraprake të Fazës Fillestare	25 Maj 2017	Seminari u fokusua në diskutimin rreth disa aspekteve të Fazës Fillestare, që formon një bazë të rëndësishme për shtjellimin e mëtejshëm të paketave të punës. Të gjitha çështjet e diskutuara janë paraqitur në Raportin e Fazës Fillestare: <ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna mbi popullsinë dhe mbetjet • Kuadri rregullator • Impiantet rajonale ekzistuese dhe të planifikuara për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve • Sondazh me bashkitë
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve paraprake të Fazës së Hartimit të Teknologjive	26 Korrik 2017	Në Fazën e Hartimit të Teknologjive fokusi ishte në identifikimin e alternativave të teknologjisë që janë konform politikave, të testuara dhe të realizueshme financiarisht. Çështjet e diskutuara gjatë seminarit janë përfshirë në Raportin Teknik: <ul style="list-style-type: none"> • Komente dhe pyetje rreth Raportit të Fazës Fillestare • Përgjigje/ reagime nga diskutimi rreth metodologjisë për llogaritjen e sasive të mbetjeve dhe parashikimit të tyre • Metodologjia për vlerësimin e teknologjive të menaxhimit të mbetjeve
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve paraprake të Fazës së Identifikimit të Vendndodhjeve dhe të Planifikimit të Investimeve	05 Dhjetor 2017	Përveç një prezantimi të përgjithshëm të statusit dhe rezultateve aktuale të projektit, u prezantuan dhe u diskutuan gjithashtu metodologjia dhe qasja, ashtu si edhe rezultatet e Fazave të Identifikimit të Vendndodhjeve dhe të Planifikimit të Investimeve. Gjithashtu, u bënë të njohura në perspektivë hapat e mëtejshëm të projektit dhe afatet kohore: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrim i përgjithshëm i projektit • Prezantim i alternativave teknike • Prezantim dhe diskutim i identifikimit të vendndodhjeve • Prezantim dhe diskutim i metodologjisë për planifikimin e investimeve • Perspektivë në hapat e ardhshëm dhe afatet kohore



Veprimi/ aktiviteti VSM	Datë	Përshkrimi
Seminar për Planin e Investimeve	10 & 11 Janar 2018	Qëllimi i seminarit ishte <ul style="list-style-type: none"> Diskutimi dhe hartimi i propozimeve për zonat e mbetjeve (zonat e mbulimit) Identifikimi i masave MIMN në zonat e mbetjeve Diskutimi i sistemit të prioritetëve dhe kriteret e përdorura
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e Raportit për Kostot e Konsoliduara të Investimit	07 Mars 2018	Seminaru u zhvillua për të prezantuar dhe diskutuar <ul style="list-style-type: none"> Masat e konsoliduara të investimit në secilën zonë mbetjesh Kostot e përgjithshme për investimet "rajonale" dhe "vendore" Kostot operative të aktivitetëve "rajonale" dhe "vendore", si edhe kostot përkatëse për familje
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të Fazës së Caktimit të Prioritetëve	24 Prill 2018	Seminaru kishte për qëllim të prezantohej dhe të diskutohej rreth <ul style="list-style-type: none"> Rezultateve të Sistemit të Prioritetëve
Seminar për prezantimin dhe diskutimin e Rezultateve Përfundimtare të Planit të Investimeve MIMN	06 Qershor 2018	Në seminar u prezantuan dhe u diskutuan <ul style="list-style-type: none"> Rezultatet e Sistemit të Prioritetëve Rezultatet përfundimtare të Planit të Investimeve
Takimet në Zonat e Mbetjeve ⁹	02 – 10 Korrik 2018	Takimet në zonat e mbetjeve u zhvilluan për të marrë rezultatet dhe konkluzionet lidhur me <ul style="list-style-type: none"> Opinionet e bashkive përkatëse sa i përket përfshirjes së tyre në një zonë specifike mbetjesh, si edhe masave të propozuara në Studimin e Sektorit për nivelin bashkiak Materialin për përgatitjen e Studimit Hulumtues për VSM
Takim me OJQ ¹⁰	11 Korrik 2018	Gjatë takimit u prezantuan këto tema kryesore që lidhen me zhvillimin e përgjithshëm të Planit të Investimeve MIMN dhe VSM: <ul style="list-style-type: none"> Panoramë e përgjithshme e Studimit të Sektorit MIMN VSM dhe struktura e synuar e Raportit Mjedisor Aktorët kryesorë që duhen përfshirë në konsultimet e mëtejshme
Shpërndarja e Draftit të Studimit të Sektorit në të 61 bashkitë shqiptare dhe tek aktorë të tjerë kryesorë nga MIE, përfshi kërkesën për të	Fund korriku 2018	

⁹ Procesverbalet e takimeve në zonat e mbetjeve janë përfshirë në kapitullin 7.2 në Shtojcën 2 si pjesë e Raportit Hulumtues Përfundimtar.

¹⁰ Procesverbali i takimit me OJQ është përfshirë në kapitullin 7.2 në Shtojcën 2, si pjesë e Raportit Hulumtues Përfundimtar.



Veprimi/ aktiviteti VSM	Datë	Përshkrimi
paraqitur komente		
Dorëzimi i Draft Raportit Hulumtues	07 Gusht 2018	
Takim me Donatorin	11 Shtator 2018	Në takimin me donatorin u prezantuan dhe u diskutuan temat kryesore si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Sfondi historik dhe qasja metodologjike e Studimit të Sektorit • Kriteret e planifikimit • Zonat e mbetjeve të propozuara • Mjetet e planifikimit • Përmbledhje e rezultateve të planifikimit të investimeve • Aktivitetet aktuale dhe ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme
Takim me MIE mbi Sferën e Mbulimit të VSM	20 Shtator 2018	Takimi kishte si qëllim diskutimin rreth <ul style="list-style-type: none"> • Raportit Hulumtues Paraprak • Hapave të mëtejshëm dhe kuadrit kohor për Studimin VSM: <ul style="list-style-type: none"> ◦ Rezultatet e Fazës Hulumtuese ◦ Seminar për të diskutuar dhe marrë në konsideratë komentet e dhëna mbi Draft Planin e Investimeve ◦ Konsultimi i Draft Studimit VSM me publikun dhe grupet e interesit ◦ Përshtatje të nevojshme të grafikut kohor
Takim me MTM mbi Sferën e Mbulimit të VSM	20 Shtator 2018	Takimi kishte si qëllim diskutimin rreth <ul style="list-style-type: none"> • Raportit Hulumtues Paraprak • Hapat e mëtejshëm dhe grafiku kohor për Studimin VSM: <ul style="list-style-type: none"> ◦ Mundësitë për optimizimin e procesit ◦ Aktorët kryesorë që duhet të përfshihen ◦ Përfshirja e aktorëve kryesorë dhe konsultimi me publikun dhe me grupet e interesit
Dorëzimi i Raportit Hulumtues Përfundimtar	24 Shtator 2018	Raporti Hulumtues Përfundimtar është përfshirë në kapitullin 7.2 si Shtojca 2.
Seminar për diskutimin rreth komenteve të marra për Studimin e Sektorit	26 Tetor 2018	Bazuar në rezultatet/ komentet nga përfshirja e aktorëve kryesorë të ndryshëm, seminari synonte prezantimin dhe diskutimin rreth <ul style="list-style-type: none"> • Komenteve të bëra për Studimin e Sektorit • Marrjes në konsideratë të këtyre komenteve në Studimin e Sektorit
Dorëzimi i Raportit Paraprak të Studimit të VSM	9 Nëntor 2018	



Veprimi/ aktiviteti VSM	Datë	Përshkrimi
Dorëzimi i Raportit Përfundimtar të Studimit të Sektorit	19 Nëntor 2018	Përmbledhja ekzekutive e Raportit Përfundimtar të Studimit të Sektorit është bashkangjitur në kapitullin 7.1 si Shtojca 1.
Publikimi i Raportit paraprak të VSM për përfshirjen dhe konsultimin me publikun dhe grupet e interesit	19 Nëntor – 28 Dhjetor 2018	Raporti Paraprak i VSM u publikua në faqen zyrtare të MIE.
Takim konsultimi me publikun dhe grupet e interesit mbi gjetjet e Raportit Paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të Planit të Investimeve MIMN ¹¹	13 Dhjetor 2018	Qëllimi i takimit ishte të kërkonte dhe të diskutonte rreth komenteve dhe kundërshtimeve nga publiku dhe grupet e interesit.
Përgjigje nga MIE që nuk ka pasur komente me shkrim për Studimin e VSM	24 Dhjetor 2018	
Dorëzimi i Raportit Përfundimtar të Studimit VSM	18 Janar 2019	Raporti përfundimtar i Studimit VSM u përgatit duke marrë në konsideratë kundërshtimet kryesore nga Takimi i Konsultimit i datës 13 Dhjetor 2018: <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e një kapitulli mbi ligjet dhe direktivat e MMN në Shqipëri.¹² • Përfshirja e ligjeve tek të cilat bazohet VSM.¹³

1.4 Fusha e Mbulimit e Studimit VSM

1.4.1 Shtrirja gjeografike

Objektivi i Planit të Investimeve MIMN është përcaktimi i një Plani Kombëtar Investimesh në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Si i tillë ky vlerësim do të fokusohet në nivel strategjik kombëtar dhe kjo pasqyrohet në thellimin e vlerësimit.

1.4.2 Kohështrirja

Gjatë vlerësimit do të merren në konsideratë ndikimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Plani Kombëtar i Investimeve për sektorin e menaxhimit të mbetjeve gjithashtu ndahet në masa afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata (shihni Tabela 2). Si rezultat afatet

¹¹ Procesverbali i Takimit të Konsultimit është bashkangjitur në kapitullin 7.3 si Shtojca 3.

¹² Është shtuar një kapitull përkatës – shihni kapitullin 1.2.2. Një tabelë ku listohen aspektet mjedisore kyç që duhet të merren në konsideratë në Studimin VSM mund të gjendet në kapitullin 2.1, Tabela 8. Raporti Hulumtues (i bashkangjitur si Shtojca 2) gjithashtu detajon bazën ligjore dhe paraqet objektivat dhe synimet.

¹³ Raporti Hulumtues (i bashkangjitur si Shtojca 2) shpjegon ligjet në të cilat bazohet VSM. Shihni edhe referencën përkatëse në kapitullin 1 të këtij raporti.



kohore për vlerësimin e ndikimeve do të jenë identike me afatet kohore të Planit të Investimeve. Pra, në funksion të VSM është marrë parasysh

- një kohështrirje afatshkurtër që mbulon periudhën 2018 – 2022,
- një kohështrirje afatmesme që mbulon periudhën 2023 – 2027 dhe
- një kohështrirje afatgjatë që mbulon periudhën 2028 – 2032.

1.4.3 Pjesët e Studimit të Sektorit që duhet të vlerësohen

Qëllimi i Studimit VSM është të kryejë një vlerësim kuptimplotë të atyre pjesëve të Studimit të Sektorit që mund të çojnë në efekte mjedisore domethënëse. Në këtë mënyrë ai garanton që do të përmbushen kërkesat e Direktivës për VSM dhe të rregulloreve të tjera mjedisore gjatë zbatimit të Planit të Investimeve MIMN.

Tabela e mëposhtme tregon ato elementë të Studimit të Sektorit që do të vlerësohen si pjesë të VSM dhe gjithashtu shpjegon pse ato janë ose nuk janë vlerësuar.

Tabela 5 Elementët e Studimit të Sektorit që propozohen për vlerësim

Kapitulli	Vendimi dhe justifikimi
Kapitulli 0: Përmbledhje ekzekutive	Jo. Ky kapitull përmbledh përmbajtjen thelbësore dhe pikat kyç të Studimit të Sektorit dhe për rrjedhojë ai vetë nuk ka nevojë për vlerësim.
Kapitulli 1: Hyrje	Jo. Ky kapitull jep një panoramë të përgjithshme të historikut dhe procesit të përgatitjes së Studimit të Sektorit.
Kapitulli 2: Situata ekzistuese MMN	Jo. Ky kapitull përshkruan situatën e tanishme të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Për përshkrimin e Gjendjes Mjedisore mund të jenë të vlefshme disa informacione bazë që jepen në këtë kapitull.
Kapitulli 3: Alternativat e teknologjisë për MMN	Jo. Ky kapitull shpjegon dhe krahason alternativat e teknologjisë për MMN.
Kapitulli 4: Zonat e Mbetjeve dhe Vendndodhjet për Masat e Investimeve Rajonale	Po. VSM do të shqyrtojë caktimin e kufijve të zonave të mbetjeve dhe vendndodhjet e mundshme për t'u bërë Qendra të reja të Menaxhimit të Mbetjeve.
Kapitulli 5: Plani i Investimeve	Po. VSM do të shqyrtojë planin e investimeve sa u përket impianteve të reja rajonale dhe rreziqet e mundshme që lidhen me to.
Kapitulli 6: Caktimi i Prioriteteve për Masat e Investimit	Jo. Ky kapitull përshkruan metodologjinë për caktimin e prioriteteve për investimet e planifikuara. Rekomandimet nga VSM mund të ndikojnë në metodologjinë e caktimit të prioriteteve.
Kapitulli 7: Hapat e ardhshëm	Jo. Ky kapitull shpjegon hapat e nevojshëm që duhet të merren për ta publikuar Studimin e Sektorit si një plan detyrues për autoritetet publike.



1.4.4 Aspektet mjedisore kyçe që duhet të trajtohen në Studimin VSM

VSM do të identifikojë dhe do të vlerësojë ndikimet dhe efektet e mundshme të rëndësishme mjedisore nga Planit i Investimeve MIMN, nëse nuk janë zbutur. Këto efekte përfshijnë ndër të tjera, efektet pozitive dhe negative, afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata, efektet e përkohshme si edhe ato të grumbulluara.

Duhet të merren parasysh efektet e ndërtimit dhe të funksionimit. Aty ku është e përshtatshme, duhet të merret parasysh sezonaliteti për të përcaktuar efektet përkatëse.

Në efektet e mundshme të rëndësishme mjedisore nga zbatimi i Planit të Investimeve MIMN pritet të përfshihen ato që renditen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6 Komponentët mjedisorë dhe efektet e mundshme

Komponenti mjedisor	Efektet e mundshme të rëndësishme, nëse nuk zbutet
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> Afërsia e Qendrave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe impianteve të tjera rajonale me qendrat e banuara Përmirësimet në mundësinë e përdorimit dhe në standardet teknike të impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve kontribuojnë në një mbrojtje më të mirë të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve Efektet e mundshme në turizëm dhe në përdorimin e tokës për argëtime Efektet në cilësinë e ajrit Efektet në tokë Efektet në cilësinë e ujit (ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore) Efektet në qarkullimin e mjeteve dhe rrjetet e transportit Mundësia për prishje të qetësisë publike (zhurma, aromat e rënda, etj.)
Biodiversiteti, flora dhe fauna	<ul style="list-style-type: none"> Efektet në zonat e mbrojtura Efektet në florë dhe faunë dhe në habitatet (e ndjeshme)
Përdorimi i dheut dhe tokës	<ul style="list-style-type: none"> Kërkesat për tokën lidhur me qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe impiante të tjera rajonale Ndikimi në praktikën e përdorimit të tokës Efektet në cilësinë e dheut për shkak të reduktimit të lëngut kullues nga mbetjet Efektet në cilësinë e dheut nga përdorimi i plehrave organike që prodhohen në impiantet e kompostimit në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve Ndikimet në tokë që mund të shkaktohen nga ndonjë incident në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe në impiantet e tjera rajonale

Komponenti mjedisor	Efkti i mundshëm i rëndësishëm, nëse nuk zbutet
Asetet materiale	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i burimeve (materialet e ndërtimit dhe energji) për qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe impiantet e tjera rajonale Ripërdorimi i materialit me anë të riciklimit të fraksioneve përkatëse të mbetjeve Përdorimi i rrjeteve të transportit Përdorimi i burimeve për funksionimin e qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe të impianteve të tjera rajonale
Uji	<ul style="list-style-type: none"> Ndikimet në cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor (p.sh. nga reduktimi i lëngut kullues ose i mbetjeve në ujërat sipërfaqësore) Ndikimet në statusin ekologjik të trupave ujore Ndikimet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndonjë incident në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe në impiantet e tjera rajonale
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> Efektet e aromave të rënda që çlirohen në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve Efektet e emetimeve në ajër nga transportimi i mbetjeve Efektet e emetimeve në ajër nga impiantet rajonale të menaxhimit të mbetjeve Emetimet e gazit serrë nga transportimi i mbetjeve Reduktimi i emetimeve të gazit serrë nëpërmjet depozitimit të mbetjeve në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe reduktimit të numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike
Peizazhi	<ul style="list-style-type: none"> Efektet në karakterin e përgjithshëm të peizazhit dhe receptorët e ndjeshëm
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Efektet në veçoritë e trashëgimisë kulturore, arkitekturore dhe arkeologjike në afërsi të qendrave të propozuara për menaxhimin e mbetjeve dhe të impianteve të tjera rajonale Mundësia e dëmtimit të zonave të pazbuluara më parë pranë ose brenda qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe në impiantet e tjera rajonale

1.4.5 Burimet e të dhënave dhe shkalla e vlerësimit

Iu referohet dokumenteve kyç më poshtë

- Raporti i Gjendjes së Mjedisit
- Vlerësimi i Performancës Mjedisore

Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) janë përdorur aty ku është e mundur për të shfaqur dhe për të analizuar informacionin përkatës. Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të secilës temë të VSM që parashtrohet në të dhënat bazë të VSM. Tabela përfshin gjithashtu një listë të burimeve të të dhënave që përdoren për të përpiluar

informacionin bazë dhe përveç kësaj tregon shkallën e vlerësimit bazuar në këto burime të dhënash që janë në dispozicion.

Tabela 7 Burimet e të dhënave bazë dhe shkalla e vlerësimit

Tema e VSM	Burimet e mundshme të të dhënave	Shkalla e mundshme e vlerësimit bazuar në burimet e të dhënave
Biodiversiteti, flora dhe fauna	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat GIS për zonat e mbrojtura natyrore (ASIG dhe AKUK) Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 – 2030 (AKPT) Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin Rrjeti Kombëtar i Biodiversitetit të Shqipërisë (AKZM): skedarë të dhënash për speciet, të dhëna për speciet, webGIS, zonat e mbrojtura 	Janë në dispozicion të dhëna kombëtare dhe rajonale për aspektet që lidhen me biodiversitetin, florën dhe faunën.
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> INSTAT Instituti Shqiptar i Statistikave Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 – 2030 (AKPT) Të dhëna GIS mbi zonat e banuara, zonat turistike, bimësinë – zonat bujqësore (MTM, ASIG, AKUK) 	Janë në dispozicion të dhëna dhe informacion kombëtar mbi dendësinë dhe shpërndarjen e popullsisë dhe ndikimet e mundshme nga Plani i Investimeve MIMN mund të vlerësohen në varësi të informacionit të dhënë. Temës së shëndetit të njerëzve do t'i referohemi lidhur me ndikimet jo të drejtpërdrejta nga cilësia e ajrit, zhurmat, cilësia e ujit, etj.
Përdorimi i dheut dhe tokës	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat GIS për zonat e banuara, infrastrukturën e transportit, bujqësinë, infrastrukturën teknike ekzistuese, kushtet gjeologjike dhe hidro-gjeologjike, zonat turistike (MTM, ASIG, AKUK) Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 – 2030 (AKPT) Fleta informative kombëtare mbi mbulimin tokës në Shqipëri 	Janë në dispozicion të dhëna dhe informacion kombëtar mbi përdorimin e dheut dhe tokës në nivel rajonal/kombëtar. Këto janë të mjaftueshme për natyrën strategjike dhe shtrirjen gjeografike të Planit të Investimeve MIMN.

Tema e VSM	Burimet e mundshme të të dhënave	Shkalla e mundshme e vlerësimit bazuar në burimet e të dhënave
Uji	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna GIS mbi rrugët ujore dhe trupat ujorë (AKUK) • Informacion për zonat e përmytura (jo në gjithë vendin) • Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 – 2030 (AKPT) • Strategjia e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve e Republikës së Shqipërisë • Master Plani Kombëtar për Ujësjetës dhe Kanalizimet • Raporti për cilësinë e ujit të plazheve në Shqipëri 2017 • Menaxhimi i baseneve të lumenjve Drin – Buna, Seman, Shkumbin (dokumente draft) • Draft Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2017 – 2027 	<p>Të dhënat dhe informacioni kombëtar është në dispozicion në një masë të kufizuar (p.sh. informacioni për zonat e përmytura nuk ekziston për gjithë vendin). Do të identifikohen sa të jetë e mundur çështjet që lidhen me mbetjet dhe cilësinë e ujit.</p>
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> • Ndotja e ajrit – gjendja dhe ndikimet (Shqipëri) • Komunikata e tretë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike • Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve i AKM • Rezultatet e monitorimit të kryer gjatë fushatave të AKM dhe Institutit Shqiptar të Shëndetit Publik 	<p>Të dhënat dhe informacioni kombëtar gjenden në nivel qarku/ kombëtar. Kjo është e mjaftueshme për natyrën strategjike dhe shtrirjen gjeografike të Planit të Investimeve MIMN.</p>



Tema e VSM	Burimet e mundshme të të dhënave	Shkalla e mundshme e vlerësimit bazuar në burimet e të dhënave
Asetet materiale	<ul style="list-style-type: none"> Shqipëria – rikuperimi i burimeve materiale Shqipëria – menaxhimi i mbetjeve bashkiake Draft Strategjia Kombëtare MMN dhe Plani i Veprimit Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë – Statistika për Shqipërinë Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit 2015 – 2030 (AKPT) 	Ka informacion kombëtar për disa burime që mund të ndikohen nga Plani i Investimeve MIMN.
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore dhe peizazhi	<ul style="list-style-type: none"> Të dhëna GIS mbi vendet (sitet) e trashëgimisë kulturore (MTM, ASIG) Shqipëria – Qendra e Trashëgimisë Botërore UNESCO Nuk ka informacion të publikuar në nivel kombëtar mbi peizazhin 	Ka në dispozicion të dhëna dhe informacion kombëtar për trashëgiminë kulturore, megjithatë niveli i tyre çon drejt burimeve specifike të projekteve vendore. Gjithsesi, informacioni në dispozicion është i mjaftueshëm për natyrën strategjike dhe shtrirjen gjeografike të Planit të Investimeve MIMN.

2 Objektivat mjedisore, synimet dhe indikatorët

2.1 Objektivat mjedisore në Shqipëri

Një qëllim kyç i hulumtimit të sferës së mbulimit është të ofrojë detajet e mjaftueshme rreth kuadrit të propozuar metodologjik për vlerësimin e ndikimeve mjedisore që të bëjë të mundur krijimin e një opinioni rreth kësaj çështjeje. Propozohet që të përdoret një vlerësim i drejtuar kah objektivat, i cili do të lejojë që vlerësimi të bëhet kundrejt objektivave mjedisore të përcaktuara të VSM për secilën nga fushat e identifikuara.

Në pjesët e mëparshme janë identifikuar karakteristikat mjedisore dhe çështjet kyç mjedisore që lidhen me Planin e Investimeve MIMN. Kjo pjesë e raportit e përdor atë informacion për të parashtruar një sërë draft objektivash, indikatorësh dhe synimesh në VSM. Këto do të përdoren në studimin e VSM për të parashikuar ndikimet e mundshme mjedisore të Planit të Investimeve MIMN. Me përdorimin e këtyre objektivave do të garantohet që në vijim të studimit hulumtues, studimi i VSM të fokusohet vetëm në ato çështje që janë më domethënëse dhe që i shërbejnë qëllimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten draft objektivat e VSM që po merren në konsideratë për të shqyrtuar ndikimet e mundshme mjedisore të Planit të Investimeve MIMN. Kriteret-e

vlerësimin janë shembuj të çështjeve që do të trajtohen. Duhet të vihet re që këto janë vetëm draft objektiva dhe jepen në funksion të diskutimit në këtë fazë të përcaktimit të fushës së studimit VSM. Do të vlerësohet çdo koment lidhur me draft objektivat me qëllim përditësimin e tyre para studimit të VSM.

Tabela 8 Objektivat mjedisore të VSM

Tema VSM	Objektivat mjedisore	Synimet e VSM
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njerëzve 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i cilësisë së jetës Mbrojtja e shëndetit të njerëzve
Biodiversiteti, flora dhe fauna	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e biodiversitetit Mbrojtja e florës dhe faunës dhe habitatet e tyre natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore
Përdorimi i dheut dhe tokës	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut Parandalimi i dëmtimit të tokës (dheut) përfshi mbrojtjen e strukturës së saj (erozion, ngjeshje e dheut) Rehabilitimi dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme të tokës (dheut) së dëmtuar 	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut
Asetet materiale	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i kujdesshëm dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj 	<ul style="list-style-type: none"> Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efijencës së këtij përdorimi Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore
Uji	<ul style="list-style-type: none"> Gjendja e mirë ekologjike e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore Gjendja e mirë kimike e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre ekologjike Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së tyre kimike
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja dhe ruajtja e cilësisë së ajrit Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimin e klimës 	<ul style="list-style-type: none"> Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit



Tema VSM	Objektivat mjedisore	Synimet e VSM
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e trashëgimisë kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja dhe mbrojtja e e aseteve të trashëgimisë kulturore
Peizazhi	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja dhe restaurimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit 	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e diversitetit të peizazhit

Këto synime do të kihen parasysh gjatë përgatitjes së informacionit mbi gjendjen mjedisore dhe gjatë vlerësimit mjedisor, për të përmbushur objektivat mjedisore të VSM për Planin e Investimeve MIMN.

Bazuar në studimin e kryer mbi gjendjen mjedisore, do të përcaktohen indikatorët duke mbajtur parasysh disponueshmërinë e të dhënave dhe fizibilitetin e krijimit të lidhjeve direkte midis ndryshimeve në mjedis dhe zbatimit të Planit të Investimeve MIMN. Kjo do të thotë që indikatorët do të nxirren gjatë studimit VSM, si edhe në përgjigje të komenteve të marra për Raportin Hulumtues.

2.2 Marrja parasysh e objektivave mjedisore në procesin e planifikimit

Në kuadër të VSM për Master Planin MIMN, janë përcaktuar dhe janë vlerësuar ndikimet e mundshme domethënëse mjedisore të masave të parashikuara për temat e mbrojtjes në gjithë fushën e studimit. Ky vlerësim mundëson që të identifikohen në një fazë të hershme cilat lloje masash janë potencialisht të dëmshme ndaj mjedisit.

Vendimi nëse dhe se si do të zbatohen masat e veçanta të Planit të Investimeve MIMN do të merret më vonë, ose në nivel kombëtar/rajonale ose vendor. Rëndësia e ndikimeve mjedisore të pritshme të masave përkatëse do të vlerësohet në mënyrë përfundimtare në kuadër të procedurave të planifikimit të zbatimit dhe procedurave të miratimit. Sugjerimet e para që kanë të bëjnë me procedurat e planifikimit dhe miratimit të mëtejshëm përmbledhen si më poshtë:

- Për temat e mbrojtjes së *ujit dhe tokës (dheut)*, studimi VSM vlerëson objektivat mjedisore strategjike për të gjithë fushën e studimit të Planit të Investimeve. Kur të zbatohen masat individuale, duhet të merren parasysh edhe kushtet rajonale e vendore të ujit dhe tokës. Ndër të tjera, kriteret e sasisë së ujit dhe balancës së ujit duhet të përfshihen në planifikimin dytësor dhe procedurat e miratimit.
- Për çështjen e mbrojtjes së *cilësisë së ajrit dhe klimës*, zbatimi i masave individuale të Planit të Investimeve duhet të marrë parasysh edhe kushtet rajonale e vendore të klimës dhe ajrit në planifikimin dytësor dhe procedurat e miratimit.



- Qëllimet për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore, ndër të tjera përfshijnë ruajtjen e monumenteve arkitekturore dhe natyrore si edhe peizazhet e mbrojtura. Gjatë zbatimit të masave individuale të Planit të Investimeve, ndikimi i mundshëm tek këto aspekte duhet të kihet parasysh për procedurat e planifikimit dhe miratimit.
- Çështja e mbrojtjes së aseteve materiale përfshin të mirat materiale me rëndësi ekonomike për publikun e gjerë. Këto përfshijnë ndër të tjera depozitat minerare si kromi, nikeli, bakri, gymyrguri, gipsi, guri gëlqeror, torfa, bazalti, guri i shtufit dhe argjila. Zbatimi i masave individuale në Planin e Investimeve duhet të marrë parasysh edhe ndikimet e mundshme në zonat e minierave. Gjithashtu duhet të përfshijë ndikimin ekonomik në proceset e fundit të prodhimit.

3 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç, përfshi zhvillimin e mundshëm të mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Karakteristikat kryesore dhe gjendja aktuale e mjedisit si edhe problemet aktuale serioze të mjedisit sa i përket MMN përshkruhen në nënkapitujt në vijim.

Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN përfaqëson skenarin referencë për ndikimet mjedisore të mundshme nga zbatimi i këtij plani.

Plani i Investimeve MIMN udhëhiqet nga objektivat e Sektorit Kombëtar të MMN, përkatësisht për

- ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme MMN në gjithë vendin,
- reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve,
- reduktimin e numrit të vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo-higjienike, si edhe
- mbrojtjen e mjedisit.

Plani i Investimeve MIMN fokusohet në mbetjet e ngurta bashkiake dhe përfshin më tej investimet që nevojiten për menaxhimin e mbetjeve inerte. Sipas draft Strategjisë të Menaxhimit të Mbetjeve, rrymat e tjera të mbetjeve do të trajtohen në masterplane të tjera të posaçme.

3.1 Përshkrimi i zonës gjeografike dhe parashikimi i popullsisë dhe sasisë së mbetjeve

Si Plan Kombëtar Investimesh, ai mbulon gjithë territorin e Shqipërisë.






Figura 3 Pamje e Shqipërisë me rajonet administrative (qarqet)



3.1.1 Kushtet gjeografike

Shqipëria është një shtet i vogël në Europën juglindore, me dalje në detin Mesdhe dhe ka një sipërfaqe gjithsej prej 28,748 km². Vendi kufizohet me Malin e Zi në veriperëndim, Kosovën në verilindje, Maqedoninë në lindje dhe me Greqinë në jug. Gjatësia e vijës bregdetare në detet Adriatik dhe Jon është 476 km. Gjithsej 70 % e vendit është me reliev malor dhe shpesh i pakalueshëm.

3.1.2 Popullsia dhe mbetjet

3.1.2.1 Parashikimi i popullsisë

Tabela më poshtë raporton parashikimin e numrit të popullsisë sipas qarqeve, duke treguar numrin e supozuar të popullsisë për 2018 dhe për vitet e fundit të Fazave 1 – 3."

Tabela 9 Parashikimi i popullsisë sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i popullsisë			
	2018	2022	2027	2032
Berat	159,629	151,851	143,087	135,283
Dibër	139,090	131,304	122,467	114,525
Durrës	334,298	348,156	366,324	385,480
Elbasan	329,358	321,261	311,871	303,252
Fier	360,686	354,527	347,408	340,909
Gjirokastrë	90,379	85,687	80,846	77,101
Korçë	253,456	245,634	236,438	227,849
Kukës	87,290	83,206	78,524	74,272
Lezhë	155,560	152,568	149,150	146,072
Shkodër	245,350	239,796	233,491	227,859
Tiranë	944,494	1,007,636	1,092,782	1,185,418
Vlorë	247,774	250,328	254,065	258,418
SHQIPËRIA	3,347,364	3,371,954	3,416,451	3,476,438



Shqipëria ka disa burime zyrtare që japin të dhëna mbi popullsinë. Zakonisht përdoren ato të INSTAT (bazuar në Census) dhe të Zyrës së Gjendjes Civile, por, shifrat e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Shifrat e popullsisë nga Zyra e Gjendjes Civile janë në përgjithësi shumë më të larta sesa shifrat sipas INSTAT. Për këtë arsye, është përdorur një faktor korrigjimi i prezantuar nga Ministria e Financave e Shqipërisë për të llogaritur numrin e popullsisë bazuar në të dyja burimet: $Census + (Zyra e Gjendjes Civile - Census) * 30 \%$.



3.1.2.2 Parashikimi i gjenerimit dhe grumbullimit të mbetjeve

Bazuar në parashikimin e popullsisë dhe në sasi të specifike të supozuara të mbetjeve të gjeneruara, në lloje të ndryshme vendbanimesh¹⁵ siç tregohen në tabelën e mëposhtme është llogaritur sasia e mbetjeve që pritet të gjenerohet gjatë periudhës së projektit.

Tabela 10 Sasi të specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Llojet e vendbanimeve	Gjenerimi i mbetjeve [kg/person/d]
Kryeqyteti i vendit (Tiranë)	1.2
Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, > 35,000 banorë)	1.1
Qendër rajonale e bashkuar (qendra e bashkimit të vendbanimeve, > 20,000 banorë)	1.0
Qendër lokale (qendra e rrethit, jo e formuar nga bashkimet, < 20,000 banorë)	0.7
Zonë periferike metropolitane (brenda zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane të orientuara drejt turizmit	0.55
Periferi (jashtë zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane pranë minierave ose burimeve të energjisë	
Njësi vendore të përziera industriale dhe shërbimesh	0.4
Zona të përziera bujqësore fushore	
Zona të përziera bujqësore malore	
Zona bujqësore fushore	
Zona bujqësore malore	

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet një përmbledhje e parashikimit për gjenerimin e mbetjeve në nivel qarku, duke iu referuar të njëjtëve vite si në parashikimin e popullsisë.

¹⁵ Llojet e vendbanimeve bazohen në Tipologjinë e Komunave dhe Bashkive, të publikuar nga INSTAT. Shihni INSTAT: Tipologjia e Komunave dhe Bashkive në Shqipëri, Maj 2014.

Tabela 11 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve [Mg/v]			
	2018	2022	2027	2032
Berat	39,503	37,616	35,491	33,601
Dibër	26,585	25,097	23,408	21,891
Durrës	105,626	110,081	115,924	122,088
Elbasan	76,175	74,350	72,239	70,309
Fier	84,624	83,197	81,549	80,046
Gjirokastrë	21,376	20,263	19,102	18,184
Korçë	62,575	60,733	58,571	56,558
Kukës	18,178	17,322	16,340	15,449
Lezhë	35,864	35,182	34,403	33,704
Shkodër	62,307	60,910	59,325	57,911
Tiranë	334,049	356,517	386,815	419,778
Vlorë	73,512	74,551	76,005	77,641
SHQIPËRIA	940,376	955,819	979,173	1,007,159

Në Shqipëri sasi të mbetjeve që grumbullohen janë të ndryshme nga sasi të gjenerohen, për shkak se shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk i mbulojnë të gjitha zonat, sidomos zonat bujqësore. Ndaj për parashikimin e sasive të grumbulluara të mbetjeve supozohen këto norma grumbullimi si më poshtë.



Tabela 12 Norma e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Llojet e vendbanimeve	Grumbullimi i mbetjeve [%]
Kryeqyteti i vendit (Tiranë)	85
Kryeqytete me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, > 35,000 banorë)	80
Qendër rajonale e bashkuar (qendra e bashkimit të vendbanimeve, > 20.000 banorë)	
Qendër lokale (qendra e rrethit, jo e formuar nga bashkimet, < 20,000 banorë)	
Zonë periferike metropolitane (brenda zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane të orientuara drejt turizmit	60
Periferi (jashtë zonës metropolitane Tiranë-Durrës)	
Njësi vendore jo-urbane pranë minierave ose burimeve të energjisë	33
Njësi vendore të përziera industriale dhe shërbimesh	
Zona të përziera bujqësore fushore	
Zona të përziera bujqësore malore	
Zona bujqësore fushore	33
Zona bujqësore malore	

Gjithashtu, mbulimi me shërbim pritet të rritet çdo vit me 3 % në zonat bujqësore dhe me 1 % në të gjitha zonat e tjera.

Bazuar në supozimet e përshkruara më sipër, tabela në vijim tregon parashikimin e grumbullimit të mbetjeve në nivel qarku, duke iu referuar të njëjtëve vite si në parashikimet e popullsisë dhe të gjenerimit të mbetjeve. Parashikimi i detajuar mund të gjendet gjithashtu në Shtojcën 1.



Tabela 13 Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve sipas qarqeve

Qark	Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve			
	2018	2022	2027	2032
	[t/v]	[t/v]	[t/v]	[t/v]
Berat	26,516	28,010	29,679	30,874
Dibër	15,212	16,627	18,151	19,263
Durrës	84,703	92,839	103,772	115,614
Elbasan	49,120	53,542	58,817	63,430
Fier	54,557	59,809	66,187	71,992
Gjirokastrë	14,674	15,398	16,269	16,934
Korçë	42,391	45,418	48,941	51,828
Kukës	11,114	11,968	12,915	13,678
Lezhë	24,016	26,495	29,500	31,768
Shkodër	42,490	45,847	49,899	53,348
Tiranë	278,345	312,167	359,150	411,808
Vlorë	54,544	59,603	66,147	72,659
SHQIPËRIA	697,681	767,723	859,428	953,196

Për ta përmbledhur, si sasi të mbetjeve që gjenerohen dhe ato të mbetjeve të grumbulluara parashikohet të rriten gjatë gjithë periudhës së planifikimit. Forcat shtytëse për rritjen e sasisë së gjeneruar të mbetjeve janë padyshim qarqet ku ndodhen qendrat më të mëdha urbane të vendit, përkatësisht Tiranë, Durrës dhe Vlorë. Nga ana tjetër, rritja e parashikuar në sasi të mbetjeve të grumbulluara vjen edhe falë supozimit se do të ketë një përmirësim të përgjithshëm në grumbullimin e mbetjeve. Në tabelën e mëposhtme krahasohet se si parashikohet të zhvillohet në vend gjenerimi i mbetjeve dhe grumbullimi i tyre dhe tregohet se si pritet të zhvillohet norma e grumbullimit të mbetjeve në përqindje.

Tabela 14 Përmbledhje e parashikimeve për gjenerimin dhe grumbullimin e mbetjeve

	Parashikimi i sasisë së mbetjeve			
	2018	2022	2027	2032
	[t/v]	[t/v]	[t/v]	[t/v]
Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve	940,376	955,819	979,173	1,007,159
Parashikimi i grumbullimit të mbetjeve	697,681	767,723	859,428	953,196
Norma e grumbullimit të mbetjeve	74%	80%	88%	95%

3.1.2.3 Përbërja e mbetjeve

Është supozuar kjo përbërje e mbetjeve si në grafikën më poshtë. Ajo bazohet në informacionin zyrtar shqiptar.¹⁶




Figura 4 Përbërja mesatare e mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme me to në Shqipëri (%)

3.1.2.4 Mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet/ Mbetjet inerte

Është përgatitur gjithashtu një vlerësim i status quo për mbetjet nga ndërtimet dhe prishjet/ mbetjet inerte. Është supozuar se të dhënat e paraqitura në statistikat zyrtare (200,000 Mg për 2016, bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë shqiptare) janë tepër të ulëta. Në vend të tyre, është përllogaritur që të gjenerohen 1.9 milion tonë MNP në vit.

3.2 Popullsia dhe shëndeti i njerëzve

3.2.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Aktualisht Shqipëria ka një popullsi prej rreth 3.5 milion banorë. Pak më shumë se 50 % e popullsisë është urbane.

Popullsia është e përqendruar kryesisht në fushën bregdetare dhe në disa lugina kryesore. Në mënyrë të vazhdueshme qytetet kanë ardhur duke u zgjeruar në drejtim të zonave rurale. Sidomos në Shqipërinë qendrore vihet re një shpërthim i fortë urban. Kjo

¹⁶ Shihni Komisioni i Komuniteteve Europiane, për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë: Strategjia Kombëtare Shqiptare e Mbetjeve, Komponenti D – Planet e Menaxhimit Mjedisor, Aktiviteti – Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, Version Draft; Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL; Prill 2010, p. 45

është më e dukshme në korridorin Tiranë-Durrës, ku dy qytetet më të mëdha të vendit po rriten së bashku në një zonë të vetme metropolitane dhe ku jeton të paktën një e treta e popullsisë shqiptare. Vendbanime të tjera të rëndësishme janë Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Fier, Berat, Lushnjë, Kavajë dhe Pogradec.

Zonat malore dhe kodrinore janë të populluara më pak ose rrallë. Shumë nga këto zona thuajse periferike janë prekur nga migrimi i theksuar.

Shqipëria konsiderohet një nga vendet më të ndotura në Europë. Emetimet dhe zonat e ndotura të braktisura ndotin trupat ujore, ujërat nëntokësore, tokën dhe ajrin, sidomos në zonat me popullsi më të dendur.

Një nga arsyet për këtë gjendje është menaxhimi i keq i mbetjeve të ngurta, përfshirë hedhjen e parregullt të mbetjeve dhe djegien e pakontrolluar të tyre në masë të gjerë. Shpesh mbetjet depozitohen në brigjet e lumenjve ose në fusha të hapura. Sot ka vetëm pak vend depozitime që përmbushin standardet e një vend depozitimi sanitar; dhe jo të gjitha prej tyre garantojnë funksionimin e duhur.

Vend depozitimet sanitare në Shqipëri janë në:

- Tiranë (Vend depozitimi i Sharrës)
- Shkodër (Vend depozitimi i Bushatit)
- Sarandë (Vend depozitimi i Bajkaj)
- Korçë (Vend depozitimi i Maliqit)
- Vlorë (në proces përgatitor/ zbatimi)

Përveç tyre, ka filluar funksionimi i një impianti për incinerimin e mbetjeve dhe dy të tjerë janë të planifikuar/ duke u ndërtuar:¹⁷

- Elbasan (në funksionim)
- Tiranë - Durrës
- Fier

Figura 13 paraqet këto impiante ekzistuese MMN.

Megjithëse Shqipëria ka përparuar ndjeshëm në menaxhimin e mbetjeve gjatë viteve të fundit, ndikimet mjedisore dhe shëndetësore të sistemit të tanishëm MMN janë ende serioze:

Ndikimet mjedisore të këtyre impianteve janë të paqarta.

Megjithë përmirësimet në drejtim të mbulimit me grumbullimin e mbetjeve në vitet e fundit, shërbimet e grumbullimit ende nuk i mbulojnë të gjitha zonat e banuara, sidomos në zonat rurale. Ndërkohë që qendrat e qyteteve paraqiten në përgjithësi të pastra, në periferi dhe përgjatë rrugëve shpesh ndesh mbetje të shpërndara, përgje mbetjesh të grumbulluara, sidomos nga ndërtimet. Arsyet për këtë gjendje të pakënaqshme, veçanërisht jashtë qendrave kryesore janë të shumta, duke përfshirë gjendjen e keqe dhe numrin e pamjaftueshëm të pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve (automjete dhe kontenierë). Në rang vendi përlogaritet që aktualisht norma mesatare e grumbullimit të mbetjeve të jetë 74 %.




Figura 5 Mbetje të hedhura të pakontrolluara që përhapen në anët e rrugës (majtas), kontenier mbetjesh i dëmtuar dhe mbetje të përhapura që digjen (djathtas)

Në përgjithësi mund të thuhet se depozitimi jo i duhur i mbetjeve është problemi mjedisor më serioz i menaxhimit aktual të mbetjeve. Problemet kryesore kanë të bëjnë me përzgjedhjen e vendndodhjeve të gabuara (p.sh. në shtratin e lumenjve, brenda qendrave të banuara), mungesën e masave për të kufizuar emetimet (p.sh. mbetjet nuk mbulohen, digjen), hedhjen e mbetjeve nëpër lumenj dhe në burime të rëndësishme ujore dhe punën e dobët në vendgrumbullime, aty ku ka të tilla (nuk ka buxhet, nuk ka pajisje). Edhe aty ku bashkitë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, situata në vendgrumbullimet e mbetjeve në shumicën e rasteve neglizhohet.






Figura 6 Shembuj të vendgrumbullimeve në dy qytete kryesore shqiptare: vendgrumbullimi i mbetjeve i qytetit të Beratit i ndodhur në lumin Osum (majtas), vendgrumbullimi i qytetit të Vlorës me lëngun kullues të mbetjeve dhe endjen e lirë të derrave (djathtas)

Përveç fondeve të pakta, mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit tek popullsia dhe vendimmarrësit duket se është një arsye e rëndësishme për këtë neglizhencë. Madje, edhe në disa vend depozitime që janë ndërtuar sipas standardeve të vend depozitimeve sanitare, funksionimi nuk është në përputhje me standardet e direktivës së BE për vend depozitimet, duke humbur kështu përfitimet e investimit të kryer.

Ndotja nga vendgrumbullimet vijon të mbetet një risk i madh mjedisor në vend, edhe pas mbylljes së tyre. Megjithëse rehabilitimi mund të reduktojë në masë të konsiderueshme ndotjen mjedisore dhe për këtë tashmë janë përgatitur studime të ndryshme fizibiliteti, zbatimi i masave të propozuara në realitet në shumicën e rasteve ka ngelur pezull. Raporti përfundimtar i Zbutjes së Riskut në Vend depozitime, i përgatitur nga MTM paraqet një përmbledhje të përgatitur nga grupi i punës. Ai përfshin një inventar të vendgrumbullimeve ekzistuese dhe propozon masa për rehabilitimin e tyre.

Në parim, në sistemin e tanishëm të MMN mund të evidentohen këto mangësi lidhur me popullsinë dhe shëndetin e njerëzve.



Tabela 15 Mangësitë mjedisore të sistemit të tanishëm MMN sa i përket popullsisë dhe shëndetit të njerëzve

Aktiviteti MMN	Mangësi mjedisore
Nivele të ulëta të grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Shpërndarja e mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter sidomos në zonat ku deri tani nuk ka sistem për grumbullimin e mbetjeve ndikojnë negativisht në situatën higjienike të këtyre zonave Përdorimi ujërave të kontaminuara sipërfaqësore apo nëntokësore si ujë të pijshëm ose ujë për vaditje favorizon futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve dhe/ose të kafshëve
Nivele të ulëta të riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar (përfshi fraksionet e mbetjeve organike)	<ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet informale të ndarjes së mbetjeve (si nëpër kontenierët e mbetjeve brenda vendbanimeve edhe në vendgrumbullime/ vend depozitime) vazhdojnë të zhvillohen në kushte pune të këqija që i ekspozojnë punëtorët informalë ndaj risqeve të shëndetit
Depozitimi në vendgrumbullime të pakontrolluara ose të keqmenaxhuara	<ul style="list-style-type: none"> Mbetjet e shpërndara dhe përgjetet e mbetjeve/ vendgrumbullimet e keqmenaxhuara tërheqin parazitë, të cilët mund të transmetojnë sëmundje tek njerëzit dhe tek kafshët Emetimet e pluhurit dhe të aromave të rënda ndikojnë tek receptorët e ndjeshëm në afërsi Pjesët e lehta të mbetjeve të hedhura/ depozituara ngrihen nga era dhe ndotin zonat përreth Emetimet e lëngut kullues nga vend depozitimet ndotin tokën, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore (me ndotës organikë të qëndrueshëm dhe komponentë të tjerë organikë, metale të rënda dhe kripërat e tyre) Zjarret në vend depozitim (dhe djegia e pakontrolluar e mbetjeve) shkaktojnë ndotje të ajrit si rezultat i djegies së paplotë (formimit të grimcave dhe substancave toksike) Mbetjet e shpërndara dhe vendgrumbullimet e projektuara dhe menaxhuara keq lejojnë hyrjen e kafshëve shtëpiake që ushqehen me lëndën e mbetjeve (përfshirë letrën dhe plastikën), duke nxitur futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve.

3.2.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Për sa kohë nuk ka grumbullim, trajtim dhe depozitim të mbetjeve modern e gjithëpërfshirës në mbarë vendin, pasojat për higjienën publike, shëndetin publik dhe mjedisin janë serioze. Sidoqoftë menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve nuk është i rëndësishëm vetëm për këto tri aspekte, por edhe për reduktimin e gazeve serrë dhe për rrjedhojë mbrojtjen e klimës. Nëpërmjet parandalimit, rikuperimit dhe optimizimit të depozitimit të mbetjeve kursehen burimet dhe energjia dhe reduktohen emetimet e gazit serrë.



Shqipëria kërkon të anëtarësohet në BE dhe për rrjedhojë është në procesin e adoptimit të standardeve të BE si standarde kombëtare. Kështu për Qeverinë Shqiptare ka prioritet të lartë grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve bashkiake në mënyrë të sigurt higjienike, të realizueshme ekonomikisht dhe miqësore ndaj mjedisit. Për të përshpejtuar procesin, Shqipëria ka kërkuar mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë.

Pra mund të supozohet që edhe pa Planin e Investimeve MIMN, menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri do të vazhdojë të zhvillohet dhe të modernizohet. Megjithatë, nëpërmjet hartimit të Planit të Investimeve MIMN mund të realizohet një koordinim i ngushtë i investimeve afatgjata dhe planifikimit të financimeve midis Qeverisë Shqiptare, njësisë të qeverisjes vendore dhe donatorëve, duke mundësuar monitorimin e investimeve dhe financimit afatgjatë.

Qëllimi më i lartë i Planit të Investimeve MIMN është të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, në shëndetin e njerëzve, si edhe në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Në mënyrë më specifike, Plani i Investimeve synon të eliminojë investimet spontane, të cilat nuk janë të bazuara në studime, nuk janë të miratuara nga politikëbërësit, në mënyrë që të parandalohet

- Shpërdorimi i fondeve publike dhe
- Krijimi i pikave të nxehta mjedisore që do të kërkonin fonde dhe burime shtesë për t'u rikthyer në kushte të pranueshme normale.

Synimi i Planit të Investimeve MIMN është që të ofrohen shërbimet MMN në të gjithë vendin, të reduktohen dhe të riciklohen fraksionet përkatëse të mbetjeve, të pakësohet numri i vendgrumbullimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare dhe të mbrohet mjedisi, duke marrë në konsideratë kostot e përgjithshme, për të shmangur mospërputhje midis objektivave dhe kostove që lidhen me qeverinë qendrore dhe qeveritë lokale. Me fjalë të tjera, Plani i Investimeve MIMN synon të garantojë krijimin e mirëmbajtjen e rregullt të një sistemi kombëtar dhe realist MIMN. Pa këtë plan, ekziston risku që investimet të mos bashkërendohen në rang kombëtar ose/ dhe të mos bazohen në financime të qendrueshme. Për pasojë, do të ekzistonte mundësia që popullsia dhe shëndeti i njerëzve do të vazhdonin të ekspozoheshin ndaj risqeve të përshkruara më sipër, që mund të jenë prezente për një kohë të gjatë.



3.3 Biodiversiteti, flora dhe fauna

3.3.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Megjithëse një shtet i vogël, Shqipëria dallohet për një diversitet biologjik të pasur. Larmia e gjeomorfologjisë, klimës dhe terrenit krijojnë kushte të favorshme për shumë specie endemike dhe sub-endemike.

Më shumë se një e treta e territorit të Shqipërisë, rreth 10,000 km², është e pyllëzuar dhe vendi ka një florë të pasur. Rreth 3,000 specie të ndryshme bimësh rriten në Shqipëri. Rajonet bregdetare dhe ultësirat kanë bimësi tipike mesdhetare makia dhe në lartësi më të mëdha shtrihen pyjet e dushkut. Pyje të gjerë të pishës së zezë, ahut dhe bredhit gjenden në male më të lartë dhe kullotat alpine rriten në lartësitë mbi 1,800 m.

Pyjet shqiptare janë strehë për një gamë të gjerë gjitarësh. Brenda Shqipërisë gjenden 91 specie që janë të rrezikuara globalisht ku përfshihen pelikani dalmat, kormoranti pigmi blini European i detit. Rajonet e bregdetit shkëmbor në jug krijojnë habitate të mira për fokën Mesdhetare (monachus) që është specie e rrezikuar. Një nga speciet e shpendëve më të rëndësishme që gjenden në vend është shqiponja e malit (shqiponja e artë), e njohur si simboli kombëtar i Shqipërisë. Pyjet shqiptare ende strehojnë komunitete të rëndësishme gjitarësh të mëdhenj si ariu i murrmë, ujku i përhimë, dhia e egër dhe derri i egër. Në malet në veri dhe lindje të vendit jetojnë rrëqebujt e fundit të Ballkanit, një popullsi e rrezikuar seriozisht e rrëqebullit Euroaziatik.

Sipas informacionit të Agjencisë Kombëtare Shqiptare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Qeveria e Shqipërisë ka ngritur një sistem të Zonave të Mbrojtura.¹⁸ Ky sistem konsiston në Rezerva Strikte Natyrore (IUCN kategoria Ia), Parqe Kombëtare (IUCN kategoria II), Monumente Natyrore (IUCN kategoria III), Parqe Natyrore dhe Rezervate Natyrore të Menaxhuara (IUCN kategoria IV), Peizazhe të Mbrojtur, Zona të Mbrojtura të Burimeve të Menaxhuara (IUCN kategoria VI), si edhe Zona të Mbrojtura Rajonale.¹⁹ Sipas Strategjisë Shqiptare të Zhvillimit të Zonave të Mbrojtura, gjithsej sipërfaqja e zonave të mbrojtura parashikohej të ishte 18 përqind e territorit shqiptar deri në fund të 2016.

¹⁸ Për më shumë informacion shihni Agjencinë Kombëtare Shqiptare të Zonave të Mbrojtura: Zonat e Mbrojtura, http://www.akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&d=30&Itemid=433&lang=us, sipas datës 19 Qershor 2017.

¹⁹ Për më shumë hollësi lidhur me kategoritë e zonave të mbrojtura sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës IUCN q v. <https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about/protected-areas-categories>



Megjithatë, mungesa e mjeteve financiare dhe numri i kufizuar i stafit e bën të vështirë zbatimin e planeve dhe objektivave.²⁰

Zonat e mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri tregohen në figurën e mëposhtme. Zonat e mbrojtura janë si vijon:

- I: Rezervat Strikt Natyror
- II: Parqe Kombëtare
- III: Monumente Natyrore
- IV: Rezervat Natyror i Menaxhuar
- V: Peizazhe të Mbrojtur
- VI: Zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara



²⁰ Qv. Agjencia Kombëtare Shqiptare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) Strategjia e Zhvillimit e ZM; http://www.akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=item&id=125_strategjia-e-zhvillimit-e-zm&Itemid=426&lang=us, sipas dt 19 Qershor 2017.






Figura 7 Harta e zonave të mbrojtura më të rëndësishme në Shqipëri



Caktimi i Zonave të Mbrojtura të reja ka ndikuar në ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit brenda dhe përreth këtyre zonave që përgjithësisht duken të mbrojtura mirë. Megjithë ndikimin pozitiv të ZM të reja në biodiversitet, aktualisht ato ende përballesh me probleme dhe sfida të ndryshme:

- Degradimi i habitatit nga erozioni i brigjeve;
- Prerja e paligjshme e pyjeve;
- Peshkimi dhe gjuetia e paligjshme e shpendëve dhe kafshëve të egra;
- Menaxhimi jo-efikas i aktiviteteve çlodhëse.

Këto janë çështje kritike që kërkojnë më shumë përpjekje.

Për të mbrojtur ZM dhe florën e faunën shqiptare, në ZM dhe zonat e tyre buferike nuk mund të ndërtohet infrastrukturë për MMN. Po ashtu, organizimi i duhur i MMN bashkiak duhet të ndihmojë në mbrojtjen e natyrës nga ndikimet negative.

Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN që kanë të bëjnë me biodiversitetin, florën dhe faunën paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 16 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket biodiversitetit, florës dhe faunës

Aktivitetet MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e pakontrolluar e tyre ndotin mjedisin/ peizazhin dhe për rrjedhojë mund të ndikojë në zonat e mbrojtura apo me vlerë ekologjike • Ujërat sipërfaqësore apo nëntokësore të kontaminuara mund të jenë të dëmshme për zonat a speciet e mbrojtura
Depozitimi i mbetjeve në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> • Kundërvënie të tjera mund të lindin nga përzgjedhja e gabuar e vendndodhjeve, p.sh. për impiantet e depozitimit të mbetjeve

3.3.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Sa i përket menaxhimit të mbetjeve, zhvillimi i ardhshëm i biodiversitetit, florës dhe faunës do të ndikohet në veçanti nga zbatimi i masave dhe projekteve që janë në proces. Si rezultat, mund të priten përmirësime, edhe lidhur me mbrojtjen/ përmirësimin e gjendjes së zonave të mbrojtura.

Nëse Plani i Investimeve MIMN nuk zbatohet, duhet t'i trembemi faktit që ndikimet e dëmshme ekzistuese nuk mund të kontrollohen në rang kombëtar dhe në disa rajone mund të shkaktohen dëme në florë dhe faunë nga emetimi i ndotësve.



3.4 Përdorimi i dheut dhe tokës si edhe asetëve materiale

3.4.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Rreth gjysmën e territorit shqiptar e zënë malet me lartësi mbi 600 m, por vetëm një pjesë e vogël është zonë malore e lartë. Nga liqeni i Shkodrës në veri deri në Vlorë në jug, përgjatë bregdetit shtrihen toka aluviale me gjerësi vetëm pak kilometra; në Shqipërinë qendrore, ato zgjerohen për të formuar Fushën e Madhe të Myzeqesë. Veç kësaj, në bregdet ka një numër të madh lagunash dhe ligatinash.

Vetëm luginat, zonat kodrinore, disa pjesë të fushës bregdetare dhe disa pllaja bëjnë të mundur vendbanime me popullsi të dendur. Atje, dendësia e popullsisë është pak a shumë e lartë, ndërsa në pjesët e tjera të vendit ka përqendrim më të rrallë të popullsisë.

Zhvillimi i vendbanimeve ka pësuar rënie këto 10 vitet e fundit krahasuar me një dekadë më parë. Tani urbanizimi është nxitur kryesisht nga ndërtimi i autostradave në pjesën veriore të vendit dhe gjithashtu nga zgjerimi i njësive industriale dhe tregtare në zonat përreth kryeqytetit Tiranë dhe qytetit të Durrësit.²¹

Infrastruktura në zonat rurale është disi e varfër. Megjithëse rrugët kryesore janë rehabilituar dhe përmirësuar, në zonat rurale një pjesë e madhe e rrugëve të transportit është ende në gjendje të keqe. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike, si edhe menaxhimi i mbetjeve e higjiena publike është shpesh e pamjaftueshme në zonat rurale.

Në Shqipëri erozioni i tokës²² mbetet një kërcënim i përhershëm ndaj stabilitetit të tokës dhe një problem mjedisor i vazhdueshëm për bujqësinë.²³

Bujqësia është një nga sektorët ekonomikë më të rëndësishëm të Shqipërisë. Më shumë se ¼ e sipërfaqes totale të Shqipërisë përdoret për qëllime bujqësore.²⁴ Dominon blegtoria.²⁵

²¹ Shihni Agjencinë Europiane të Mjedisit: Mbulimi i tokës 2012; Shqipëria, Shtator 2017.

²² Disa nga faktorët që ndikojnë erozionin janë kushtet klimatike, si reshjet (sasia, intensiteti, frekuenca), temperatura, karakteristikat fizike të tokës, kushtet e relievit (pjerina) dhe përdorimi i tokës, mbulesa bimore dhe degradimi (shpyllëzimi, zjarret, mbikullojtja, etj.), modifikimet e topografisë (ndërtimi i rrugëve, qendrave urbane, etj.) dhe politika e menaxhimit të ujit (kanalizimet, punimet hidrike, argjinaturat, etj.)

²³ Shihni Ministrinë Shqiptare të Mjedisit: Komunikata e Tretë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë sipas Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike; Tiranë, Qershor 2016.

²⁴ Shihni Agjencinë Europiane Mjedisore: Mbulimi i tokës 2012; Shqipëria, Shtator 2017.

²⁵ Gjithashtu, rreth gjysma e produkteve nga kultivimi i tokës përdoret si ushqim për bagëtinë.

Prodhimtaria në bujqësi është e ulët. Megjithëse gati ½ e fuqisë punëtore shqiptare punon në bujqësi, ajo gjeneron vetëm 1/5 të GDP, pasi pjesa kryesore e bujqësisë është e zhvilluar si ekonomi për të siguruar jetesën e familjes.

Shqipëria ka shumë lëndë të para: Kromi është një lëndët e para më të rëndësishme në vend. Gjithashtu ka depozita të mëdha nikeli, bakri, qymyrguri, gipsi, guri gëlqeror, torfe, bazalti, gur shtufi dhe argjile. Për arsye të ndryshme, shumë prej këtyre lëndëve rrallë nxirren. Përveç tyre, Shqipëria ka edhe rezerva gazi dhe naftë shumë pak të shfrytëzuara.

Grafiku i mëposhtëm tregon përdorimin e tokës në Shqipëri, bazuar në informacionin e raportit të fundit për mbulimin e tokës.




Figura 8 Mbulimi i tokës shqiptare në 2012 [% e totalit]

Për përdorimin e dheut dhe tokës, mund të përmblihen mangësitë mjedisore si më poshtë lidhur me menaxhimin ekzistues të mbetjeve.

Tabela 17 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual të MMN sa i përket përdorimit të dheut dhe tokës

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Përhapja dhe hedhja pa kriter e mbetjeve ndotin tokën dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore Përdorimi i ujërave të kontaminuara sipërfaqësore a nëntokësore si ujë për vaditje rrezikon futjen e ndotësve në zinxhirin ushqimor të njerëzve dhe/ ose kafshëve

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar (përfshi fraksionet e mbetjeve organike)	<ul style="list-style-type: none"> • Normat e ulëta të riciklimit çojnë në një shfrytëzim të përgjithshëm/ global të burimeve natyrore
Depozitimi i mbetjeve në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> • Emetimet e lëngut kullues nga vend depozitimet dhe vendgrumbullimet ndotin tokën • Pjesëzat e lehta të mbetjeve të hedhura ngrihen nga era dhe ndotin zonat përreth dhe mund të kenë ndikim negativ në disa përdorime të tokës (banesa, bujqësia) • Kafshët shtëpiake mund të futen në vendgrumbullime dhe vend depozitime të pakontrolluara/ të menaxhuara keq dhe të ushqehen me lëndën e mbetjeve • Vendet e gabuara që caktohen për impiante depozitimi mbetjesh mund të sjellin përplasje me përdorimet e tjera të tokës, si banesat, bujqësia apo aktiviteti i minierave

3.4.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Në këndvështrimin e risqeve që sjell menaxhimi aktual i mbetjeve, zhvillimi i mundshëm i përdorimit të dheut dhe tokës karakterizohet në veçanti nga futja e ndotësve, duke pasur ndikim negativ në funksionet dhe cilësinë e tokës (dheut). Po ashtu, pretendimet për tokën për impiante MMN mund të sjellin kundërvënie me përdorimet e tjera të tokës. Këto rreziqe janë sidomos të pranishme në ato rajone ku nuk janë planifikuar apo nuk po zhvillohen projekte MMN.

Moszbatimi i Planit të Investimeve MIMN do të rezultojë në risqe serioze siç janë përshkruar më lart, veçanërisht lidhur me futjen e ndotësve.

3.5 Uji

3.5.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Shqipëria ka afërsisht 362 km vijë bregdetare përgjatë deteve Adriatik dhe Jon.

Vendi është i pasur me burime ujore. Baseni hidrografik që ushqen rrjedhat ujore të Shqipërisë ka një sipërfaqe totale prej 43,305 km².²⁰

²⁰ UNECE, 2012 Vlerësimi i Performancës Mjedisore të Shqipërisë – Shqyrtimi i dytë

Shtatë lumenj dhe degë të tyre derdhen në detin Adriatik. Lumi më i gjatë është Drini me gjatësi 282 km. Një total prej 250 liqenesh zënë 4 % të territorit shqiptar.

Lumenjtë e Shqipërisë janë një burim i rëndësishëm për hidrocentralet. Ka gjithsej 5 rezervuarë mbi dy lumenjtë e mëdhenj të Drinit dhe Matit. Mbi lumin Devoll janë duke u ndërtuar dhe planifikuar disa diga. Edhe shumë lumenj të tjerë më të vegjël përdoren për prodhim energjie.

Në periudhën e komunizmit, rezervuarë të vegjël për vaditje janë ndërtuar në gjithë vendin, së bashku me një rrjet të gjerë kanalesh vaditëse. Gjithashtu, përpara Luftës së Dytë Botërore, pllajtat bregdetare moçalishte kulloheshin në mënyrë sistematike për të zgjeruar sipërfaqen bujqësore.

Përmbytjet ndodhin jo vetëm për shkak të shkrirjes së dëborës, por edhe pas shirave të dendur. Arsyet për këtë janë të shumta; përfshi edhe efektet e bllokimit të rrjedhave ujore, ndër të tjera nga mbetjet që shtyhen nga uji nëpër lumenj dhe kanale.

Për të vlerësuar cilësinë e ujit, si sipërfaqësor edhe nëntokësor, të dhënat e tanishme nga monitorimi i cilësisë dhe sasisë së burimeve ujore janë të pamjaftueshme. Në themel mund të thuhet që shumica e lumenjve janë të ndotur në rrjedhën e tyre të mesme dhe të poshtme. Nga ana tjetër shumica e trupave ujore nëntokësore paraqitet me cilësi të mirë, megjithëse nuk ka të dhëna të mjaftueshme nga monitorimi për të vlerësuar ndotjen e tyre të mundshme, p.sh. me metale të rënda.²⁷

Cilësia e ujit në plazhet përgjatë bregdetit shqiptar monitorohet rregullisht:²⁸ 84.3 % e të gjitha ujërave bregdetare ishin brenda standardeve minimale të cilësisë në 2017. 12 vende plazhi u klasifikuan si dobët, gjë që tregon përmirësim krahasuar me vitet e fundit.

Për ta përmbledhur, mund të identifikohen këto mangësi mjedisore të menaxhimit aktual të mbetjeve sa i përket ujit.

Tabela 18 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket ujit

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Përhapja dhe hedhja e çrregullt e mbetjeve ndotin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore Mbetjet që merren nga uji nëpër lumenj çojnë në bllokimin e tyre dhe në fund grumbullohen në det

²⁷ Shihni UNECE Shqipëria – Vlerësimi i Performancës Mjedisorë (Albania – Environmental Performance Reviews); New York and Geneva 2018.

²⁸ Shihni Agjencinë Europiane të Mjedisit: Cilësia e ujit të plazheve në Shqipëri 2017 (European Environment Agency: Albanian bathing water quality in 2017); Albania, Maj 2018.

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Depozitimi në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> Emetimet e lëngut kullues nga vend depozitimet ndotin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore (me ndotës organikë të qëndrueshëm dhe komponentë të tjerë organikë, metale të rënda dhe kripërat e tyre)

3.5.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Zhvillimi i mundshëm i burimeve ujore ndikohet, ndër të tjera, nga masat/ projektet aktuale apo të planifikuara për MMN. Një nga objektivat e zbatimit të këtyre masave/ projekteve është të reduktohet ndotja e ujit nga lëngu kullues në të ardhmen dhe në këtë mënyrë të ndihmohet arritja dhe mbajtja e një statusi të mirë ekologjik dhe kimik të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Sfida të veçanta në këtë drejtim paraqesin vendgrumbullimet ekzistuese të mbetjeve, të cilat kanë nevojë urgjente për t'u rehabilituar.

Nëse Plani i Investimeve MIMN nuk zbatohet, është e pritshme që risqet ekzistuese të vazhdojnë të jenë të pranishme, të paktën pjesërisht. Kjo ka të bëjë si me riskun e ndotjes së ujit nëntokësor dhe sipërfaqësor nga lëngu kullues i mbetjeve, ashtu edhe me risqet e depozitimit të paligjshëm në rrjedhat ujore dhe me erozionin e mbetjeve të depozituara në vend depozitimet ekzistuese në vendndodhje të papërshtatshme.

3.6 Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë

3.6.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Pozita gjeografike e Shqipërisë përcakton klimën e saj mesdhetare, që karakterizohet nga dimër i butë dhe i lagësht dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore në Shqipëri është 16°C. Rreshjet e shiut bien kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit; sasia mesatare vjetore e rrëshjeve është vetëm pak më pak se 1,200 milimetra.

Kushtet klimatike ndryshojnë ndjeshëm sipas rajoneve: ultësirat bregdetare kanë një ndikim të fortë detar, që shkakton një rënie graduale të temperaturave dhe pakësim të rreshjeve nga bregu në drejtim të lindjes. Dimrat janë të ashpër në rajonet malore veriore dhe lindore. Në këto zona, në dimër shumë vende izoloohen nga pjesa tjetër e vendit për muaj të tërë për shkak të dëborës.

Megjithëse rrjeti i tanishëm i monitorimit të cilësisë së ajrit nuk na lejon të krijojmë një pamje të saktë të cilësisë së përgjithshme të ajrit në Shqipëri, supozohet që cilësia e ajrit është përmirësuar shumë gjatë dekadës së fundit.



Numri i stacioneve ekzistuese të monitorimit është i kufizuar. Sidoqoftë, është evidentuar një ulje e nivelit të oksideve të sulfurit (SO₂) dhe amoniakut. Nga ana tjetër, janë rritur emetimet e oksideve të azotit (NO₂), të përbërësve organikë jo-metan të paqendrueshëm si edhe të lëndës së grimcuar (PM 10, PM 2.5).²⁹ Sidoqoftë, meqë Shqipëria ka reduktuar përdorimin e lëndëve djegëse për prodhim energjie dhe për proceset industriale dhe ka prezantuar standardet europiane për cilësinë e karburantit, është e pritshme që edhe niveli i këtyre emetimeve të përmirësohet në të ardhmen. Që në periudhën 2011 – 2013 në stacionet e monitorimit në Tiranë është vënë re një rënie prej 20 – 30 % në nivelin e koncentrimit të lëndës së grimcuar PM 10 dhe PM 2.5, falë përmirësimeve të bëra në infrastrukturë dhe ndërmarrjes së disa masave legislative.³⁰

Figurat e mëposhtme tregojnë përqendrimet mesatare të matura të ndotësve të ajrit në Shqipëri.³¹




Figura 9 Përqendrimi mesatar i SO₂, NO₂, O₃ dhe PM 10 në Shqipëri krahasuar me vlerat limit të rekomanduara nga OBSH dhe ato të caktuara nga BE [2016]

²⁹ Shihni UNECE Shqipëria – Vlerësimi i Performancës Mjedisore (Albania – Environmental Performance Reviews, Third Review), New York and Geneva, 2018.

³⁰ Shihni Agjencinë Europiane të Mjedisit (European Environment Agency): Albania Country Briefing – The European Environment – State and Outlook 2015.

³¹ Shihni UNECE Shqipëria – Vlerësimi i Performancës Mjedisore (Albania – Environmental Performance Reviews), Third Review, New York and Geneva, 2018.




Figura 10 Përqendrimi mesatar vjetor i PM 10 në disa qytete të përzgjedhura [2016]

Në Shqipëri, nuk është vlerësuar ndikimi në shëndet nga ndotja e ajrit. Për pasojë, popullsia dhe veçanërisht grupet e ndjeshme nuk marrin të dhëna të mjaftueshme dhe në kohën e duhur për cilësinë e ajrit, të shoqëruar me rekomandime për mbrojtjen e shëndetit.³²

Duke parë emetimet e gazit serrë (GHG), mund të thuhet se totali i emetimeve shqiptare të GHG është relativisht i ulët: 9,036.8 Gg CO₂ eq. në vitin 2009. Por duhet të përmendet fakti se dokumentet/ të dhënat më të fundit zyrtare, si Komunikata e Tretë Kombëtare e vendit për Ndryshimin e Klimës e vitit 2016 bazohen në të dhëna relativisht të vjetra që nga viti 2009, duke iu referuar gjendjes bazë të vitit 2005.³³ Sa i përket CO₂ eq., sektori i mbetjeve zë pak më shumë se 7 %. Figura e mëposhtme paraqet një përmbledhje të emetimeve të CO₂ eq. nga të gjithë sektorët ekonomikë të Shqipërisë për vitin 2005. Supozohet se kontribuesi kryesor në emetimin e GHG në sektorin e mbetjeve është depozitimi i mbetjeve të ngurta.³⁴

³² Shihni UNECE: Shqipëria – Vlerësimi i Performancës Mjedisore (Albania – Environmental Performance Reviews, Third Review); New York and Geneva, 2018.

³³ Shihni UNECE: Shqipëria – Vlerësimi i Performancës Mjedisore (Albania – Environmental Performance Reviews, Third Review); New York and Geneva, 2018.

³⁴ Shihni Ministrinë Shqiptare të Mjedisit: Komunikata e Tretë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë në Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Tiranë, Qershor 2016






Figura 11 Emetimet CO2 eq. nga të gjithë sektorët ekonomikë për vitin 2005 [%]

Bazuar në sistemin ekzistues MMN, janë vënë re këto mangësi mjedisore.

Tabela 19 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket cilësisë së ajrit dhe faktorët klimatikë

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Hedhje pa kriter dhe djegie e mbetjeve veçanërisht në zonat ku nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve (emetime të pluhurit, aromave dhe gazit)
Norma të ulëta të riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar (përfshi fraksionet e mbetjeve organike)	<ul style="list-style-type: none"> Ndikimi negativ në ndryshimet klimatike, pasi nuk përdoren potencialet për të shmangur emetimet e GHG nëpërmjet riciklimit të burimeve natyrore apo reduktimit të emetimeve të metanit nga mbetjet organike
Depozitimi në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> Emetimet e gazit metan nga vend depozitimet dhe vendgrumbullimet Emetimet e pluhurit dhe aromave të rënda Zjarret në vendgrumbullime shkaktojnë ndotje të ajrit që vjen nga djegia e paplotë Kundërvënie të tjera që lidhen me zgjedhjen e gabuar të impianteve MMN

3.6.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Zhvillimi i mundshëm i cilësisë së ajrit dhe faktorëve klimatikë do të karakterizohet nga zhvillimi i mëtejshëm global i ndryshimeve klimatike dhe nga zbatimi i mëtejshëm i masave për të reduktuar emetimin e ndotësve të ajrit. Në nivel global, përqendrimi i GHG në atmosferë do të vazhdojë të rritet. Në nivel kombëtar, nuk pritet që emetimet e ndotësve të ajrit të ulen ndjeshëm ndërkohë që zhvillimi i Shqipërisë përparon. Zbatimi/



përdorimi i teknologjive të avancuara dhe pajtueshmëria me standardet kombëtare dhe europiane mund të ndihmojnë në zbutjen e efekteve.

Nëse Plani i Masave MIMN nuk zbatohet, duhet t'i druheni faktit se zbatimi i menaxhimit të integruar të avancuar dhe të qendrueshëm të mbetjeve nuk do të mbështetet në mbarë vendin. Përmirësimet vendore/ rajonale ka mundësi të arrihen aty ku tashmë janë planifikuar ose ka filluar zbatimi i projekteve/ masave, ndërsa situata në rajonet e tjera nuk do të ndryshojë ose madje do të përkeqësohet.

3.7 Peizazhi

3.7.1 Gjendja mjedisore dhe problemet kyç

Territore të mëdha të vendit karakterizohen nga natyra e virgjër dhe peizazhe të larmishme. Për sipërfaqen e dhënë, Shqipëria është një nga shtetet më biodiversë në Europë. Ajo është pjesë e atyre që njihen si "Brez i Gjelbër i Europës" dhe "Zemra Blu e Europës". Megjithëse ka një peizazh të larmishëm, pjesërisht të paprekur dhe një biodiversitet të pasur, ajo përballet me një sërë problemesh mjedisore, përfshirë mbikullotjen, shpyllëzimin, gjuetinë e paligjshme dhe mbipeshkimin.

Zgjerimi urban dhe ndotja mjedisore (si niveli i ulët i grumbullimit apo hedhjet e paligjshme të mbetjeve), sidomos në zonat urbane përgjatë bregdetit dhe në luginat kryesore të lumenjve, janë një fenomen i kudogjendur në Shqipëri.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbetjeve ka këto mangësi mjedisore sa i përket peizazhit.

Tabela 20 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual sa i përket peizazhit

Aktiviteti MMN	Mangësitë mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e çrregullt e tyre sidomos në zonat ku nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit ndikojnë negativisht në pamjen e përgjithshme Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e çrregullt e tyre ndotin peizazhin (përfshi ndikimin negativ tek turizmi)
Niveli i ulët i riciklimit dhe mungesa e grumbullimit të diferencuar (përfshi fraksionet e mbetjeve organike)	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e sasive të mbetjeve që duhen depozituar
Depozitimi në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> Emetimet e pluhurit dhe aromave të rënda ndikojnë receptorët e ndjeshëm në afërsi Pjesët e lehta të mbetjeve të depozituara merren nga era dhe ndotin ambientin përreth



3.7.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve

Është e pritshme që urbanizimi do të vazhdojë dhe kjo do të rritë presionin mbi peizazhin dhe mjedisin në zonat urbane. Në të njëjtën kohë, pritet që zonat rurale, veçanërisht ato më të largëta do të vazhdojnë të shpopullohen, çka do të ketë një ndikim pozitiv në peizazh dhe mbrojtjen mjedisore. Supozohet që këta faktorë dhe të tjerë do të kenë një ndikim të fortë në zhvillimin e peizazhit.

Për rrjedhojë, moszbatimi i Planit të Investimeve MIMN do të sjellë vetëm disa ndikime të vogla vendore/ rajonale, më së shumti në zonat e largëta të vendit.

3.8 Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore

3.8.1 Gjendja mjedisore dhe probleme kyç

Shqipëria mbart shumë monumente me vlerë dhe peizazhi shqiptar karakterizohet nga prania e kështjellave, fortesave dhe kalave. Monumente arkitekturore të shenjta, si katedralet dhe kishat, xhamitë dhe teqetë gjenden në të gjithë vendin nga epoka të ndryshme. Peizazhi arkitekturor është pasuruar nga zbulimet arkeologjike.

Shqipëria ka tre vende të përfshira në Listën e Vendeve (Siteve) të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s:³⁵

- Butrinti (vend kulturor),³⁶
- Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës (vende kulturore)³⁷ dhe
- Pyjet e Lashtë të Ahut Primar të Karpateve dhe Rajoneve të Tjera të Europës (vend natyror, pasuri ndërkufitare)³⁸



³⁵ Shihni UNESCO: Lista e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List), <http://whc.unesco.org/en/list/>

Shihni UNESCO: Lista e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List), <https://whc.unesco.org/en/list/570>

³⁷ Shihni UNESCO: Lista e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List), <https://whc.unesco.org/en/list/569>

³⁸ Shihni UNESCO: Lista e Trashëgimisë Botërore (World Heritage List), <https://whc.unesco.org/en/list/1133>




Figura 12 Vendet (sitet) e trashëgimisë botërore të UNESCO-s në Shqipëri (majtas: Butrinti, në mes: Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, djathtas: Pyjet e Ahut Primar të Karpateve)

Vende të tjera në Listën e pritjes për t'u shpallur Trashëgimi Botërore e UNESCO-s janë:³⁹

- Varret mbretërore të Selcës së Poshtme
- Amfiteatri i Durrësit
- Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit
- Qyteti i Lashtë i Apollonisë
- Kalaja e Bashtovës

Përveç tyre, Kodikët e Beratit (Codex Beratinus) janë regjistruar në Regjistrin e Kujtesës së Botës të UNESCO.⁴⁰

Mund të supozohet që në Shqipëri ka edhe shumë site të tjera të trashëgimisë arkitekturore, kulturore dhe në veçanti arkeologjike, të cilat as nuk njihen as nuk janë të regjistruara plotësisht në autoritetet përgjegjëse. Këto monumente të supozuara kulture duhet të mbrohen po aq sa ato të njohurat, jo vetëm për shkak të rëndësisë së tyre për trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, por edhe për potencialin e tyre për zhvillimin e turizmit kulturor në vend.

³⁹ Shihni UNESCO Lista e pritjes (Tentative Lists), <https://whc.unesco.org/en/tentativelists/state=all>

⁴⁰ Shihni UNESCO Kujtesa e Botës (Memory of the World), <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/memory-of-the-world/register/full-list-of-registered-heritage/registered-heritage-page-2/codex-purpureus-beratinus/>

Mangësitë mjedisore mund të vijnë si pasojë e sistemit aktual MMN dhe mund të kenë ndikim negativ në trashëgiminë kulturore, siç paraqitet e përmbledhur më poshtë:

Tabela 21 Mangësitë mjedisore të sistemit aktual MMN sa i përket peizazhit

Aktiviteti MMN	Mangësi mjedisore
Niveli i ulët i grumbullimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> Përhapja e mbetjeve dhe hedhja e çrregullt e tyre, sidomos në zonat ku deri tani nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve ndikojnë negativisht në zonat përreth (p.sh. ndikimi pamor nga mbetjet e shpërndara) Përhapja dhe hedhja e çrregullt e mbetjeve ndotin zonat përreth (si sheshet qendrore, rrugët dhe vendet e rëndësishme historike)
Depozitimi në vendgrumbullime të keqmenaxhuara apo të pakontrolluara	<ul style="list-style-type: none"> Emetimet e pluhurit dhe aromave të rënda ndikojnë receptorët në afërsi dhe përdorimet e tokës Pjesët e lehta të mbetjeve të depozituara ngrihen nga era dhe ndotin zonat përreth Kundërvëniet e tjera të mundshme që lidhen me përzgjedhjen e gabuar të vendndodhjeve për impiantet MMN

3.8.2 Zhvillimi i mundshëm i mjedisit pa Planin e Investimeve MIMN

Nuk mund të parashikohen tendencat e përgjithshme për zhvillimin e mundshëm të trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore. Risku ekzistues për këto asete do të vazhdojë pavarësisht zbatimit apo mos-zbatimit të Planit të Investimeve MIMN, pasi ato janë më pak të ndikuara nga MMN sesa nga faktorë të tjerë.

Sidoqoftë, përmirësimi i situatës së përgjithshme mjedisore nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve do të ketë një ndikim pozitiv edhe në zhvillimin e trashëgimisë arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore.

4 Vlerësimi i ndikimeve mjedisore

4.1 Vlerësimi i alternativave

Si pjesë e procesit të VSM kërkohet të kryhet një vlerësim i alternativave të arsyeshme. Për shkak të natyrës strategjike të Planit të Investimeve MIMN dhe efektet në shkallë të gjerë të tij, në fazën e Hartimit të Teknologjive janë marrë në konsideratë dhe janë diskutuar alternativa të ndryshme të teknologjisë për menaxhimin e mbetjeve lidhur me aspektet e mëposhtme:

- Ndikimet e politikës dhe kuadrit rregullator
- Identifikimi i alternativave që janë konform politikave dhe të testuara



- Fizibiliteti financiar i teknologjive të testuara

Pas deduktimit të ndikimeve të politikave dhe kuadrit rregullator, u identifikuan këto alternativa të teknologjisë që janë konform politikave.

Tabela 22 Alternativat e marra në konsideratë

	Mbetje të përziera		Mbetje të ndara	Mbetje inerte
Pastrimi i rrugëve	Pastrimi i rrugëve			Menaxhimi i mbetjeve inerte
Grumbullimi i mbetjeve	Grumbullimi i mbetjeve		Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	
Transferimi dhe transportimi	Transferimi dhe transportimi			
Trajtimi mekanik	IRM e papastër	Trajtimi mekanik-biologjik (TMB)	IRM e pastër	
Trajtimi biologjik	Tharja biologjike		Kompostimi, tretja	
Trajtimi termik	Incinerimi, Piroлиза, Gazifikimi, Trajtimi plazma, Teknologjia e prodhimit të naftës nga mbetjet			
Depozitimi	Vend depozitim sanitar, rehabilitim i vend depozitimeve			

Fokusi kryesor ishte në identifikimin dhe përzgjedhjen e teknologjive të provuara (eksperiencia afatgjata në ndërtim dhe funksionim) dhe shqyrtimi i mundësisë financiare për t'u realizuar (duke qenë në sinergji me projekte të tjera në zbatim dhe të planifikuara që financohen nga donatorë).

Teknologjitë e reja për trajtimin e mbetjeve për prodhim energjie, si gazifikimi dhe piroliza, janë njohur si procese për një kohë të gjatë, por vetëm për lëndë djegëse të mirëpërcaktuara si qymyrguri apo druri. Përvoja në drejtim të trajtimit të mbetjeve bashkiake vijon të jetë e kufizuar. Për ta përmbledhur, mund të thuhet se gazifikimi, piroliza, trajtimi plazma dhe prodhimi i naftës nga mbetjet nuk janë teknologji të provuara në periudhë afatgjatë për trajtimin e mbetjeve bashkiake dhe për këtë arsye janë përjashtuar (të shkruara me ngjyrë të kuqe në tabelën më sipër). Plani i Investimeve MIMN bazohet në teknologjitë e identifikuar, të shkruara në tabelën më sipër me ngjyrë të zezë.

Plani i Investimeve MIMN është hartuar mbi masat bazë për një menaxhim të integruar e modern të mbetjeve në Shqipëri. Zbatimi fizik i masave të propozuara kërkon studime specifike (si p.sh. studime fizibiliteti) dhe projekte të detajuara. Kjo do të realizohet vetëm në procedurat e planifikimit dytësor dhe të miratimit.

Ky studim i VSM përcakton kuadrin për vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe evidenton ato aspekte që duhen marrë në konsideratë. Këto duhet të kihet parasysh gjatë zgjedhjes së masave individuale dhe, nëse është e nevojshme, gjatë përzgjedhjes së vendndodhjeve për zbatimin e tyre.

Në përgjithësi, efektet mjedisore lokale mund të përcaktohen qartë vetëm duke marrë për bazë të dhëna/ informacion të detajuar me një referencë hapësinore bazuar në projektet/ planifikimin e detajuar. Nëse shfaqen ndikime mjedisore negative serioze, duhet të shqyrtohen mundësi të tjera në procedurat vijuese të planifikimit dhe miratimit.

4.2 Qasja metodike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Studimi VSM identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e mundshme negative të mjedisit dhe paraqet, aty ku duhet, masat për t'i parandaluar dhe zbutur këto ndikime.

Temat e mbrojtjes që duhet të merren parasysh renditen në Tabela 6:

- popullsia dhe shëndeti i njerëzve,
- biodiversiteti, flora dhe fauna,
- përdorimi i dheut dhe tokës si edhe aseteve materiale,
- uji,
- cilësia e ajrit dhe faktorëve klimatikë,
- trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore, si edhe
- peizazhi

duhen marrë parasysh edhe ndërveprimet midis këtyre aspekteve të mbrojtjes.

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore duhet të shihet në kontekstin e mëposhtëm:

- Ndikimet mjedisore mund të vlerësohen vetëm deri në masën e specifikuar në Planin e Investimeve MIMN. Nëse nevojiten referenca specifike hapësinore dhe/ ose dokumente planifikues të detajuar, vlerësimi përkatës do të bëhet gjatë procedurave të mëtejshme të planifikimit dhe miratimit.
- Për vlerësimin mjedisor supozohet se masat janë planifikuar dhe zbatohen sipas teknologjisë më të mirë të disponueshme. Përshkrimi i hollësishëm i



secilës masë teknike të dhënë në Raportin Teknik të projektit shërben si bazë për vlerësimin.

Identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor janë kryer bazuar në profilet e VSM për masat e listuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela 23 Masat e marra në konsideratë në profilet e VSM

Lloji i masave/ Shkurtimi	Përshkrimi
ZeM	Përcaktimi i Zonave të Mbetjeve
R	Komponentët rajonalë të menaxhimit të mbetjeve
R01	Transferimi i mbetjeve dhe transporti në distancë të largët
R01-01	Stacion transferimi me rampë
R01-02	Stacion transferimi me rampë dhe me njësi kompaktore
R02	Trajtimi mekanik (IRM)
R02-01	IRM e papastër (mbetje të përziera)
R02-02	IRM e pastër (mbetje të ndara)
R03	Trajtimi mekanik-biologjik (TMB)
R03-01	TMB me tretje anaerobike
R03-02	TMB me stabilizim
R03-03	TMB me kompostim
R04	Tretja anaerobike
R05	Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)
R05-01	Incinerimi me skarë të lëvizshme
R06	Vend depozitim sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve)
R06-01	Vend depozitim sanitar
R06-02	Rehabilitim i vend depozitimit
L	Komponentët vendorë të menaxhimit të mbetjeve
L01	Pastrimi i rrugëve
L01-01	Fshirja manuale e rrugëve
L01-02	Fshirja mekanike e rrugëve
L02	Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)
L02-01	Grumbullimi i mbetjeve të përziera
L02-02	Grumbullimi i mbetjeve organike
L02-03	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata
L03	Kompostimi (rikuperim materiali)
L03-01	Impiant kompostimi në kavaleta
L03-02	Impiant kompostimi i mbyllur i automatizuar plotësisht



Lloji i masave/ Shkurtimi	Përshkrimi
L04	Menaxhimi i mbetjeve inerte
L04-01	Trajtimi me pajisje të lëvizshme
L04-02	Trajtimi stacionar
L04-03	Depozitimi në vend depozitim

Masat janë vlerësuar sa i përket ndikimit të tyre të përgjithshëm. Kushtet lokale specifike përkatëse nuk janë marrë parasysh për këtë vlerësim.

Ndikimet e këtyre masave do të përcaktohen, përshkruhen dhe do të vlerësohen kundrejt objektivave mjedisore të përcaktuar në kapitullin 2 për aspektet e mbrojtjes të listuara në Tabela 8 në përputhje me këtë klasifikim.

Tabela 24 Klasifikimi i ndikimeve mjedisore

Simboli	Klasifikimi
++	Në përgjithësi ndikime mjedisore shumë pozitive
+	Në përgjithësi ndikime mjedisore pozitive
0	Pa ndikim mjedisor domethënës
-	Ndikime mjedisore të mundshme negative
--	Ndikime mjedisore të mundshme shumë negative

Vlerësimi/ klasifikimi bazohet veçanërisht në ndikimet mjedisore negative dhe shkallën e mundshme të ashpërsisë, kompleksitetin potencial, kohëzgjatjen/ frekuencën e mundshme apo në pakthyeshmërinë e tyre. Ndikimet e mundshme mjedisore vlerësohen gjithmonë në mënyrë kualitative.

Nëse ndikimet mjedisore negative (domethënëse) nuk mund të përjashtohen, masat përkatëse duhet të vlerësohen më hollësisht brenda kuadrit të procedurave të mëtejshme të miratimit dhe vlerësimit, ndër të tjera me një referencë hapësinore specifike dhe bazuar në të dhëna dhe informacion më të detajuar. Pra, në kuadër të këtij studimi VSM është përgatitur analiza e rastit më të keq sa u përket ndikimeve mjedisore të mundshme negative (domethënëse) në aspektin e mbrojtjes mjedisore parandaluese.

4.3 Profilet e VSM të masave të propozuara

Në paragrafët hyrës të secilit profil të VSM, janë përmbledhur masa përkatëse dhe ndikimet e saj mjedisore, si edhe rekomandimet për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative, të cilat duhet të trajtohen në procedurat e mëtejshme të planifikimit dhe miratimit. Tabelat përkatëse të vlerësimit tregojnë vlerësimin e klasifikuar të secilën masë, sipas temës së mbrojtjes dhe si vlerësim gjithëpërfshirës.



4.3.1 Përcaktimi i Zonave të Mbetjeve

4.3.1.1 Justifikimi për përcaktimin e Zonave të Mbetjeve

Në të gjithë Shqipërinë, zonat e mbetjeve janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të gjitha bashkitë t'i përkasin një impianti të caktuar rajonal për menaxhimin e mbetjeve.

Aspektet thelbësore të ndarjes së zonave të mbetjeve ishin, nga njëra anë struktura hapësinore dhe mundësia e qarkullimit dhe nga ana tjetër numri dhe zhvillimi i popullsisë. Nisur nga këto kushte kornizë, mund të përlogariten sasi të mbetjeve të gjeneruara dhe sasi të grumbulluara. Sasia totale e mbetjeve që grumbullohen dhe çohen në një impiant MMN brenda një zone mbetjesh duhet të jetë në masën 100 Mg/d në mënyrë që të ketë një funksionim ekonomik të impiantit rajonal MMN.

Është hartuar informacioni rreth vend depozitimeve sanitare ekzistuese dhe rreth incineratorëve ekzistues dhe të planifikuar. U paraqitën në hartë zonat ekzistuese të mbulimit të këtyre impianteve të mbetjeve. Gjithashtu u paraqitën grafikisht në hartë impiantet e planifikuara të mbetjeve dhe zonat e tyre përkatëse të mbulimit, si edhe projektet aktuale ose të planifikuara të menaxhimit të mbetjeve.

Bazuar në këto konsiderata, u caktuan kufijtë për gjithsej dhjetë zona mbetjesh në Shqipëri, siç tregohen në figurën më poshtë.






Figura 13 Zonat e ardhshme të mbetjeve

4.3.1.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Zonat e mbetjeve sigurojnë përmbushjen e kërkesave bazë për një funksionim të qendrueshëm të impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve, si aspekti ekonomik dhe logjistika.

Nëpërmjet hartëzimit GIS (paraqitje grafike pozitive dhe negative) mund të identifikohen vendndodhjet e mundshme për vend depozitime sanitare dhe impiante të tjera rajonale të menaxhimit të mbetjeve në një zonë të caktuar mbetjesh, pa rënë dakord për një vendndodhje të caktuar.


Për qëllimin e identifikimit të vendndodhjeve u përgatit një bazë të dhënash GIS që mbulon gjithë Shqipërinë. Në paraqitjen grafike negative, bazuar në kërkesat e parashtruara nga legjislacioni dhe standardet, u përpiluan kriteret për përjashtimin e zonave të papërshtatshme.

Në zonat e mbetura (të papërshtatuara) u krye një paraqitje grafike pozitive për të identifikuar zonat e përshtatshme ku mund të zbatohet një qendër rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Rezultatet e këtij ushtrimi janë përfundimi i zonave kandidate për qendra të ardhshme të menaxhimit të mbetjeve, si edhe aspektet që duhen marrë parasysh në studimet e mëtejshme që nevojiten për përzgjedhjen përfundimtare të vendndodhjes për një projekt të mundshëm investimi. Këto të dhëna dhe informacione gjenden gjithashtu si bazë të dhënash dhe shtresë GIS.

Duke përdorur instrumentin për Planifikimin e Investimeve – Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta (ISWM-IPT) mund të planifikohen dhe të aktualizohen në mënyrë interaktive investimet e ardhshme në nivel rajonal dhe vendor.

Figura e mëposhtme ilustron skemën bazë të ISWM-IPT për Shqipërinë.⁴¹

⁴¹ Kohështrirja e planifikimit ndahet në tri faza: Faza 1: 2018 - 2022, Faza 2: 2023 - 2027, Faza 3: 2028 - 2032.






Figura 14 Skema bazë e Instrumentit për Planifikimin e Investimeve MIMN

Tabela e mëposhtme vlerëson ndikimet mjedisore të ndarjes së vendit në zona mbetjesh si dhe të zbatimit të sistemeve moderne dhe të integruara të MMN në këto zona.

Tabela 25 Vlerësimi mjedisor për përcaktimin e zonave të mbetjeve

ZeM	Përcaktimi i Zonave të Mbetjeve																											
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Objektivi mjedisor / synimi i VSM</th> <th>Shkurtimi</th> <th>Vlerësimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="3">Popullsia dhe shëndeti i njerëzve</td> </tr> <tr> <td>Përmirësimi i cilësisë së jetës</td> <td>ZeM</td> <td>+</td> </tr> <tr> <td>Mbrojtja e shëndetit të njerëzve</td> <td>ZeM</td> <td>++</td> </tr> <tr> <td colspan="3">Biodiversiteti, flora dhe fauna</td> </tr> <tr> <td>Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike</td> <td>ZeM</td> <td>+</td> </tr> <tr> <td>Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore</td> <td>ZeM</td> <td>+</td> </tr> <tr> <td colspan="3">Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale</td> </tr> <tr> <td>Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut</td> <td>ZeM</td> <td>+</td> </tr> </tbody> </table>	Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi	Popullsia dhe shëndeti i njerëzve			Përmirësimi i cilësisë së jetës	ZeM	+	Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	ZeM	++	Biodiversiteti, flora dhe fauna			Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	ZeM	+	Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore	ZeM	+	Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale			Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	ZeM	+
Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi																										
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve																												
Përmirësimi i cilësisë së jetës	ZeM	+																										
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	ZeM	++																										
Biodiversiteti, flora dhe fauna																												
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	ZeM	+																										
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore	ZeM	+																										
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale																												
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	ZeM	+																										



Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	ZeM	+
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	ZeM	+
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	ZeM	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	ZeM	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	ZeM	++
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	ZeM	+
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	ZeM	0
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	ZeM	0
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	ZeM	+

4.3.2 Komponentët rajonalë të menaxhimit të mbetjeve

4.3.2.1 Transferimi dhe transporti në distancë të largët

4.3.2.1.1 Përshkrimi i teknologjisë

Alternativat më të zakonata dhe të zbatueshme të transportit për vende si Shqipëria janë transportimi i mbetjeve në kontenierë të mëdhenj të hapur nga sipër ose në kontenierë të mbyllur me njësi kompaktore.



Ngarkimi direkt pa ngjeshje i mbetjeve



Ngarkimi direkt me ngjeshje i mbetjeve



Figura 15 Parimet e ngarkimit të drejtpërdrejtë me dhe pa ngjeshje në stacionet e transferimit⁴²

Ngjeshja e mbetjeve mund të bëhet me presa të instaluar të palëvizshme ose me një njësi kompaktore që i instalohet gjysëm-rimorkios ose kontenierit të transportueshëm (roll-on/ off). Kontenierët e ndërrueshëm, si ata që mund të transportohen (roll-on/off), ofrojnë fleksibilitetin maksimal dhe janë një teknologji e provuar me kosto të ulëta investimi dhe operative. Nëse gjendja e rrugëve është e përshtatshme, këta kamionë mund të transportojnë një kontenier shtesë mbi një rimorkio. Ngjeshja e mbetjeve përpara kryerjes së transportit është e arsyeshme nëse dendësia fillestare e mbetjeve është e ulët. Për mbetjet e pariciklueshme në Shqipëri, duhet të konsiderohet një dendësi e lartë, për shkak të pjesës së madhe që zënë mbetjet organike. Përveç kësaj, njësitë kompaktore mund të pësojnë difekte duke bërë që stacionet e transferimit ku janë instaluar të kenë më tepër risk për ndërprerjen e punës krahasuar me stacionet e transferimit pa njësinë kompaktore. Gjithsesi, nevoja për ngjeshjen e mbetjeve duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke krahasuar kostot e alternativave në bazë të përbërjes së mbetjeve dhe të distancave të transportit.

4.3.2.1.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Reduktimi i proceseve të transportit me shfrytëzimin e kamionëve të transportit në distancë të largët redukton trafikun e mjeteve në rrugë dhe rrjedhimisht emetimet që lidhen me të: emetimet e gazit serrë, zhurmën, pluhurin. Në këtë aspekt, stacionet e transferimit me njësi kompaktore kanë një avantazh krahasuar me stacionet e transferimit ku mbetjet nuk ngjishen.

Për të parandaluar rrëzimin e mbetjeve dhe për të reduktuar emetimet e aromave të rënda, kontenierët e hapur nga sipër do të mbulohen me një pëlthurë të gomuar gjatë

⁴² <https://www.zaoc.de>

transportit. Ngarkimi i drejtpërdrejtë i mbetjeve nëpër kontenierët e transportit zgjidh rrezikun e ndotjes së ujit apo tokës.

Megjithatë mund të ketë disa ndikime negative në stacionet e transferimit të mbetjeve, siç janë aromat e rënda, pluhuri, zhurma dhe trafiku i mjeteve në rrugën drejt stacionit. Për t'i mbajtur këto ndikime në minimum, është e nevojshme të kryhet siç duhet procesi i përzgjedhjes së vendndodhjes dhe një vlerësim i ndikimit në mjedis. Veç kësaj me projektimin e duhur dhe duke zbatuar praktika të mira menaxhimi, edhe emetimet mund të minimizohen. Qoftë edhe një mbyllje e pjesshme e zonës së shkarkimit do të ndihmonte në minimizimin e emetimit të pluhurit. Largimi i menjëhershëm i kontenierëve të mbushur dhe koordinimi i orareve me bashkitë për sjelljen e mbetjeve mund të përmenden si shembuj të praktikave të mira.

Tabela 26 Vlerësimi mjedisor për transferimin dhe transportin në distancë të largët të mbetjeve

R01	Transferimi dhe transporti në distancë të largët i mbetjeve		
R01-01	Stacion transferimi me rampë		
R01-02	Stacion transferimi me rampë dhe me njësi kompaktore		

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	R01-01	++
	R01-02	+
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R01-01	++
	R01-02	-
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R01-01	0
	R01-02	0
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore	R01-01	0
	R01-02	0
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve të tjera materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R01-01	+
	R01-02	+
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	R01-01	+
	R01-02	++
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R01-01	+
	R01-02	++
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i	R01-01	0

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
statusit të tyre ekologjik	R01-02	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R01-01	O
	R01-02	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R01-01	+
	R01-02	++
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R01-01	+
	R01-02	++
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R01-01	O
	R01-02	O
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	R01-01	O
	R01-02	O
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	R01-01	+
	R01-02	++

4.3.2.2 Trajtimi mekanik

Objektivat kryesore të aktiviteteve të riciklimit janë të kursejnë burimet dhe të minimizojnë ndikimin mjedisor të mbetjeve duke pakësuar sasinë e tyre që depozitohet. Sipas VKM Nr. 418, NJQV do të rritin nivelin e rikuperimit të materialeve nga mbetjet bashkiake me anë të riciklimit (letër, metal, plastikë dhe qelq) deri në 17 % në 2020.

Ka potencial të konsiderueshëm për një zgjerim të aktiviteteve të riciklimit në Shqipëri, meqë deri tani ka pasur një përparim të kufizuar në zbatimin e parimeve të hierarkisë së mbetjeve. Aktualisht menaxhimi i mbetjeve fokusohet në grumbullimin dhe depozitimin e tyre duke treguar pak vëmendje për minimizimin, ripërdorimin dhe rikuperimin e materialit (riciklimin).

4.3.2.2.1 Përshkrimi i teknologjisë

Në përgjithësi, ka dy mënyra për ndarjen e materialeve të riciklueshme dhe fraksioneve të tjera të mbetjeve – impiantet "e papastra" ose "të pastra" të rikuperimit të materialeve (IRM). Në IRM e papastra elementët e rrymës së mbetjeve të përzjera ndahen duke i nxjerrë me dorë dhe/ ose me teknika mekanike ndarjeje. Teknikat e kontrollimit dhe ndarjes përdoren për të ndarë rrymën e mbetjeve në materiale të riciklueshme dhe në mbetje fundore të pariciklueshme që duhen depozituar ose përpunuar më tej.



Figura 16 Elementët e IRM: Bunkerit/ hapësi i qeseve, ndarja me dorë, sita, presa⁴³

Në IRM e pastra ndahen elementët e materialeve të riciklueshme të përziera që janë grumbulluar veçmas nga mbetjet e tjera. Krahasuar me IRM e papastra, puna e ndarjes këtu është më pak e vështirë dhe normat e rikuperimit janë (teorikisht) më të larta. Nga ana tjetër, kërkohet punë shtesë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.

Megjithëse projektet e IRM klasifikohen si teknologji bazë, duhet menaxhim me përvojë, monitorim dhe kontroll cilësie për të garantuar një rendiment të mirë pune.

Meqë deri tani zbatohet një numër i vogël aktivitësh ricikluese nga ana e bashkive në Shqipëri, rekomandohet të ndiqet një qasje graduale për zbatimin e një sistemi kaq kompleks. Në këtë mënyrë, si grumbullimi i diferencuar ashtu edhe njohuritë e bashkive do të mund të zhvilloheshin hap pas hapi.

4.3.2.2.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Gjatë procesit të trajtimit në IRM, emetimet kryesore janë ato të aromave të rënda, pluhurit dhe zhurmës. Impiantet e mbyllura bëjnë të mundur kapjen e pjesës më të

⁴³ INFRASTRUKTUR & UMWELT, Orhan Boran

madhe të emetimeve. Në varësi të intensitetit të emetimeve të aromave të rënda mund të jetë i nevojshëm trajtimi i ajrit të shkarkimit.

Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet stafit që punon për ndarjen e mbetjeve në IRM; ajrimi i kabinave ku kryhet ndarja e mbetjeve duhet të jetë i teknologjisë së fundit në mënyrë që ndikimi negativ tek punëtorët të jetë sa më minimal.

Në tërësi, duke supozuar që funksionimi të jetë sipas standardeve, ndikimet mjedisore të mundshme negative të IRM janë të ulëta krahasuar me teknologjitë e tjera.

Përfitimet janë rikuperimi i materialit dhe rrjedhimisht ruajtja e burimeve dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve që çohet në vend depozitim.

Tabela 27 Vlerësimi mjedisor për trajtimin mekanik (IRM)

R02	Trajtimi mekanik (IRM)
R02-01	IRM e papastër
R02-02	IRM e pastër

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	R02-01	+
	R02-02	o
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R02-01	+
	R02-02	+
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R02-01	o
	R02-02	o
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore	R02-01	o
	R02-02	o
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R02-01	+
	R02-02	++
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe rritja e efikasitetit të përdorimit	R02-01	+
	R02-02	++
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R02-01	+
	R02-02	++
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	R02-01	+
	R02-02	++



Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R02-01	O
	R02-02	O
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R02-01	+
	R02-02	++
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R02-01	+
	R02-02	++
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R02-01	O
	R02-02	O
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	R02-01	O
	R02-02	O
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	R02-01	+
	R02-02	++

4.3.2.3 Trajtimi mekanik-biologjik (TMB, Rikuperimi i materialit dhe/ose energjisë)

4.3.2.3.1 Përshkrimi i teknologjisë

Gjatë dekadës së fundit, me zbatimin e rregulloreve strikte për vend depozitimet, trajtimi mekanik-biologjik i mbetjeve është shndërruar në një alternativë të konsoliduar ose plotësuese të incinerimit të mbetjeve në Europë. Kështu, është krijuar një përvojë e plotë me vënien në punë të teknologjive të ndryshme TMB. Niveli i teknologjisë së zbatuar në impiantet TMB varion nga i ulët në shumë të lartë, kryesisht në varësi të kërkesave ligjore dhe qëllimit të trajtimit. Megjithatë, qoftë edhe me një teknologji të ulët mund të arrihet reduktimi i ndjeshëm i emetimeve të vend depozitimeve, gazi i vend depozitimit dhe lëngu kullues.

Siç sugjeron vetë emri, ka një proces trajtimi mekanik dhe biologjik. Faza e trajtimit mekanik mund të ndiqet për qëllime të ndryshme, si largimin e materialeve inerte apo papastërtive dhe përgatitjen për një trajtim të mëtejshëm biologjik, ndarjen e materialeve të riciklueshme dhe/ose përgatitjen e lëndës djegëse me prejardhje nga mbetjet (LDPM). Në fazën e trajtimit biologjik biomasa ose fraksioni i "kompostueshëm" përpunohet përmes një tretjeje anaerobike, kompostimi ose sistemi të bio-tharjes me qëllim reduktimin e masës, prodhimin e materialit të ngjashëm me kompostin, biogaz dhe/ ose LDPM dhe/ ose stabilizimin e mbetjeve fundore.






Figura 17 Hapat e procesit dhe produktet e impianteve të TMB

4.3.2.3.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Konfigurimet e ndryshme të proceseve të TMB gjenerojnë lloje dhe sasi të ndryshme emetimesh.

Gjatë procesit të trajtimit mekanik emetimet kryesore janë aromat e rënda, pluhuri dhe zhurma. Procesi biologjik gjeneron emetime në ujë dhe ajër. Në varësi të kërkesave ligjore dhe në bazë të projektimit të impiantit duhet të përzgjidhet teknologjia e trajtimit për ujërat e përdorura dhe ajrin e shkarkimit. Në mënyrë që të arrihen standardet e emetimeve në Gjermani, përdoren bio filtra të kombinuar me procese oksidimi termike rigjeneruese (RTO) për trajtimin e ajrit të shkarkimit. Për shkak të kërkesës së lartë për energji dhe nevojave për mirëmbajtje, procesi RTO është një proces trajtimi i kushtueshëm. Impiantet e mbyllura lejojnë kapjen e pjesës më të madhe të emetimeve, por kanë kosto të larta investimi dhe operative.

Procesi i TMB jep kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen e klimës me anë të reduktimit të emetimeve të metanit nga vend depozitimet si edhe me anë të zëvendësimit të lëndëve djegëse fosile me LDPM. Sipas një studimi të kryer nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës, shfrytëzimi i LDPM në dy furra çimentoje në Shqipëri do ta ndihmonte Shqipërinë të arrinte rreth 20-42 % të synimeve për reduktimin e CO₂ për vitin 2030⁴⁴.

Gjithashtu, gjenerimi i lëngut kullues në vend depozitime reduktohet dhe kështu nga njëra anë minimizohet rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore dhe nga ana tjetër ulen kostot për trajtimin e lëngut kullues nga mbetjet. Përfitime të tjera janë rikuperimi i materialit dhe për rrjedhojë ruajtja e burimeve, si edhe furnizimi me energji të rinovueshme.

Tabela 28 Vlerësimi mjedisor për trajtimin mekanik-biologji (TMB)

R03	Trajtimi mekanik-biologji (TMB)
R03-01	TMB me tretje anaerobike
R03-02	TMB me stabilizim
R03-03	TMB me kompostim

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	R03-01	0
	R03-02	0
	R03-03	0
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R03-01	-
	R03-02	0
	R03-03	+
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R03-01	0
	R03-02	0
	R03-03	0
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	R03-01	0
	R03-02	0
	R03-03	0

⁴⁴ Përfitimet nga përdorimi i lëndëve djegëse alternative në prodhimin e çimentos (Benefits from Usage of Alternative Fuels in the Cement Production), Stela Pepa, Alma Shehu, Departamenti I Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, Nëntor 2016, <http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2017/02/39.-Stela-Pepa.pdf>

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R03-01	O
	R03-02	O
	R03-03	O
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	+
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	+
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	O
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	O
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	+
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	O
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R03-01	O
	R03-02	O
	R03-03	O
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	R03-01	O
	R03-02	O
	R03-03	O
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	R03-01	++
	R03-02	++
	R03-03	O

4.3.2.4 Tretja anaerobike (Rikuperimi i materialit dhe energjisë)

Në përgjithësi, tretja anaerobike (TA) është një proces stabilizimi i substancave organike. Sa i përket rikuperimit të energjisë dhe materialit, synimet kryesore të kësaj alternative teknologjike janë gjenerimi i biogazit (prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë) dhe prodhimi i një plehëruesi për të rritur pjellorinë e tokës.

Nga ana tjetër, trajtimi anaerobik i mbetjeve shtëpiake të përziera si komponent i një impianti të TMB (siç përshkruhet në Kapitullin 4.5) fokusohet kryesisht në stabilizimin e përmbajtjes organike të mbetjeve në mënyrë që të reduktohet si sasia e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që çohen në vend depozitim, ashtu edhe emetimet përkatëse që shkaktohen prej tyre.

Sigurisht që TA e mbetjeve organike të grumbulluara veçmas, siç përshkruhet hollësisht në këtë kapitull, përfshin përmirësimet e sipërpërmendura lidhur me vend depozitimet dhe emetimet e tyre. Një parakusht bazë për arritjen e të gjitha këtyre synimeve është grumbullimi i diferencuar i bio-mbetjeve. Shpenzimet shtesë që nevojiten për këtë mund të kompensohen nga të ardhurat e arkëtueshme dhe përmirësimet në vlerë monetare të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

4.3.2.4.1 Përshkrimi i teknologjisë

Tretja anaerobike (TA) është një proces stabilizimi i substancave organike. Sa i përket rikuperimit të energjisë dhe materialit, synimet kryesore të TA të mbetjeve organike të grumbulluara veçmas janë gjenerimi i biogazit (prodhimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë) dhe prodhimi i plehëruesit për tokë pjellore. Synime të tjera janë stabilizimi i përmbajtjes organike të mbetjeve për të reduktuar si sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që çohen në vend depozitim, ashtu edhe emetimet përkatëse që shkaktohen prej tyre. Një parakusht bazë për arritjen e këtyre synimeve është grumbullimi i diferencuar i bio-mbetjeve. Shpenzimet shtesë që nevojiten për këtë mund të kompensohen nga të ardhurat e arkëtueshme dhe përmirësimet në vlerë monetare të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve.

4.3.2.4.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Meqë TA është një sistem i mbyllur, nuk pritet të ketë ndikime mjedisore të rëndësishme për sa kohë sigurohet një funksionim i qendrueshëm. Megjithatë asnjë punë teknike nuk përjashton mundësinë e difekteve gjatë punës. Për këtë arsye është thelbësore të ketë staf të kualifikuar për të ndërhyrë menjëherë në rastin e ndonjë keqfunksionimi. Për shembull, në rastin e rrjedhjeve të biogazit, biogazi që rrjedh duhet të digjet në mënyrë të

kontrolluar, gjë e cila natyrisht shoqërohet me një ndikim të vogël mjedisor, por pa dëmtime afatgjata. Për shkak të kapsulimit të tretësve anaerobikë, nuk ka gjasa të ndodhin humbje të substratit për shkak të pompave të dëmtuara apo të rrjedhjeve të reaktorit. Veç kësaj, produktet e impianteve TA duhet të kontrollohen edhe në drejtim të standardeve përkatëse. Duhet të shmanget dhe për rrjedhojë të kontrollohet përdorimi i mbetjeve të kontaminuara apo i ujit të papërpunuar që dalin nga procesi.

Në përgjithësi, TA ndihmon tërthorazi për mbrojtjen e klimës duke shmangur emetimet e metanit nga vend depozitimet. Gjithashtu, për shkak të stabilizimit të materialit organik, masa e mbetjeve në vend depozitim zë vend më mirë krahasuar me vend depozitimet me mbetje bashkiake të patrajtuara. Përfitime të tjera janë rikuperimi i materialit dhe energjisë dhe për rrjedhojë ruajtja e burimeve.

Tabela 29 Vlerësimi mjedisor për tretjen anaerobike

R04		Tretja anaerobike	
Objektivi mjedisor / synimi i VSM		Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve			
	Përmirësimi i cilësisë së jetës	R04	O
	Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R04	-
Biodiversiteti, flora dhe fauna			
	Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R04	O
	Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	R04	O
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale			
	Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R04	+
	Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	R04	++
	Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R04	++
Uji			
	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	R04	++
	Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R04	++
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë			
	Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R04	++
	Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R04	++
Peizazhi			
	Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R04	O
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore			
	Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	R04	O

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor	R04	++

4.3.2.5 Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)

Në BE, Direktiva për Incinerimin e Mbetjeve⁴⁵ (Direktiva IM) cakton kufirin e vlerave të emetimeve në ajër dhe kërkesat e monitorimit për incinerimin e mbetjeve. Direktiva IM bën një dallim midis:

- impianteve të incinerimit, të cilat janë të dedikuara për trajtimin termik të mbetjeve
 - me rikuperim nxehtësie dhe energjie
 - pa rikuperim nxehtësie dhe energjie
- impianteve të bashkë-incinerimit (si furrat e çimentos apo gëlqeres, impiantet e prodhimit të çelikut apo stacionet e prodhimit të energjisë)

Meqë incinerimi i mbetjeve pa rikuperim energjie nuk konsiderohet më teknologji e avancuar moderne, ky lloj impianti nuk është marrë parasysh në këtë raport.

Impiantet e bashkë-djegies janë impiante që shfrytëzojnë mbetjet si një burim dytësor energjie të kombinuar me lloje të tjera të lëndëve djegëse. Ky lloj trajtimi në impiantet e djegies apo të çimentos është thuajse i zakonitë në Europë⁴⁶. Ka madje edhe impiante djegieje që djegin mbetje bashkiake të patrajtuara duke zbatuar rreptësisht vlerat limit të emetimeve të përcaktuara në Direktivën e Incinerimit të Mbetjeve. Meqë hidrocentralet e Shqipërisë gjenerojnë më shumë se 80 % të energjisë elektrike që nevojitet dhe hidrocentrale të reja janë planifikuar ose janë duke u ndërtuar, mundësia e bashkë-djegies në impiantet e prodhimit të energjisë me lëndë djegëse fosile është e kufizuar. Veç kësaj, përmbajtja organike e mbetjeve në Shqipëri është shumë e lartë dhe në të vërtetë jo e përshtatshme për djegie pa kaluar një para-trajtim. Si rezultat, bashkë-djegie e mbetjeve të patrajtuara nuk është marrë parasysh në Planin e Investimeve MIMN.


4.3.2.5.1 Përshkrimi i teknologjisë

Incinerimi i mbetjeve nënkupton trajtimin termik të mbetjeve për të ulur vëllimin dhe rrezikun e tyre, në të njëjtën kohë për të kapur apo eliminuar substancat e dëmshme që çlirohen ose mund të çlirohen gjatë incinerimit dhe për të rikuperuar energjinë, mineralin

⁴⁵ Direktiva 2000/76/EC për Incinerimin e mbetjeve

⁴⁶ Vlerësimi dhe Përmbledhje e Raporteve të Zbatimit të Shteteve Anëtare për IED, IPPCD, SED dhe WID. Raporti Përfundimtar i WID (WID Final Report), EC, 2016

dhe/ ose përmbajtjen kimike nga mbetjet. Si rezultat i këtyre procesve, një impiant incinerimi konsiston në një mori komplekse komponentësh teknike ndërveprues.



Waste receiving and storage	Grate combustion and boiler	Flue gas treatment	Energy utilization	Residue handling
1 Tipping hall	4 Feed hopper	14 Electrostatic precipitator	23 Extraction-condensation turbine	29 Bottom ash extractor
2 Waste bunker	5 Ram feeder	15 Sodium bicarbonate Injection	24 Air cooled condenser	30 Bottom ash bunker
3 Waste crane	6 Hitachi Zosen Inova grate	16 Fabric filter 1	25 District heating heat exchanger	31 Bottom ash crane
	7 Four-pass steam boiler	17 SCR DeNO _x	26 Process steam extraction	
	8 External Economiser	18 Heat exchanger 1	27 Trafo	
	9 Secondary air injection	19 Fabric filter 2	28 Electricity Export	
	10 Secondary air fan	20 Induced draft fan		
	11 Recirculated flue gas injection	21 Heat exchanger 2		
	12 Recirculated flue gas fan	22 Stack		
	13 Primary air fan			




Figura 18 Komponentët e një impianti për incinerimin e mbetjeve⁴⁷

⁴⁷ Diagrama e Sistemit: Hitachi Zosen INOVA, <http://www.hz-inova.com>, Foto: INFRASTRUKTUR & UMWELT, Orhan Boran

Ka teknologji të ndryshme për djegien e mbetjeve: skara e lëvizshme, furra rrotulluese, shtrati i fluidizuar, etj. Teknologjia më e përhapur dhe e provuar është djegia e masës me një skarë të lëvizshme ku mbetjet digjen në temperaturën 1,000°C ose më të lartë mbi një skarë me fryrje ajri nga poshtë. Në Europë rreth 90 % e impianteve që trajtojnë mbetje të ngurta bashkiake (MNB) përdorin skarat.

4.3.2.5.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Përfitimi madhor i incinerimit të mbetjeve është gjurma e vogël e depozitimit të mbetjeve në mjedis për shkak të reduktimit në masë të madhe të vëllimit dhe sasisë së mbetjeve që përfundojnë në vend depozitim. Gjithashtu toka që nevojitet për impiantin mund të jetë sa 10 % e tokës që nevojitet për depozitimin e mbetjeve të patrajuara. Nga ana tjetër, emetimet e gazit nga djegia dhe mbetjet nga pastrimi i këtij gazi janë arsye madhore për t'u shqetësuar. Nëse përdoret një sistem për pastrimin e gazit të djegies, përveç mbetjeve të ngurta, të cilat duhet të depozitohen në vend depozitime për mbetjet e rrezikshme, nga procesi mund të dalë edhe ujë i përdorur i ndotur.

Duke marrë për bazë hierarkinë e mbetjeve, rikuperimi i energjisë termike vjen pas rikuperimit të materialit. Rikuperimi i materialit do të jetë alternativa e parapëlqyer aty ku është e mundur. Nëse riciklimi nuk është i mundur për cilëndo arsye, incinerimi i mbetjeve mund të shihet si një alternativë. Aktivitetet e grumbullimit të diferencuar që synojnë grumbullimin e materialeve të riciklueshme të ndryshme nga mbetjet organike do ta ulte fuqinë kalorifike të mbetjeve që duhet të çohen në impiantin e incinerimit. Në Shqipëri, ku fraksioni organik zë pjesën më të madhe të mbetjeve bashkiake, kjo do të nënkuptonte rritjen e përdorimit të lëndëve djegëse shtesë dhe rritjen e kostove. Në të kundërt as synimet e djegies (reduktimi i vëllimit dhe masës), as synimet e rikuperimit të energjisë dhe pastrimit të gazit të djegies nuk mund të arrihen.

Metalet që nxirren nga hiri janë zakonisht të një cilësie më të ulët sesa ato që nxirren në burim ose në një impiant të ndarjes së mbetjeve. Shfrytëzimi i blazës, zakonisht për mbushje ose për materiale ndërtimi, kërkon zbatimin e rregulloreve strikte, udhëzime dhe monitorim. Për më tepër, teksa metalet bëjnë pjesë në synimet e riciklimit, materialet e tjera pas procesit të trajtimit teknik, si bloza apo mbetjet nga trajtimi i gazit të djegies, nuk gjejnë vend në synimet e riciklimit.

Tabela 30 Vlerësimi mjedisor për incinerimin e mbetjeve (me rikuperim energjie)

R05	Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)
R05-01	Incinerimi me skarë të lëvizshme

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	R05-01	-
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R05-01	-
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R05-01	0
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	R05-01	0
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R05-01	0
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	R05-01	+
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R05-01	0
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	R05-01	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R05-01	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R05-01	0
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R05-01	0
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R05-01	0
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	R05-01	0
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	R05-01	0

4.3.2.6 Vend depozitimi sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve)

Ndërtimi i vend depozitimeve sanitarë është një element qendror i sistemeve MIMN, pasi duhet të sigurohet depozitimi i sigurt mbetjeve të ngurta sipas rregullave mjedisore.

Kështu, pavarësisht zgjedhjes të ndonjë zgjidhjeje për të shmangur, ricikluar dhe trajtuar mbetjet tani dhe në të ardhmen, do të mbeten pëherë mbetje për t'u depozituar.

Barra mjedisore nga depozitimi i mbetjeve lidhet kryesisht me dekompozimin anaerobik të pakontrolluar të lëndës organike në mbetjet e depozituara. Kjo çon në efekte negative si



gjenerimi i gazit të vend depozitimit, lëngut kullues dhe aromave të rënda, si edhe probleme me stabilitetin për shkak të sheshimit të masës së mbetjeve.

Këto efekte negative mund të reduktohen me anë të përzgjedhjes së vendndodhjes së duhur për vend depozitim, të masave strukturore, si shtresat izoluese dhe me anë të mënyrave të përparuar të kryerjes së punës në vend depozitim. Gjithashtu, mbetjet mund të trajtohen për të pakësuar me efikasitet përmbajtjen e tyre organike para se të depozitohen, kështu do të rezultojnë më pak emetime nga mbetjet e depozituara.

Situata aktuale në Shqipëri

Në përgjithësi mund të thuhet se depozitimi jo i duhur i mbetjeve është problemi më serioz që ka sot MMN në Shqipëri. Problemet kryesore lidhen me

- Përzgjedhjen e vendndodhjeve të gabuara (p.sh. në shtretërit e lumenjve, brenda vendbanimeve),
- Mungesën e masave për të kufizuar emetimet (p.sh. mbetjet nuk mbulohen, zjarre të pakontrolluar),
- Hedhjen e mbetjeve nëpër lumenj dhe burime ujore të rëndësishme dhe
- Drejtimin e dobët të punës (ose mungesën e tij) në vendgrumbullimet e mbetjeve (mungesë buxheti, pajisjesh, etj.).

Edhe në rastet kur bashkitë bëjnë përpjekje të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, situata në vendgrumbullimet e mbetjeve në shumicën e rasteve neglizhohet.

Zakonisht, me disa përjashtime të pakta, mbetjet e grumbulluara depozitohen në natyrë në vendgrumbullime të pakontrolluara. Shumë prej tyre ndodhen në vende të papërshtatshme dhe në shumicën e rasteve nuk ndërmerren masa ndërtimore apo operative për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit, si kontrolli në hyrje, menaxhimi i ujërave sipërfaqësore, sistemi i izolimit fundor dhe sistemi i mbledhjes së lëngut kullues dhe gazit. Po ashtu mbetjet e depozituara nuk mbulohen rregullisht me dhë ose zhavorr.

Vitet e fundit, janë zbatuar projekte të ndryshme me fokus përmirësimin e vend depozitimeve në vend, p.sh. ndërtimi i vend depozitimeve sanitare sipas standardeve të direktivës së BE për vend depozitimet. Për shkak të ekonomisë së shkallës, këto projekte janë planifikuar për disa bashki ose si impiante rajonale:

- Qarku i Shkodrës: Vend depozitimi sanitar i Bushatit u ndërtua brenda një sipërfaqeje toke të rrethuar prej 23 ha dhe u projektua për një kapacitet prej 1

milion tonë mbetje që do të grumbulloheshin nga qarqet e Shkodrës dhe Lezhës. Nisi nga puna në Korrik 2011. Ky impiant përfshin disa aktivitete si: një peshore, një impiant për ndarjen e mbetjeve (nuk ishte funksional në Mars 2017), sisteme për trajtimin e lëngut kullues dhe të ujërave sipërfaqësore (jo funksional), sistem për mbledhjen e gazit (nuk funksionon mirë) dhe mjete pune të rënda (kompaktor, buldozer) dhe menaxhohet nga një kompani aksionere. Për shkak të disa marrëveshjeve mbi tarifat e vend depozitimit, sasi të mbetjeve që janë çuar faktikisht janë shumë më të ulëta se sasi të planifikuara dhe për pasojë kostot operative për njësi të vend depozitimit janë rritur. Aktualisht puna në vend depozitim përmban vetëm shtyrjen, sheshimin dhe deri diku mbulimin me dhë të mbetjeve.

- Qarku i Vlorës: Vend depozitimi sanitar i Bajkaj, që ka filluar nga puna në Shtator 2015, është projektuar për t'i shërbyer një zone mbulimi ku futet gjithë pjesa jugore e qarkut të Vlorës. Sasi të mbetjeve që priten aktualisht në vend depozitim janë më pak se gjysma e sasive të planifikuara fillimisht. Për këtë arsye, kostot për njësi janë më të larta nga sa pritej dhe financimi i aktivitetit pa subvencione do të vështirësohet. Vend depozitimi aktualisht drejtohet nga një ndërmarrje shërbimi publike e krijuar dhe në zotërimin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
- Veç kësaj, Qeveria Shqiptare synon të zbatojë një projekt për MMN në pjesën veriore të qarkut të Vlorës. Si masa investimi në këtë projekt përfshihen një vend depozitim sanitar rajonal, një impiant për ndarjen e mbetjeve kryesisht për materiale të riciklueshme të ndara më parë, një impiant kompostimi për mbetje organike të ndara paraprakisht, pajisje për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve bashkiake dhe mbyllja e rehabilitimi i vendgrumbullimeve më të mëdha ekzistuese. Zbatimi i projektit filloi në 2018, financuar nga KfW.
- Qarku i Korçës: ndërtimi i vend depozitimit sanitar të Maliqit ka përfunduar së fundmi dhe ka filluar funksionimi i tij. Gjithashtu, janë ndërtuar stacione transferimi në Devoll dhe Kolonjë, ndërkohë që stacioni i tretë i transferimit parashikohet në Pogradec. Sistemi rajonal i MIMN mbështetet në vijim nga KfW.
- Qarku i Tiranës: aktualisht bashkitë po përdorin tre vend depozitime të ndryshme, nga të cilat dy ndodhen brenda qarkut të Tiranës, përkatësisht vend depozitimi sanitar i Sharrës (që u shërben bashkive Tiranë dhe Vorë) dhe vendgrumbullimi i Kamzës (që i shërben bashkisë Kamëz). Bashkitë e Kavajës dhe Rogozhinës i çojnë mbetjet e grumbulluara në një vendgrumbullim në Durrës. Kështu, përveç se në bashkitë e Tiranës dhe Vorës, mbetjet e grumbulluara depozitohen në vendgrumbullime ku nuk janë marrë masa për mbrojtjen mjedisore. Po gjithashtu në vend depozitimin e Sharrës, megjithëse duhej të ishte një vend depozitim



sanitar, lëngu kullues dhe gazi i vend depozitimit deri tani nuk trajtohen dhe ndikojnë negativisht në ajrin, tokën dhe ujin përreth. Aktualisht koncesionari po rehabiliton vend depozitimin e Sharrës dhe ka filluar vënien në punë të një sistemi për mbledhjen e gazit, teksa po punohet për ngritjen e sistemit për trajtimin e lëngut kullues.

4.3.2.6.1 Përshkrimi i teknologjisë

Ndërtimi i vend depozitimeve sanitare është një element qendror i sistemeve MIMN, pasi duhet të sigurohet depozitimi i sigurt mbetjeve të ngurta sipas rregullave mjedisore. Kështu, pavarësisht zgjedhjes të ndonjë teknologjie për të shmangur, ricikluar dhe/ ose trajtuar mbetjet tani dhe në të ardhmen, do të mbetet përherë një sasi e caktuar mbetjesh që do të duhet të depozitohet në mënyrë të sigurt.

Barra mjedisore nga depozitimi i mbetjeve lidhet kryesisht me dekompozimi anaerobik të pakontrolluar të lëndës organike në mbetjet e depozituara. Kjo çon në efekte negative si gjenerimi i gazit të vend depozitimit, lëngut kullues dhe aromave të rënda, si edhe probleme me stabilitetin për shkak të sheshimit të masës së mbetjeve.

Këto efekte negative mund të reduktohen me anë të përzgjedhjes së vendndodhjes së duhur për vend depozitim, të masave strukturore, si shtresat izoluese dhe me anë të mënyrave të përparuara të kryerjes së punës në vend depozitim.



Figura 19 Shtresat e sistemit izolues fundor të vend depozitimit sipas standardeve të BE

Për të garantuar pajtueshmëri me standardet europiane (të përcaktuara në Direktivën 99/31/EC për Vend depozitimet e mbetjeve) nuk duhet të merren parasysh vetëm kërkesat lidhur me planifikimin, ndërtimin dhe funksionimin, por edhe çështjet e monitorimit dhe kontrollit. Gjithashtu duhet të kihet parasysh edhe rehabilitimi i vendgrumbullimeve ekzistuese dhe të integrohet në tërësinë e procesit.

4.3.2.6.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Dekompozimi anaerobik i pakontrolluar i lëndës organike në vend depozitime/ vendgrumbullime sjell këto efekte negative:

- Gjenerimin e gazit të vend depozitimit, i cili përmban një sasi të konsiderueshme metani. Metani nga vend depozitimet është një nga burimet kryesore të emetimeve të gazit serrë.
- Gjenerimi i lëngut kullues, i cili është i kontaminuar nga produktet e dekompozimit dhe ndotësit e tjerë.
- Gjenerimi i aromave të rënda, të cilat mund të jenë shqetësuese për vendbanimet në afërsi.
- Sheshimi i masës së mbetjeve në vend depozitim, i cili mund të sjellë probleme me stabilitetin, emetime të pakontrolluara të gazit të vend depozitimit dhe depërtimi i ujit në trupin e vend depozitimit.

Edhe vend depozitimet sanitare të kontrolluara kanë një ndikim negativ në mjedis. Megjithatë, ky ndikim është shumë më i ulët krahasuar me vendgrumbullimet e pakontrolluara të mbetjeve. Për të përmbushur standardet europiane është thelbësor një monitorim i rregullt i gjithë proceseve të punës (dorëzimi, depozitimi, kontrolli i emetimeve, etj.).

Për të shmangur efektet e pafavorshme në cilësinë e jetës të popullsisë që jeton në zonat përreth (mbrojtja ndaj emetimeve), duhet të ruhen distancat e përcaktuara midis vend depozitimeve sanitare dhe vendbanimeve. Për të ulur ndikimet mjedisore të vend depozitimeve të vjetër (si infiltrimi i lëngut kullues dhe emimet e gazit) rekomandohen masa rehabilituese (izolim sipërfaqësor i mirë-projektuar).

Tabela 31 Vlerësimi mjedisor për vend depozitim sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve)

R06	Vend depozitim sanitar (depozitim i sigurt i mbetjeve)
R06-01	Vend depozitim sanitar
R06-02	Rehabilitim i vend depozitimeve

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	R06-01	0
	R06-02	+
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	R06-01	0
	R06-02	+
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	R06-01	0
	R06-02	0
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	R06-01	0
	R06-02	0
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i asetëve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	R06-01	0
	R06-02	+
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	R06-01	--
	R06-02	--
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	R06-01	--
	R06-02	--
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	R06-01	0
	R06-02	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	R06-01	0
	R06-02	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	R06-01	0
	R06-02	+
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	R06-01	0
	R06-02	+
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	R06-01	0
	R06-02	+
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e asetëve të trashëgimisë kulturore	R06-01	0
	R06-02	0
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	R06-01	0
	R06-02	+

4.3.3 Komponentët vendorë të menaxhimit të mbetjeve

4.3.3.1 Pastrimi i rrugëve

4.3.3.1.1 Përshkrimi i teknologjisë

Në parim janë dy mënyra për pastrimin e rrugëve – ose në mënyrë manuale ose mekanike.



Figura 20 Shembuj të pastrimit të rrugëve në mënyrë manuale⁴⁶ (majtas) dhe mekanike⁴⁹ (djathtas)

Disavantazhet kryesore të fshirjes mekanike janë kostot e larta të investimit dhe operative. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në Shqipëri, fshirja e rrugëve me dorë ofron një mundësi për krijimin e vendeve të punës për personat e pakualifikuar. Për këtë arsye fshirja mekanike duhet të përdoret vetëm në rastet kur është e nevojshme, p.sh. nëse nuk mund të garantohet siguria e punëtorëve të pastrimit. Përveç mjeteve për fshirjen e rrugëve, elementë të tjerë të rëndësishëm të pastrimit të rrugëve janë koshat, sidomos në zonat këmbësore dhe publike. Ato mund të zbrazen nga punëtorët që fshijnë rrugët ose nga grupe pune të posaçme për to. Kamionçinat përdoren për të kryer transportin e punëtorëve të pastrimit dhe pajisjet, ashtu si edhe për të shkarkuar koshat publike.

⁴⁶ <https://worksitt.dk/haveredskaber/309-redskabsholder-til-affaldscontainer.html>

⁴⁹ http://sweeper.buchermunicipal.com/en/products/compact_sweepers

4.3.3.1.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Shërbimet e rregullta dhe efektive të pastrimit të rrugëve sigurojnë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për popullsinë për të jetuar dhe punuar. Përveçse ndihmon në pastërtinë e përgjithshme të qytetit, fshirja e rrugëve është një masë efikase për të reduktuar ndotësit në ujërat që rrjedhin mbi sipërfaqen e rrugëve dhe për pasojë për të mbrojtur cilësinë e ujit. Disa nga makineritë moderne fshirëse kanë certifikatën PM10 që do të thotë se ato mund të marrin grimca deri në masën 10 mikrometra apo më të vogla. Ndaj cilësia e ajrit në qytet përmirësohet edhe nga pastrimi i rrugëve.

Është e pritshme që përhapja e mbetjeve në hapësirat publike të pakësohet, nëse do të ketë një shërbim të rregullt të pastrimit të rrugëve dhe një numër të mjaftueshëm të koshave publike në gjendje të mirë. Edhe depozitimi i mbetjeve shtëpiake jashtë kontenierëve apo zonave të caktuara për to mund të parandalohet.

Makineritë mekanike të fshirjes mund të arrijnë një nivel pastrimi më të lartë; megjithatë, ato shkaktojnë zhurmë dhe emetime të dioksidit të karbonit. Për shkak të përdorimit të disa lëndëve të para, gjurma e tyre mjedisore është shumë më e madhe sesa ajo e mjeteve që përdoren për pastrimin manual të rrugëve.

Tabela 32 Vlerësimi mjedisor për pastrimin e rrugëve

L01	Pastrimi i rrugëve
L01-01	Fshirja manuale e rrugëve
L01-02	Fshirja mekanike e rrugëve

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	L01-01	++
	L01-02	+
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	L01-01	++
	L01-02	0
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	L01-01	+
	L01-02	+
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	L01-01	+
	L01-02	+
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	L01-01	+

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
	L01-02	+
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	L01-01	++
	L01-02	+
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	L01-01	++
	L01-02	O
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	L01-01	+
	L01-02	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	L01-01	+
	L01-02	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	L01-01	++
	L01-02	O
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	L01-01	++
	L01-02	O
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	L01-01	+
	L01-02	+
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	L01-01	+
	L01-02	+
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	L01-01	++
	L01-02	O

4.3.3.2 Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)

4.3.3.2.1 Përshkrimi i teknologjisë

Në përgjithësi ka dy mënyra për grumbullimin e mbetjeve – derë-më-derë (grumbullimi i mbetjeve nga cepi i trotuarit) dhe në pikat e grumbullimit kolektiv (banorët i çojnë vetë mbetjet tek kontenierët).



Figura 21 Shembuj të koshave me rrota që përdoren për grumbullimin derë-më-derë (majtas) dhe kontenerët për grumbullim kolektiv në Maliq / Shqipëri (djathtas)⁵⁰

Të dy sistemet mund të përdoren për grumbullimin e të gjitha llojeve të mbetjeve. Nga pikëpamja teknike, mbetjet e përziera shtëpiake (ose mbetjet fundore) mund të grumbullohen me qese plastike ose çdo lloj konteneri. Megjithëse ka eksperiencë me grumbullimin e letrës, kartonit dhe qelqit në qese plastike, për shkak të vëllimit dhe dendësisë së lartë, ky është një sistem më pak i përshtatshëm për këto lloj mbetjesh. Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike (veçanërisht të mbetjeve ushqimore të kuzhinës) mënyra më e përshtatshme është grumbullimi i koshave individuale për secilin gjenerues mbetjesh (apo grupe gjeneruesish). Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bimore të kopshtit, mund të ngrihen pika grumbullimi (kryesisht të mbikëqyrura). Mbetjet, të cilat gjenerohen në sasi të vogla dhe më rrallë, si ato elektrike dhe elektronike apo mbetjet tekstile, grumbullohen zakonisht në pika grumbullimi të caktuara.

4.3.3.2.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Në thelb, grumbullimi i mbetjeve ka një ndikim pozitiv në mjedis. Jeta në zonat urbane nuk do të ishte e mundur pa grumbullimin e mbetjeve. Sidoqoftë, edhe sisteme të ndryshme grumbullimi mund të kenë pak a shumë ndikime të pafavorshme në mjedis:

- Aromat e rënda: teknologjia e përdorur dhe frekuenca e grumbullimit do të zgjidhet në mënyrë të tillë që të mos shkaktohen shqetësime për shkak të aromave të pakëndshme nga mbajtja e përkohshme brenda shtëpive apo në zonat publike. Në



rastin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve organike aroma e rëndë është një çështje e rëndësishme, sidomos gjatë muajve të verës.

- Zhurma: Sa i përket gjenerimit të zhurmës, faktorët që lidhen me të janë pajisjet e përdorura dhe koha e kryerjes së shërbimit. Grumbullimi i mbetjeve gjatë natës mund të jetë një alternativë e mirë duke pasur parasysh se gjatë ditës ka më tepër trafik. Sidoqoftë, duhet marrë në konsideratë dëmtimi që u shkaktohet banorëve nga zhurmat.
- Ndikimi pamor: kontenierët e mëdhenj në trotuare (p.sh. një numër kontenierësh depo për grumbullimin e materialeve të riciklueshme) ose hedhja e mbetjeve jashtë kontenierëve, p.sh. për shkak të frekuencës së ulët të grumbullimit, mund të kenë ndikim pamor negativ.
- Parazitët dhe brejtësit: Frekuencat e ulëta të grumbullimit dhe kontenierët në gjendje të keqe sanitare mund të tërheqin parazitë dhe brejtës përreth pikave të grumbullimit.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike dhe materialeve të riciklueshme kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara ligjore për mbrojtjen mjedisore. Grumbullimi i diferencuar dhe aktivitetet e mëtejshme të kompostimit dhe riciklimit ndihmojnë në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në reduktimin e ndikimeve mjedisore negative të vend deponitimit.

Tabela 33 Vlerësimi mjedisor për grumbullimin e mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)

L02	Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)
L02-01	Grumbullimi i mbetjeve të përziera
L02-02	Grumbullimi i mbetjeve organike
L02-03	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	L02-01	++
	L02-02	+
	L02-03	0
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	L02-01	++
	L02-02	0
	L02-03	0



Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	+
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	+
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	+
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	L02-01	O
	L02-02	+
	L02-03	++
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	L02-01	O
	L02-02	+
	L02-03	++
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	L02-01	++
	L02-02	++
	L02-03	++
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	+
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	L02-01	+
	L02-02	++
	L02-03	++
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	++
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	+
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	L02-01	+

Objektivi mjedisor/ synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
	L02-02	+
	L02-03	+
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	L02-01	+
	L02-02	+
	L02-03	++

4.3.3.3 Kompostimi (Rikuperim i materialit)

Kompostimi është në thelb një proces stabilizimi aerobik i mbetjeve organike. Synimi kryesor i kësaj alternative trajtimi është t'i stabilizojë mbetjet dhe në këtë mënyrë të reduktojë sasinë e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme (MBB) që çohen në vend depozitim. Synime të tjera të kompostimit janë reduktimi i emetimeve nga mbetjet e depozituara dhe shitja e kompostit ose plehut organik me cilësi të lartë. (Rikuperimi i materialit).

Në Europë prodhimi i kompostit nga mbetjet shtëpiake të përziera është një çështje që ka ngjallur diskutime. Kompostet me cilësi të dobët nga mbetjet e përziera që u prodhuan në Gjermani midis viteve 1950 dhe rreth 1980 krijuan një reputacion të keq për këtë lloj komposti. Për pasojë ndarja në burim e mbetjeve të gjelbra nga kopshtet dhe e mbetjeve organike nga kuzhina filluan të ndërmerreshin nga viti 1983 e në vazhdim. Kjo bëri që të arrihej një cilësi shumë më e mirë e kompostit dhe ai të pranohej më gjerësisht. Kështu, grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të gjelbra të kopshteve apo i mbetjeve organike të kuzhinës është një kërkesë bazë për të zbatuar këtë teknologji trajtimi.

Kompostimi i mbetjeve organike nga bujqësia dhe kopshtaria ka një traditë të hershme jo vetëm në Europën Qendrore, por edhe në Shqipëri. Megjithatë nuk ka një eksperiencë të suksesshme kohët e fundit me kompostimin e mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri. Megjithëse rregulloret në Shqipëri i detyrojnë bashkitë të fillojnë me grumbullimin e diferencuar të fraksioneve të ndryshme (materiale të riciklueshme të thata, mbetje organike për kompostim dhe mbetje fundore të pariciklueshme), deri tani ka një angazhim shumë të kufizuar të bashkive shqiptare për të realizuar kompostimin.



Në drejtim të ndarjes së mbetjeve në burim nga familjet apo bizneset vihen re shumë pak nisma zyrtare. Por në të ardhmen, parashikohet që mbetjet bashkiake organike të grumbullohen në mënyrë të diferencuar dhe të kompostohen, për të përmbushur kërkesat ligjore. Për këtë arsye, impiante kompostimi pilot tashmë janë planifikuar në kuadër të projekteve të mëposhtme:

- Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për Projektin e Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta për Qarkun e Vlorës, Shqipëri (financuar nga KfW)
- Shërbime konsulence për Masat Shoqëruese të Projektit Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Shqipërinë Juglindore (financuar nga KfW)
- Menaxhimi i Integruar dhe Miqësor ndaj Klimës dhe Riciklimi (Program i GIZ)

Duke synuar një zbatim të qëndrueshëm në shkallë të gjerë të impianteve të kompostimit, rekomandohet që në fillim të testohet zbatimi dhe funksionimi me anë të impianteve pilot për mbetjet e gjelbra dhe të kopshteve.

4.3.3.3.1 Përshkrimi i teknologjisë

Kompostimi është një proces stabilizimi aerobik i substancave organike. Ka disa teknologji të ndryshme kompostimi, nga kompostimi i thjeshtë në pirgje e deri në impiantet e mbyllura të automatizuara plotësisht.





Figura 22 Shembull i një impianti kompostimi me ajrosje artificiale: materiali i sjellë, mbushja e kontenierëve me ajrosje, kompostimi në kontenierë, komposti i situar⁵¹

Përmasat e rekomandueshme të impiantit (kapaciteti) dhe kostot përkatëse të stabilizimit aerobik varen nga lloji i teknologjisë që përdoret. Kompostimi i thjeshtë në kavaleta pa ajrosje aktive është zgjidhja më pak e kushtueshme e përshtatshme për impiante shumë të vogla kompostimi; kostot për sistemet e automatizuara plotësisht të mbyllura zakonisht janë disa herë më të larta. Për rrjedhojë, këto sisteme janë të rekomandueshme vetëm për një kapacitet të caktuar (> 10,000 Mg/vit). Këto të dytat, megjithatë kanë avantazhe të qarta sa i përket nevojës për hapësira dhe kontrollit të emetimeve. Përkundrazi, kompostimi me kavaleta të hapura nuk rekomandohet për trajtimin e mbetjeve ushqimore dhe të kuzhinës. Për të shmangur apo zvogëluar emetimet e aromave të rënda dhe lëngut kullues, si edhe përhapjen e mizave, shpendëve dhe brejtësve, preferohen zgjidhjet e mbuluara ose të mbyllura.

4.3.3.3.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Në përgjithësi, kompostimi është një alternativë teknologjike që ndihmon shumë në mbrojtjen e klimës me anë të reduktimit të bio-mbetjeve që depozitohen në vend

⁵¹ INFRASTRUKTUR & UMWELT, Orhan Boran

depozitime dhe rrjedhimisht reduktimit të emetimeve të metanit në to. Në të njëjtën kohë, gjenerimi i lëngut kullues në vend depozitime reduktohet dhe kështu nga njëra anë rreziku i ndotjes së ujërave nëntokësore apo sipërfaqësore minimizohet dhe nga ana tjetër ulen kostot për trajtimin e lëngut kullues. Përfitime të tjera janë rikuperimi i materialit dhe për rrjedhojë ruajtja e burimeve.

Në kontrast me këtë, procesi biologjik i impianteve të kompostimit mund të gjenerojë emetime në ujë dhe ajër. Në varësi të kërkesave ligjore dhe në bazë të projektimit të impiantit duhet të përzgjidhen teknologjitë për trajtimin e ujit të përdorur (lëngut kullues) dhe ajrit të shkarkimit. Në këtë kontekst luan një rol të rëndësishëm lloji i mbetjeve që duhet të stabilizohen. Krahasuar me trajtimin e mbetjeve ushqimore dhe të kuzhinës, emetimet e shkaktuara nga degradimi i mbetjeve të gjelbra dhe kopshteve gjatë proceseve të kompostimit janë të papërfillshme. Në këtë rast, proceset e kushtueshme për trajtimin e ajrit të shkarkimit, si bio-filtri i kombinuar me oksidimin termik rigjenerues (RTO), nuk janë të nevojshme për të garantuar standardet europiane të emetimeve.

Ndaj, vlerësimi i ndikimeve mjedisore të kompostimit supozon që veçanërisht për mbetjet ushqimore dhe të kuzhinës të zbatohen teknologji të avancuara, që përfshijnë kapjen dhe trajtimin e ajrit të shkarkimit.

Tabela 34 Vlerësimi mjedisor për kompostimin (rikuperimi i materialit)

L03	Kompostimi (rikuperimi i materialit)
L03-01	Impiant kompostimi me kavaleta
L03-02	Impiant i mbyllur i automatizuar plotësisht

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	L03-01	0
	L03-02	0
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	L03-01	+
	L03-02	0
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	L03-01	+
	L03-02	+
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	L03-01	+
	L03-02	+
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	L03-01	++
	L03-02	++

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	L03-01	++
	L03-02	++
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	L03-01	++
	L03-02	++
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	L03-01	+
	L03-02	++
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre kimik	L03-01	+
	L03-02	++
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	L03-01	+
	L03-02	++
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	L03-01	+
	L03-02	++
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	L03-01	O
	L03-02	O
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	L03-01	O
	L03-02	O
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	L03-01	+
	L03-02	++

4.3.3.4 Menaxhimi i mbetjeve inerte

4.3.3.4.1 Përshkrimi i teknologjisë

Mbetjet inerte gjenerohen kryesisht gjatë punimeve të ndërtimit dhe të prishjes së objekteve. Sipas Direktivës Kornizë 2008/98/EC për Mbetjet, deri në vitin 2020 vendet anëtare të BE do të arrijnë objektivin që të paktën 70% e mbetjeve të parrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet, duke përjashtuar materialet natyrore (dheun dhe gurët), do të përgatiten për t'u ripërdorur, ricikluar ose do t'u nënshtrohen proceseve të tjera për rikuperimin e materialit.

Menaxhimi gjithëpërfshirës i mbetjeve inerte përfshin nga njëra anë masat për të shmangur gjenerimin e mbetjeve inerte dhe nga ana tjetër alternativat e teknologjisë për të kryer grumbullimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e tyre. Përgatitja e mbetjeve inerte mund të kryhet në vend me anë të një pajisje trajtimi të lëvizshme ose të çohen në

një impiant trajtimi qendror dhe stacionar. Për largimin e mbetjeve fundore apo gjithë rrymës së mbetjeve inerte (nëse nuk është i mundur riciklimi) janë të nevojshme vend depozitimet për mbetje inerte.



Figura 23 Shembull i një impianti të lëvizshëm për trajtimin e MNP²²

4.3.3.4.2 Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat e mundshme për parandalimin ose reduktimin e ndikimeve mjedisore negative

Një ndikim i shkëlqyer në mjedis i menaxhimit të duhur të mbetjeve inerte mund të arrihet me anë të ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve nga ndërtimet dhe prishjet. Nga njëra anë, mbrohen burimet natyrore, ndërsa nga ana tjetër, minimizohet sipërfaqja e tokës që nevojitet për depozitimin e këtyre mbetjeve. Për më tepër, në Shqipëri parcelat e tokës ku depozitohen në mënyrë të paligjshme mbetjet inerte shumë shpejt kthehen në vendgrumbullime për çdo lloj mbetjeje tjetër për shkak të perceptimit të gabuar të publikut.

Impiantet e trajtimit, si ato të lëvizshme edhe ato stacionare, gjenerojnë kryesisht zhurmë dhe pluhur. Nëse trajtohen materiale të kontaminuara me substanca të rrezikshme, ekziston rreziku i ndotjes në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe në ajër.

Krahasuar me impiantet stacionare, trajtimi me impiante të lëvizshme ka avantazhin se nuk ka nevojë për transportin e MNP dhe kështu shmangen kostot dhe emetimet e mundshme të CO₂.

Vend depozitimet e mbetjeve inerte kanë standarde më të ulëta se vend depozitimet për mbetjet shtëpiake. Për rrjedhojë funksionimi i tyre është më i thjeshtë dhe rreziqet e punës janë më të ulëta. Megjithatë, si impiantet e trajtimit stacionar ashtu edhe vend depozitimet

e mbetjeve inerte duhet t'i nënshtrohen një procesi të gjatë për marrjen e lejes, përfshi vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Tabela 35 Vlerësimi mjedisor për menaxhimin e mbetjeve inerte

L04	Menaxhimi i mbetjeve inerte
L04-01	Trajtimi me pajisje të lëvizshme
L04-02	Trajtimi stacionar
L04-03	Depozitimi

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
Popullsia dhe shëndeti i njerëzve		
Përmirësimi i cilësisë së jetës	L04-01	+
	L04-02	+
	L04-03	0
Mbrojtja e shëndetit të njerëzve	L04-01	+
	L04-02	0
	L04-03	++
Biodiversiteti, flora dhe fauna		
Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike	L04-01	+
	L04-02	+
	L04-03	++
Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe e burimeve të tyre natyrore	L04-01	+
	L04-02	+
	L04-03	++
Përdorimi i dheut dhe tokës dhe i aseteve materiale		
Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të dheut	L04-01	0
	L04-02	0
	L04-03	0
Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efikasitetit të përdorimit	L04-01	+
	L04-02	++
	L04-03	-
Shfrytëzimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore	L04-01	+
	L04-02	++
	L04-03	-
Uji		
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i statusit të tyre ekologjik	L04-01	+
	L04-02	+
	L04-03	+
Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe përmirësimi i	L04-01	0

Objektivi mjedisor / synimi i VSM	Shkurtimi	Vlerësimi
statusit të tyre kimik	L04-02	0
	L04-03	0
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë		
Reduktimi dhe stabilizimi i emetimeve të gazit serrë	L04-01	-
	L04-02	0
	L04-03	0
Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit	L04-01	-
	L04-02	0
	L04-03	0
Peizazhi		
Ruajtja e diversitetit të peizazhit	L04-01	0
	L04-02	0
	L04-03	0
Trashëgimia arkitekturore, arkeologjike dhe kulturore		
Ruajtja dhe mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore	L04-01	0
	L04-02	0
	L04-03	0
Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor		
	L04-01	+
	L04-02	++
	L04-03	0

4.4 Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm të ndikimeve mjedisore të Planit të Investimeve MIMN

Janë vlerësuar ndikimet potenciale që vijnë si rezultat i zbatimit të masave të ndryshme të parashikuara në Planin e Investimeve MIMN. Ndikimet dhe rëndësia e tyre paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.



Tabela 36 Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm mjedisor

Lloji i masave/ shkurtimi	Përshkrimi	Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor
ZeM	Përcaktimi i Zonave të Mbetjeve	+
R	Komponentët rajonalë të menaxhimit të mbetjeve	
R01	Transferimi dhe transporti në distancë të largët i mbetjeve	
R01-01	Stacion transferimi me rampë	+
R01-02	Stacion transferimi me rampë dhe njësi kompaktore	++
R02	Trajtimi mekanik (IRM)	
R02-01	IRM e papastër	+
R02-02	IRM e pastër	++
R03	Trajtimi mekanik-biologjik (TMB)	
R03-01	TMB me tretje anaerobike	++
R03-02	TMB me stabilizim	++
R03-03	TMB me kompostim	0
R04	Tretje anaerobike	++
R05	Incinerimi i mbetjeve (me rikuperim energjie)	
R05-01	Incinerimi me skarë të lëvizshme	0
R06	Vend depozitim sanitar (depozitimi i sigurt i mbetjeve)	
R06-01	Vend depozitim sanitar	0
R06-02	Rehabilitimi i vend depozitimeve	+
L	Komponentët lokalë të menaxhimit të mbetjeve	
L01	Pastrimi i rrugëve	
L01-01	Fshirja manuale e rrugëve	++
L01-02	Fshirja mekanike e rrugëve	+
L02	Grumbullimi i mbetjeve (përfshi grumbullimin e diferencuar)	
L02-01	Grumbullimi i mbetjeve të përziera	+
L02-02	Grumbullimi i mbetjeve organike	+
L02-03	Grumbullimi i materialeve të riciklueshme të thata	++
L03	Kompostimi (rikuperimi i materialit)	
L03-01	Implant kompostimi me kavaleta	+
L03-02	Implant kompostimi i mbyllur i automatizuar plotësisht	++
L04	Menaxhimi i mbetjeve inerte	
L04-01	Trajtimi me pajisje të lëvizshme	+

Lloji i masave/ shkurtimi	Përshkrimi	Vlerësimi i përgjithshëm mjedisor
L04-02	Trajtimi stacionar	++
L04-03	Depozitimi	0

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, masat e Planit të Investimeve MIMN kanë ndikim pozitiv ose nuk kanë ndikim domethënës për shumicën e temave të mbrojtjes së VSM.

Dy masa të rëndësishme që nuk kanë marrë një vlerësim të përgjithshëm pozitiv janë përshkruar më poshtë më hollësisht, ndërkohë që theksohen aspekte të tjera për të minimizuar rreziqet dhe/ ose për të përmirësuar situatën ekzistuese:

- Incinerimi me skarë të lëvizshme:
 - Monitorimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe kontrolli i emetimeve janë të detyrueshme për një funksionim të sigurt dhe mjedisor. Ato kërkojnë procese të mirëorganizuara monitorimi dhe personel të kualifikuar.
 - Për të kontrolluar emetimet dhe për të arritur standardet e emetimeve që nuk vënë në rrezik shëndetin publik apo mjedisin, duhet të instalohen sisteme teknike komplekse, si p.sh. për trajtimin e gazit të shkarkimit. Vënia në punë dhe mirëmbajtja e tyre është e kushtueshme.
 - Mbetjet që dalin pas incinerimit janë problematike dhe kërkojnë një trajtim të sigurt në vijim, si depozitimin e mbetjeve të ngurta fundore në vend depozitimet për mbetje të rrezikshme ose trajtimi i ujërave të ndotur (nëse bëhet pastrimi me ujë i gazit të shkarkimit). Infrastruktura teknike përkatëse nuk duhet vetëm të zbatohet dhe të mirëmbahet, por kostoja duhet t'i shtohet kostove të incinerimit.
 - Duke pasur parasysh hierarkinë e mbetjeve, rikuperimi i materialit është i më i parapëlqyer sesa rikuperimi termik. Megjithatë, duke kryer ndarjen e njëkohësishme të materialeve të riciklueshme (qoftë në burim apo në impiantin e ndarjes), fuqia kalorifike e mbetjeve që do të digjen ulët dhe mund të ketë nevojë për përdorimin e lëndëve djegëse shtesë. Në këtë mënyrë, nuk mund të sigurohet një mbrojtje e vlefshme e burimeve.
 - Metalet që mund të nxirren nga filtrimi i hirit pas djegies janë me cilësi më të ulët për riciklim, krahasuar me metalet e grumbulluara veçmas që në burim.

- Vend depozitimi sanitar:
 - Për të garantuar që do të arrihen emetimet më të ulëta të mundshme nga një vend depozitim sanitar dhe do të përmbushen standardet e përcaktuara, duhet të ndiqen kërkesat përkatëse si gjatë ndërtimit edhe gjatë funksionimit. Kjo kërkon personel me kualifikimin e duhur.
 - Deri tani, pjesa më e madhe MNB depozitohet në vendgrumbullime ose në vend depozitime të pakontrolluara pa marrë masa efektive për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit. Do të duhen shumë vite që standardet e vend depozitimeve sanitare të arrihen në gjithë vendin. Kështu, veç ndërtimit të vend depozitimeve të reja sanitare rajonale, paralelisht duhet të përmirësohet edhe situata e vend depozitimeve a vendgrumbullimeve ekzistuese, duke i kthyer ato në vend depozitime (të përkohshme) të kontrolluara.⁵³ Këto masa mund të zbatohen në disa vendgrumbullime/ vend depozitime ekzistuese (më të mëdha) të përzgjedhura, në mënyrë që të përqendrohet depozitimi i mbetjeve vetëm në pak vend depozitime të mëdha ku punohet më mirë dhe në mënyrë të kontrolluar. Njëkohësisht, vendgrumbullimet më të vogla duhet të mbyllen dhe të rehabilitohen sa të jetë e mundur.
 - Bazuar në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, shmangia e mbetjeve, ripërdorimi dhe riciklimi kanë përparësi më të madhe sesa trajtimi dhe depozitimi i tyre. Kështu për një periudhë afatgjatë vend depozitimi sanitar do të vazhdojë të jetë një element i rëndësishëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve. Por depozitimi nuk do të shihet si një zgjidhje përfundimtare. Në vend të tij, sistemi i integruar MMN do të konsistojë në elementë/ komponentë të ndryshëm që bëjnë të mundur ripërdorimin/ riciklimin përpara se mbetjet fundore të depozitohen.

Nga sa shihet më sipër, masat nuk duhet të vlerësohen vetëm të veçanta, por edhe në ndërveprim me njëra-tjetrën në një sistem të integruar MMN.

Përzgjedhja e vendndodhjes luan një rol të rëndësishëm, veçanërisht për zbatimin e komponentëve rajonalë të menaxhimit të mbetjeve. Pra duhet të kryhet një përzgjedhje e detajuar e vendndodhjeve si pjesë e procedurave të planifikimit dytësor dhe të miratimit.

⁵³ Kërkesat kryesore për kthimin e një vendgrumbullimi në një vend depozitim (të përkohshëm) të kontrolluar përfshijnë disponueshmërinë e stafit të përhershëm dhe pajisjeve; regjistrimin dhe kontrollin e mbetjeve që sillen, depozitimin e planifikuar të mbetjeve në qeliza si edhe ngjeshjen e mbulimit të mbetjeve të depozituara; stabilitetin e skarpateve; menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe të lëngut kullues, masa dhe udhëzime për shëndetin dhe sigurinë, parandalimin e zjarreve në vend depozitim; rrethimin dhe kontrollin e përhapjes së mbetjeve dhe pluhurit.



5 Monitorimi

Autoriteti përgjegjës, pra MIE duhet të monitorojë ndikimet mjedisore të rëndësishme nga zbatimi i Planit të Investimeve MIMN. Kjo bëhet për të identifikuar efektet negative të paparashikuara në një fazë të hershme dhe për të mundësuar ndërhyrjet e nevojshme. Masat e monitorimit do të paraqiten në raportin mjedisor.

Gjithë informacioni mbi gjendjen mjedisore në Shqipëri menaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM). Çdo vit publikohet Raporti i Gjendjes së Mjedisit që përmban informacion rreth të gjithë komponentëve të mjedisit. Rrjetet kombëtare të monitorimit të mjedisit administrohen nga institucione dhe autoritete të ndryshme, të cilët monitorojnë dhe matin parametrat specifike:

- Universiteti Bujqësor i Tiranës: toka, pyjet
- Instituti i Shëndetit Publik: shëndeti i njerëzve, uji, cilësia e ajrit
- NJQV: mbetjet
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura: biodiversiteti, flora dhe fauna
- Shërbimi Kombëtar i Gjeologjisë: ujërat nëntokësore
- Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit: ujërat sipërfaqësore, klima
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës: biodiversiteti
- Universiteti i Tiranës, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar: zhurma

Duke përdorur rrjetet e monitorimit të përshkruar më sipër, mund të përcaktohet në përgjithësi ndikimi mjedisor. Nevoja për masa të tjera monitorimi mund të lindë në veçanti gjatë zbatimit të masave individuale. Më pas do të duhet që masat përkatëse të monitorimit të përcaktohen gjatë procedurave të planifikimit dytësor dhe miratimit.

Monitorimi i ndikimit mjedisor të Planit të Investimeve MIMN sigurohet gjithashtu nga rishikimi/ përditësimi i rregullt i këtij Plani. Synohet që Plani i Investimeve MIMN të rishikohet çdo vit. Ky është një proces në vazhdim që e lejon planin të përshtatet sipas rrethanave të ndryshuara.

6 Hapat e ardhshëm

Pas dorëzimit të Raportit Përfundimtar të Studimit VSM, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe kapitullit IV të VKM nr. 219 datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për konsultimin me grupet e

interesit dhe publikun dhe për dëgjesat publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor", Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do t'i dërgojë dokumentacionin e mëposhtëm MTM për shqyrtim dhe për nxjerrjen e deklaratës mjedisore:

- Kërkesë drejtuar Ministrit, duke dhënë shpjegime se si janë zbatuar kërkesat e ligjit për procedurat dhe çfarë vështirësi janë hasur gjatë procesit;⁵⁴
- Dokumenti i planit ose programit të propozuar për miratim;⁵⁵
- Raporti përfundimtar i VSM, ku të përfshihen edhe kërkesat dhe opinionet e dhëna nga grupet e konsultuara të interesit;⁵⁶
- Përmbledhje jo-teknike e raportit përfundimtar të VSM;⁵⁷
- Informacion mbi realizimin e konsultimeve me publikun dhe grupet e tjera të interesit përfshi rezultatet përkatëse;⁵⁸
- Faturën për pagesën e tarifës së shërbimit për shqyrtimin e kërkesës nga Ministria.

⁵⁴ Ky informacion është pjesë e këtij Raporti Përfundimtar VSM – shihni kapitujt 1 & 2.

⁵⁵ Ky dokument, Raporti Përfundimtar I Studimit të Sektorit i është vënë në dispozicion Ministrisë.

⁵⁶ Ky është dokumenti i përfunduar.

⁵⁷ Kjo është pjesë e Raportit Përfundimtar të Studimit VSM – shihni kapitullin 0.

⁵⁸ Ky informacion është pjesë e Raportit Përfundimtar të Studimit VSM.



Tabela 37 Parashikimi i përgatitjes së Planit të Investimeve MIMN dhe stadat kryesore të VSM

Detyra	4				5				6				7			
	Shtator				Tetor				Nëntor				Dhjetor			
	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	02	03	04	05
Kontrata kryesore																
Perfundimi dhe dorëzimi i Draft Studimit të Sektorit	█															
Seminar																
Rishikim dhe komente mbi Draft Studimin e Sektorit	█															
Atafti zyrtar për mënyrën e komenteve mbi Draft Studimin e Sektorit	█															
Rishikimi dhe dorëzimi i Raportit Përfundimtar të Studimit të Sektorit*	█															
Shpërndarja e Draft Studimit të Sektorit tek 61 bashkitë dhe aktorët kryesorë nga MIE, së bashku me kërkesën për komente	█															
Seminar për të diskutuar shqyrtimin e komenteve të aktorëve të ndryshëm shqiptarë në një version përfundimtar të Studimit të Sektorit	█															
Dorëzimi i versionit përfundimtar të Studimit të Sektorit*	█															
Vlerësimi Strategjik Mjedsor																
Punë përgatitore për VSM	█															
Takim me organizata jo-qeveritare	█															
Kuadri kohor për komente nga OJQ	█															
Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit Hulumtues Paraprak*	█															
Rishikim dhe komente mbi Draft Studimin e Sektorit	█															
Takim nën shtetë të mbulimit të VSM me MIE dhe MTM	█															
Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit Hulumtues Përfundimtar*	█															
Vlerësimi Mjedsor i Studimit të Sektorit	█															
Dorëzimi i Raportit Paraprak të VSM*	█															
Publikimi i Studimit Paraprak të VSM (min. 30 ditë, sipas VKM N°2019)	█															
Degëzë publike (sipas VKM N°2019)	█															
Marrje e komenteve nga publiku (15 ditë, sipas VKM N°2019)	█															
Komente rreth Studimit Paraprak VSM	█															
Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit Përfundimtar VSM*	█															

* Për shkak të punës së nevojshme për përkthimin, versioni shqip do të dorëzohet më vonë se versioni anglisht

Aktivitetet e Konsulentit:
 Aktivitet kryesor
 Punëdhna plotësuese e aktivitetit
 Dorëzimi i materialit të përgatitur

Aktivitetet e MIE:
 Aktivitete
 Transferimi i informacionit tek Konsulentit



7 Shtojcat



**7.1 Shtojca 1: Përmbledhje ekzekutive e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për
Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri"**



0 Përmbledhje ekzekutive

I Hyrje

Banka Gjermane për Zhvillim, KfW Entwicklungsbank mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të përmirësuar situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend. Midis të tjerave është rënë dakord për përgatitjen e një Studim Sektorial mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri. Partneri shqiptar i Projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka pasur një përparim të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, zbatimi në nivel rajonal apo vendor dhe arritja e objektivave të rënë dakord ka mbetur ende mbrapa. Pika kryesore midis planifikimit dhe zbatimit është aspekti financiar. Pra, objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (MMN)
- të përcaktojë kostot dhe të përlogaritë tarifat e ardhshme
- të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm për përcaktimin e prioriteteve për investimet në infrastrukturën e MIMN
- të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë sipas fazave në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin e tyre, si dhe impiantet për trajtimin dhe/ose depozitimin e mbetjeve
- të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale
- të propozojë masa të tjera shoqëruese

Studimi i Sektorit është i orientuar nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si edhe për mbrojtjen e mjedisit.



II Situata e Tanishme e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime të dukshme në lidhje me hartimin e një kuadri rregullues. Për më tepër, mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve është zgjeruar dhe janë ndërmarrë hapat e parë për ricklimin formal dhe përmirësimin e asgjesimit të mbetjeve.

Megjithatë, përparimi i përgjithshëm është i ngadaltë dhe në përgjithësi nuk janë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga politika dhe korniza ligjore. Pengesat kryesore dhe mangësitë e sektorit të MMN përfshijnë:

- Ndarje e paqartë ose jo-funksionale e përgjegjësive në nivel kombëtar,
- Organizim i paqartë ose jo-funksional i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel "rajoni",
- Politikat, planet dhe rregulloret ekzistuese (ende) nuk janë vënë në zbatim,
- Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe institucionale,
- Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime dhe vendgrumbullime të menaxhuara keq,
- Financim i pamjaftueshëm i shërbimeve të përparuara të menaxhimit të mbetjeve,
- Mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe e masave zbatuese.

Faktori më i rëndësishëm i suksesit për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri do të jetë financimi i qëndrueshëm i shërbimeve. Për momentin, janë ndërmarrë disa nisma të ndryshme në lidhje me këtë çështje, përfshirë këtu

- Përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e kostos dhe vendosjen e tarifës
- Qartësimin e përparësive dhe kriterëve për investimet në MMN
- Zgjerimin e bazës së të ardhurave, p.sh. nëpërmjet zbatimit të skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit.

III Alternativat Teknologjike për MMN

Shkurtimisht përshkruhen disa alternativa teknologjike të testuara që janë në përputhje me politikat dhe të mundshme nga ana financiare, si dhe krahasohen kundrejt kërkesave përkatëse institucionale, kriterëve teknike, rëndësisë socio-ekonomike, ndikimeve mjedisore dhe karakteristikave financiare. Përsa i përket rëndësisë së mundësisë financiare, në tabelën e mëposhtme jepet njëpërmbledhje e specifikimeve kryesore të elementëve të MMN. Meqenëse në Shqipëri mungon një përvojë afatgjatë për kostot e



Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri - Studim Sektori mbi Nevojën për Investime

Raporti Përfundimtar i Studimit të Sektorit MIMN Përmbledhje Ekzekutive

trajtimit të mbetjeve, kostot përkatëse janë marrë nga baza e të dhënave referuese të BE-së.

Përmbledhje e Specifikimeve Kryesore të Elementëve të MMN

Elementi i MMN	Prodhim minimal	Lloji i Mbetjeve	Investimi specifik	Kosto Specifike Neto		Ekonomi e shkallës	Shënime
				bdhur me prodhimin vjetor	konvertuar për një sistem referues me 50,000 t/vit mbetje të grumbulluara		
Pastimi i rrugëve							
Pastrimi manual i rrugëve	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	6.6 EUR/t (50,000 t/v)	10.5 EUR/t	10.5 EUR/t	e ulët	Kostot specifike të floganturave në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara prej 50,000 t/vit
Pastrimi mekanik i rrugëve	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	17.3 EUR/t (50,000 t/v)	11.3 EUR/t	11.3 EUR/t	e ulët	Kostot specifike të floganturave në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara prej 50,000 t/vit
Grumbullimi i mbetjeve							
Grumbullimi i mbetjeve të përziera	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	44 EUR/t (25,000 t/v)	17.2 EUR/t	8.6 EUR/t	e mesme	Në bazë të floganturave për Rajonin e Korçës
Grumbullimi i mbetjeve organike	Fleksibel*	Mbetje organike	36 EUR/t (15,000 t/v)	16.7 EUR/t	5.6 EUR/t	e mesme	Në bazë të floganturave për Rajonin e Korçës
Grumbullimi i materialeve të thata të ciklueshme	Fleksibel*	Materialë të thata të ciklueshme	116 EUR/t (10,000 t/v)	35.4 EUR/t	7.1 EUR/t	e mesme	Në bazë të floganturave për Rajonin e Korçës
Transferimi dhe transportimi i mbetjeve							
Stacione transferimi me rampa	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	17.2 EUR/t (50,000 t/v)	7.6 EUR/t	7.6 EUR/t	e mesme	Për një distancë mesatare transporti prej 50 km
Stacione transferimi me rampa me ndeshje	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	18.8 EUR/t (50,000 t/v)	7.2 EUR/t	7.2 EUR/t	e mesme	Kursimet minimale kundrejt rrezikut të mosfunksionimit, për një distancë mesatare transporti prej 50 km
Impant i Rikuperimit të Materialeve (IRM)							
Impant për ndarjen e mbetjeve të përziera	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	100 EUR/t (50,000 t/v)	8 EUR/t**	6 EUR/t**	e mesme	Cilësia e materialeve të ciklueshme e dobët në krahasim me një impant Rikuperimi Materialeve të pastër
IRM e pastër	Fleksibel*	Materialë të thata të ciklueshme të grumbulluara të ndara	80 EUR/t (10,000 t/v)	25 EUR/t**	5 EUR/t**	e mesme	Pa kostot e grumbullimit të veçantë
Trajtimi Mekanik, Biologjik (TMB)							
TMB me TA	> 10,000 t/v	Mbetje bashkuake të përziera	291 EUR/t (50,000 t/v)	73 EUR/t**	73 EUR/t**	e lartë	Kërkesa të larta për trajtim anaerobik të mbetjeve bashkuake të përziera
TMB me stabilizim	> 25,000 t/v	Mbetje bashkuake të përziera	252 EUR/t (50,000 t/v)	58 EUR/t**	58 EUR/t**	e lartë	Impantet ekzistuese në Gjermani kanë një prodhim mesatar prej 150,000 t/vit
TMB me tharje biologjike (DPM)	> 10,000 t/v	Mbetje bashkuake të përziera	194 EUR/t (50,000 t/v)	52 EUR/t**	52 EUR/t**	e mesme	Fushë e lartë kërkesë
Kompostimi (Rikuperimi i Materialeve)							
Kompostimi me kaveleta	Fleksibel*	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	140 EUR/t (5,000 t/v)	20 EUR/t	2 EUR/t	e ulët	Trajtimi i mbetjeve ushqimore sjell kërkesa më të larta teknike
Plotesaht automatike brenda impianteve	> 10,000 t/a	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	200 EUR/t (25,000 t/v)	50 EUR/t	25 EUR/t	e lartë	Në bazë të Raportit për Studimin e Konceptit dhe Fizibilitetit për Rajonin Kakhet, Gjeorgji
Trajti Anaerobik (Rikuperimi i Energjisë)							
Trajti Anaerobik (TA)	Fleksibel*	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	170 EUR/t (25,000 t/v)	50 EUR/t**	25 EUR/t**	e mesme	Në bazë të floganturave për Studimin e Fizibilitetit për Rajonin Kakhet, Gjeorgji
Incinerimi i Mbetjeve (Rikuperimi i Energjisë)							
Incinerimi me shkëmb të lehtë	> 50,000 t/v	Mbetje bashkuake të përziera	638 EUR/t (100,000 t/v)	123 EUR/t**			Impant incinerimi me një trajtim të theksuar të gazit të lëshuar nga oxhaku dhe përdorni i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë (CHP)
Vend depozitim sanitar (Depozitim i shkurtra i mbetjeve)							
Vend depozitim sanitar	> 30,000 t/v	Mbetje bashkuake të përziera	115 EUR/t (50,000 t/v)	24.7 EUR/t	24.7 EUR/t	e lartë	Për shkak të ekonomisë së shkallës, përmasat minimale të landfilleve sanitare duhet të jenë 100 t/ditë
Rehabilitimi i vend depozitimit	Fleksibel*	Mbetje bashkuake të përziera	95.2 EUR/t (39,000 t/v)	95.2 EUR/t	122 EUR/t	e ulët	Kostot mesatare të bazuara në konceptin për rehabilitimin e vend-grumbullimeve për rajonin e Korçës
Menaxhimi i Mbetjeve Inerte							
Trajtim i me Njësi të Lehtë	> 30,000 t/v	Mbetje inerte të ndërtimeve dhe pishave të objekteve	10 EUR/t (50,000 t/v)	5.4 EUR/t**	5.4 EUR/t**	e mesme	Kostot specifike pa marrë parasysh rrezikun dhe fitimin për operatorin privat
Trajtim me Njësi të Përlëshueshme	> 100,000 t/v	Mbetje inerte të ndërtimeve dhe pishave të objekteve	19 EUR/t (100,000 t/v)	4.3 EUR/t**	6.6 EUR/t**	shumë e lartë	Rreziku dhe fitimi dhe kostot e transportimit për derigimin në impant nuk janë të përfshira në kostot specifike
Vend depozitim	> 2,000 t/v	Mbetje inerte	26 EUR/t (50,000 t/v)	6.0 EUR/t	6.0 EUR/t	e mesme	Llogaritja e kostos është bazuar në standardet e një vend depozitim LC I



IV Bashkëpunimi Ndërbashkiak për Menaxhim të Përparuar të Mbetjeve

Përcaktimi i Veprimtarive Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Identifikimi i Zonave të Mbetjeve

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë kanë përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Gjithësesi, disa elementë të një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje të një shkalle më të gjerë për të funksionuar me efikasitet dhe me kostojë më të ulët. Meqenëse pjesa më e madhe e bashkive në Shqipëri janë shumë të vogla për një funksionim efikas të impianteve në shkallë të gjerë, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive e përkatësisht një përcaktim zonash ose i ashtuquajtur "rajonalizim".

Implantet e një shkalle më të gjerë që u shërbejnë dy apo më shumë bashkive quhen "rajonale", edhe pse zona e mbetjeve (zona e mbulimit) e implantit përkatës mund të jetë ndryshe nga kufijtë rajonalë.

Një kusht i domosdoshëm për identifikimin e impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve është përcaktimi i zonave përkatëse të mbetjeve. Për të përcaktuar këto zona mbetjesh, është e rëndësishme që, së pari, të qartësojmë cili element/implant i MMN është

- **Rajonal:** zona e mbulimit/zona e shërbimeve përfshin më shumë se një bashki
- **Lokal:** zona e mbulimit/zona e shërbimeve zakonisht përfshin vetëm një bashki ose madje vetëm pjesë të një bashkie

Elementët e mëposhtëm do të konsiderohen si "rajonale":

- Transferimi dhe transportimi në distancë të largët (me mjete të tonazhit të lartë) pas transferimit
- Trajtimi i mbetjeve të pariciklueshme (përfshirë Trajtimin Mekanik Biologjik dhe Incinerimin)
- Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime sanitare

Elementë të tjerë mund të përfshihen në sferën e veprimtarive rajonale duke u bazuar në një analizë të kushteve aktuale kuadër. Në çdo rast, mund të përfshihet edhe sektori privat për veprimtari të ndryshme.

Stacionet e Transferimit për Transportim Efikas në Distancë të Largët

Me realizimin e impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve, do të zgjaten edhe distancat e transportimit nga burimi i gjenerimit të mbetjeve në vendet e ardhshme të

trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve. Teksa në Shqipëri praktika e zakonshme është që mbetjet e grumbulluara në një bashki depozitohen në një vend depozitim (vendgrumbullim) në afërsi, në të ardhmen, për mbetjet e grumbulluara mund të jetë e nevojshme që të transportohen në një impiant rajonal të menaxhimit të mbetjeve në një distancë prej 50 ose madje edhe 100km. Siç u përmend edhe më parë, avantazhet financiare të impianteve në shkallë të gjerë për trajtimin e mbetjeve [të gjeneruara në zona më të mëdha të mbulimit (zona e mbetjeve)] duhen të jenë të balancuara me kostot shtesë për transportimin në distancë të largët, çka zakonisht trajtohet në studimet e detajuara të konceptit dhe fizibilitetit.

Për efekt të këtij plani investimi përdoret si standard matës një distancë transportimi prej më shumë se 30 km, për të treguar nëse nevojitet një stacion transferimi. Për rrjedhojë, plani i investimit tregon se ku janë të nevojshme stacionet e transferimit dhe paraqet kostot përkatëse të investimit. Vendndodhjet e sakta të stacioneve të transferimit duhet të identifikohen gjatë planifikimit të detajuar të menaxhimit të mbetjeve (p.sh. në planet vendore të menaxhimit të mbetjeve ose në studimet e konceptit dhe fizibilitetit të projekteve për MMN) ose në planifikimin bashkiak (p.sh. në planet vendore të zhvillimit).


Zonat e Mbetjeve për Bashkëpunim Ndërbashkiak

Për të gjithë Shqipërinë përcaktohen zonat e mbetjeve, kështu që të gjitha bashkive u është caktuar një impiant i veçantë rajonal i menaxhimit të mbetjeve (ekzistues ose i planifikuar). Për të përcaktuar zonat e mbetjeve (zonat e mbulimit) janë identifikuar fillimisht impiantet moderne ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit të mbetjeve përfshirë dhe zonat e tyre të mbulimit. Më pas, zonat që kanë mbetur janë ndarë në zona të mbetjeve, të cilat mund të devijojnë nga kufijtë e qarkut, dhe kjo për shkak të:

- faktorëve ekonomikë (sasive të mbetjeve dhe ekonomisë së shkallës)
- logjistikës (distanca dhe gjendjes së rrugëve, sasive të mbetjeve që janë për t'u transportuar)

Të gjitha zonat e mbetjeve, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të reja janë të paraqitura në hartën e përgjithshme më poshtë.





harta e zonave të mbetjeve dhe impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve



Funksionimi i Qëndrueshëm i Impianteve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë kanë përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Ligji Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton funksionet e bashkive si edhe përshkruan mënyrat se si duhet të menaxhohen shërbimet vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet një apo më shumë instrumenteve të mëposhtëm:

- Njësive të tyre organizative
- Ndërmarrjeve të shërbimeve publike
- Lidhjen e kontratave me palë të treta
- Përdorimit të instrumenteve të duhura të partneriteteve publike dhe private

Kreu V i Ligjit Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore e përmend bashkëpunimin ndërmjet bashkive. Neni 14, paragrafi 5 përcakton:

“Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta.

Ky “Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta” për shembull, mund të ngrihet si një shoqëri aksionare (sh.a), siç është Shoqëria “Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë”. Ligji parashikon, përveç bashkive, edhe për përfshirjen e “Institucioneve të Qeverisë Qendrore”. Për menaxhimin e shërbimeve Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta mund të përfshijë edhe firma të sektorit privat ose të krijojë Partneritete Privat-Publik (PPP).

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se Ligji Nr.139/2015 parashikon kuadrin e ngritjes së sipërmarrjeve, ku përveç bashkive të zonës përkatëse të mbetjeve, mund të përfshihen edhe partnerë të tjerë, si për shembull institucione shtetërore ose kompani private. Sikurse tregon përvoja e deritanishme në Korçë, ngritja e një kompanie të tillë rajonale është mjaft sfiduese dhe kërkon kohë.


Një zgjidhje tjetër që pajtohet me parashikimet e Ligjit Nr.139/2015 do të ishte rasti kur një bashki merr përsipër përgjegjësinë për impiantet rajonale dhe lidh kontrata dypalëshe me bashkitë e tjera në zonën e mbetjeve. Pika e dobët e këtij modeli është se njëra nga bashkitë duhet të ketë dëshirën dhe të jetë e aftë që të marrë përsipër gjithë riskun e impiantit rajonal. Për rrjedhojë, ky model konsiderohet si i vlefshëm vetëm në raste të veçanta.



V Hartëzimi GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik) dhe Identifikimi i Vendndodhjeve të Impianteve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve

Për zonat e mbetjeve janë identifikuar vendndodhje të mundshme për vend depozitime sanitare dhe impiante të tjera të trajtimit të mbetjeve, por pa rënë dakord për vendndodhjen e saktë. Hapat e ndërmarrë për të arritur në identifikimin e këtyre vendeve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Hapat për identifikimin e vendndodhjeve për Qendrat Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve



Për identifikimin e vendndodhjeve të vendeve është përgatitur një bazë të dhënash GIS që mbulon të gjithë Shqipërinë. Në paraqitjen grafike negative, sipas kërkesave e standardeve të përcaktuara në legjislacion janë hartuar kriteret për përjashtimin e zonave të papërshtatshme.

Për territoret që mbetën (jo të përjashtuara) u krye një paraqitje grafike pozitive për identifikimin e zonave të përshtatshme për ngritjen e një qendre rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Rezultati i këtij veprimi janë zonat kandidate për qendrat e ardhshme të menaxhimit të mbetjeve, si edhe aspektet që duhet të merren parasysh në hetimet e mëtejshme për përzgjedhjen përfundimtare të vendeve për një projekt të mundshëm

investimi. Këto të dhëna dhe informacioni janë gjithashtu të disponueshme si shtresë dhe bazë të dhënash GIS.

VI Planifikimi i Investimeve


Instrumenti i Planifikimit të Investimeve – për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (IPI-MIMN)

Elementi thelbësor i planifikimit të investimeve është Instrumenti i Planifikimit të Investimeve – për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (IPI-MIMN); investimet e ardhshme në nivel rajonal dhe vendor janë marrë parasysh duke përdorur këtë instrument ndërveprues.

Fasha e planifikimit është e ndarë në tre faza: Faza 1: 2018 - 2022, Faza 2: 2023 - 2027, Faza 3: 2028 - 2032.

Tabela më poshtë ilustron skemën bazë të IPI-MIMN për Shqipërinë.

Skema bazë për Instrumentin e Planifikimit të Investimeve për MIMN



Plani i Investimeve

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të impianteve të reja rajonale të planifikuara, të cilat do të zbatohen gjatë tre fazave.

Objekte Rajonale/Zonat e Mbetjeve	WZ Berat	WZ Dibrë	WZ Fier	WZ Elbasan	WZ Korçë	WZ Kukës	WZ Shkoder-Lesha	WZ Tirane-Durres	WZ Vlore North	WZ Vlore South-Droksater	Totali
Faza 1 (2018 - 2022)											
Transport në Distanca të Largëta											
Ramp type transfer station	400 000		800 000	800 000			800 000	1 584 000		800 000	4 984 000
Ramp type TS with compaction											
Trajtimi i Mbetjeve											
Dry slurr											
MBT with AD								1 650 000	4 250 000		5 900 000
MBT with biological drying (RDF)											
MBT with composting											
Anaerobic Digestion (AD)											
Moving grate incineration			29 512 000						76 000 000		105 512 000
Aqgjuesimi i Mbetjeve											
Controlled Landfill		9 000 000				750 000					9 750 000
Sanitary Landfill	3 673 000		3 995 000				3 447 000	21 565 000	8 800 000	2 283 000	41 863 000
Totali për Fazën 1 (2018 - 2022)	4,073,000	1,000,000	29,512,000	900,000		750,000	4,287,000	107,820,000	11,000,000	2,624,000	142,019,000
Faza 2 (2023 - 2027)											
Transport në Distanca të Largëta											
Ramp type transfer station											
Ramp type TS with compaction											
Trajtimi i Mbetjeve											
Dry slurr											
MBT with AD											
MBT with biological drying (RDF)					11 100 000		14 848 000				25 948 000
MBT with composting	5 087 000								7 575 000	6 207 000	18 869 000
Anaerobic Digestion (AD)											
Moving grate incineration											
Aqgjuesimi i Mbetjeve											
Controlled Landfill											
Sanitary Landfill			4 567 000	4 342 000	3 377 000		5 473 000			2 508 000	20 277 000
Totali për Fazën 2 (2023 - 2027)	6,007,000		4,647,000	4,342,000	14,477,000		30,327,000		7,373,000	8,715,000	94,969,000
Faza 3 (2028 - 2032)											
Transport në Distanca të Largëta											
Ramp type transfer station											
Ramp type TS with compaction											
Trajtimi i Mbetjeve											
Dry slurr											
MBT with AD											
MBT with biological drying (RDF)											
MBT with composting											
Anaerobic Digestion (AD)											
Moving grate incineration											
Aqgjuesimi i Mbetjeve											
Controlled Landfill		421 000				298 000					719 000
Sanitary Landfill	2 131 000		4 068 000	4 732 000	3 577 000		5 873 000		3 478 000	2 727 000	27 484 000
Totali për Fazën 3 (2028 - 2032)	2,131,000	421,000	4,068,000	4,732,000	3,577,000	298,000	6,273,000		3,486,000	2,727,000	28,172,000

Përmbledhje e kostove të përlogaritura të investimit për impiantet e reja rajonale për zonën e mbetjeve sipas fazave të planifikimit [Euro]

Në tabelën tjetër jepen kostot e përlogaritura të investimit (për investimet vendore dhe rajonale) për secilën zonë mbetjeje dhe për nismën në nivel kombëtar për zbutjen e rrezikut të vendgrumbullimeve të mbetjeve.



Përmbledhje e kostove të përlogaritura të investimit për zonë mbetjeje sipas fazave të planifikimit [EURO]

Zona e Mbetjeve	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Total
ZM Berat	5,497,000	7,608,000	6,871,000	19,976,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>4,073,000</i>	<i>5,067,000</i>	<i>2,131,000</i>	<i>11,271,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>1,424,000</i>	<i>2,541,000</i>	<i>4,740,000</i>	<i>8,705,000</i>
ZM Dibër	1,773,000	3,012,000	1,910,000	6,695,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>1,000,000</i>		<i>421,000</i>	<i>1,421,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>773,000</i>	<i>3,012,000</i>	<i>1,489,000</i>	<i>5,274,000</i>
ZM Fier	32,303,000	8,933,000	15,128,000	56,364,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>29,312,000</i>	<i>4,567,000</i>	<i>4,968,000</i>	<i>38,847,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>2,991,000</i>	<i>4,366,000</i>	<i>10,160,000</i>	<i>17,517,000</i>
ZM Elbasan	3,587,000	6,698,000	10,730,000	21,015,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>800,000</i>	<i>4,342,000</i>	<i>4,732,000</i>	<i>9,874,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>2,787,000</i>	<i>2,356,000</i>	<i>5,998,000</i>	<i>11,141,000</i>
ZM Korçë	4,923,000	20,500,000	6,870,000	32,293,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>		<i>14,477,000</i>	<i>3,577,000</i>	<i>18,054,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>4,923,000</i>	<i>6,023,000</i>	<i>3,293,000</i>	<i>14,239,000</i>
ZM Kukës	1,354,000	2,081,000	1,334,000	4,769,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>750,000</i>		<i>288,000</i>	<i>1,038,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>604,000</i>	<i>2,081,000</i>	<i>1,046,000</i>	<i>3,731,000</i>
ZM Shkodër-Lezhë	9,890,400	27,674,000	16,413,000	53,977,400
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>4,266,400</i>	<i>20,327,000</i>	<i>5,873,000</i>	<i>30,466,400</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>5,624,000</i>	<i>7,347,000</i>	<i>10,540,000</i>	<i>23,511,000</i>
ZM Tiranë-Durrës*	140,622,900	25,101,000	35,153,000	200,876,900
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>101,829,900</i>			<i>101,829,900</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>38,793,000</i>	<i>25,101,000</i>	<i>35,153,000</i>	<i>99,047,000</i>
ZM Vlorë Veri	16,200,000	12,101,000	6,966,000	35,267,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>11,000,000</i>	<i>7,373,000</i>	<i>3,456,000</i>	<i>21,829,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>5,200,000</i>	<i>4,728,000</i>	<i>3,510,000</i>	<i>13,438,000</i>
ZM Vlorë Jug-Gjirokastër	5,232,400	13,047,000	7,046,000	25,325,400
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>2,882,400</i>	<i>8,716,000</i>	<i>2,727,000</i>	<i>14,325,400</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>2,350,000</i>	<i>4,331,000</i>	<i>4,319,000</i>	<i>11,000,000</i>
Zbutja e riskut në vend depozitime (të gjitha zonat e mbetjeve)	7,000,000			7,000,000
Shqipëria	228,383,000	126,755,000	108,421,000	463,559,000
<i>Kosto investimi rajonale</i>	<i>162,914,000</i>	<i>64,869,000</i>	<i>28,173,000</i>	<i>255,956,000</i>
<i>Kosto investimi vendore</i>	<i>65,469,000</i>	<i>61,886,000</i>	<i>80,248,000</i>	<i>207,603,000</i>

* Në Tiranë, kostot e investimit të impianteve rajonale, si edhe një pjesë e kostove për rehabilitimin e vend depozitimit brenda kostove vendore të investimit do të mbulohen nga një investitor privat në kuadër të një kontrate koncesionare.


Në Zonën e Mbetjeve Tiranë-Durrës ashtu si edhe në Zonën e Mbetjeve Fier, kostot e investimit të impianteve rajonale dhe një pjesë e kostove për rehabilitimin e vend



depozitimeve brenda kostove vendore të investimit do të mbulohet nga një investitor privat në kuadër të kontratave koncesionare.

Kërkesat për investime në total, deri në fund të fashës së planifikimit (2032), do të jenë rreth 256 milionë Euro për investimet rajonale dhe 208 milionë Euro për investimet vendore. Rrjedhimisht, për të gjithë vendin, në total, deri në fund të vitit 2032 do të duhen 463 milionë Euro për investime në sektorin e MMN. Në nivel vendor, bashkive do t'ju duhet të mbulojnë një sasi të konsiderueshme të kostove të investimit për zgjerimin e shërbimeve të grumbullimit, realizimin e grumbullimit të diferencuar dhe menaxhimin e mbetjeve inerte dhe në veçanti për mbylljen dhe rehabilitimin e vendgrumbullimeve ekzistuese të mbetjeve.

Diagrama e mëposhtme përmbledh kostot rajonale dhe vendore, në total, të investimit deri në vitin 2032 dhe paraqet përqindjen e kostove të investimit për secilin element të sistemit të MIMN në koston totale.



Përqindja dhe vlera e kostove të investimit për secilin element të MIMN [EURO]

Me ngjyrën portokalli tregohen investimet për elementët vendore të MMN, ndërsa kostot e investimit të paraqitura me ngjyrë blu lidhen me impiantet rajonale.

Kostot operative mesatare vjetore për të tre fazat e planifikimit për impiantet e tjera rajonale janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Totali i kostove operative vjetore për impiantet rajonale [EURO/vit]¹

Objekte Rajonale	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Transport në Distanca të Largëta			
Ramp type transfer station	1,099,000	1,116,000	1,179,000
Ramp type TS with compaction			
Trajtimi i Mbetjeve			
Dirty MRF	-67,000		
MBT with AD			
MBT with biological drying (RDF)		3,848,000	3,557,000
MBT with composting		3,462,000	3,163,000
Anaerobic Digestion (AD)			
Moving grate incineration	11,657,000	13,306,000	15,147,000
Asgjësimi i Mbetjeve			
Controlled Landfill	155,000	137,000	128,000
Sanitary Landfill	1,677,000	715,000	693,000

Totali i Kostove Operative për Objektet Rajonale	14,521,000	22,584,000	23,867,000
---	-------------------	-------------------	-------------------

Elementet vendore të MIMN	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Pastrimi i rrugëve			
Manual street sweeping	4,985,600	5,647,400	6,377,600
Mechanical street sweeping	524,000	870,100	1,285,900
Grumbullimi i mbetjeve			
Collection of mixed waste	7,818,700	7,979,100	8,485,700
Collection of organic waste	75,100	579,400	945,300
Collection of dry recyclables	566,200	1,163,100	1,451,300
Objekte Vendore			
Clean MRF			
Windrow composting	31,300	247,500	402,200
Fully automated in-house composting plant			
Landfill rehabilitation	130,000	107,800	197,400
Mobile Inert Waste Treatment			
Stationery Inert Waste Treatment			
Inert Waste Landfill	712,700	1,060,000	1,465,500

Totali i Kostove Operative për Elementet Vendorë të MIMN	14,844,000	17,655,000	20,611,000
---	-------------------	-------------------	-------------------

¹ Kostot operative të incinerimit përfshijnë vetëm kostot në Tiranë, të cilat bazohen në tarifën hyrëse. Kostot e incinerimit në Elbasan dhe Fier gjatë Fazës 1 konsiderohen të jenë zero, ndërsa kostot për Fazat 2 dhe 3 nuk dihen. Kështu, totali i kostove operative rajonale në Fazën 2 dhe 3 janë pa kostot e mundshme operative të incineratorëve në Elbasan dhe Fier.

Kostot operative të impianteve rajonale do të rriten ndjeshëm me zbatimin e impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve. Në Fazën 3 pritet një rritje e mëtejshme e kostove operative për shkak të rritjes së sasive të mbetjeve që do të trajtohen dhe asgjeshohen. Megjithatë, për momentin nuk dihen kostot operative të impianteve të incinerimit në Elbasan dhe Fier, për këtë arsye nuk mund të përlogariten në total kostot operative për të gjitha impiantet rajonale.

Përsa i përket elementëve vendorë të MMN, rritjet e kostove operative lidhen me sasi të rritura të mbetjeve që do të trajtohen gjatë viteve, si dhe forcimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve dhe rikuperimit të burimeve. Tabela e mëposhtme përmbledh kostot operative në total në nivel vendor.

Kostot vjetore operative në total për elementët vendorë të MMN [EURO/v]

Elementët Vendorë të MMV-ve	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Pastrimi i rrugëve			
Pastrimi manual i rrugëve	5,006,100	5,670,400	6,408,400
Pastrimi mekanik i rrugëve	524,000	870,100	1,285,900
Grumbullimi i mbetjeve			
Grumbullimi i mbetjeve të përziera	7,819,700	8,000,800	8,520,700
Grumbullimi i mbetjeve organike	75,100	555,500	906,800
Grumbullimi i materialeve të thata të riciklueshme	566,300	1,163,400	1,451,800
Impiantet Vendorë			
Impiant për rikuperimin e materialeve			
Kompostim me kavaletë	31,300	237,200	385,700
Kompostim tërësisht i automatizuar brenda në impiant			
Rehabilitimi i vend depozitimit	100,500	111,600	191,800
Trajtim me njësi të lëvizshme i mbetjeve Inerte			
Trajtim me njësi të palëvizshme i mbetjeve Inerte			
Vend depozitim për mbetjet inerte	878,200	1,081,700	1,304,900
Total kosto operative për impiante vendore	15,002,000	17,691,000	20,456,000

Në nivel rajonal dhe vendor, mesatarisht rreth 29 milionë Euro duhet të shpenzohen në vijë gjatë fazës së parë për të mbuluar kostot operative të sistemit MIMN. Drejt fundit të fashës së planifikimit, këto kosto do të rriten përafërsisht deri në 44 milionë Euro në vit.

Përditësimi i Planit të Investimeve

Duke pasur parasysh se MMN është një sektor që po zhvillohet shpejt në Shqipëri, Plani i Investimeve në MIMN duhet konsideruar si një dokument i gjallë. Për këtë arsye, masat e propozuara dhe zhvillimet e tjera në sektorin e MMN duhet të monitorohen për ta përditësuar planin rregullisht.

Plani i Investimeve mund të aktualizohet në çdo kohë nëse njihen ndryshimet në sektorin e MMN. Megjithatë, të paktën një herë në vit duhet rishikuar, mundësisht në kohën e duhur para vendimeve për buxhetin për vitin e ardhshëm financiar.

VII Efektet e Tarifës dhe Përballueshmëria Financiare



Tarifat e mundshme për familje janë llogaritur për aktivitetet vendore dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve të paraqitura në kapitujt e mëparshëm, bazuar në supozimet e mëposhtme:

- 80% e kostove të menaxhimit të mbetjeve do të financohen nga familjet dhe 20% nga subjektet tregtare
- Pagesa e tarifave supozohet se do të bëhet nga çdo familje

Gjithashtu janë përgatitur dy skenare, të cilët ndryshojnë nga njëri-tjetri sa i përket marrjes në konsideratë të kostove të investimit për masat rajonale, si dhe të kostove për rehabilitimin e vendgrumbullimeve në llogaritjen e tarifës. Skenari i parë supozon që këto kosto do të mbulohen nga tarifa, ndërsa skenari i dytë supozon se ato mund të mbulohen nga burime të tjera. Me supozimet e lartpërmendura, tarifat në skenaret 1 dhe 2 krahasohen me tarifën maksimale të përballueshme. Për përcaktimin e tarifës maksimale të përballueshme, u mor parasysh 1% e shpenzimeve vjetore për familje sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT për 2016.

Për Zonën e mbetjeve Fier dhe ZM Elbasan janë shtuar disa vija diagonale sepse nuk dihen akoma kostot operative të impianteve rajonale pas mbarimit të kontratave të koncesionit. Për Zonën e Mbetjeve Tiranë-Durrës në skenarin e dytë është përllogaritur që kostot e kontratës koncesionare konsistojnë në 70% kosto investimi dhe 30% kosto operative.





Përlllogaritja e tarifave për mbulimin e kostos dhe vlerësimi i përballueshmërisë financiare në zonat e mbetjeve

Duke pasur parasysh tarifat e përlogaritura të paraqitura në figurën e mësipërme, si edhe shkallën e ulët të arkëtimit të tarifave në shumë bashki, tarifat duhet të rriten në mënyrë të konsiderueshme për të siguruar zbatimin e sistemeve të qëndrueshme të MMN.

Meqenëse një rritje e shpejtë e tarifave nuk mund të pranohet nga populli, tarifat duhet të rriten gradualisht. Përveç parimeve të rikuperimit të kostos, "ndotësi paguan" dhe përballueshmërisë financiare, për vendosjen e tarifave duhet të merren parasysh parimet e mëposhtme:

- Barazi horizontale: çdokush paguan për nivelin e shërbimit dhe frekuencën e grumbullimit të mbetjeve në një zonë të caktuar shërbimi.
- Barazi vertikale: struktura e tarifës duhet të marrë parasysh kontekstin social dhe të pasqyrojë potencialin e ndryshëm financiar të gjeneruesve të mbetjeve.
- Transparencë: tarifat duhet të pasqyrojnë kostot dhe qytetarët duhet të jenë të informuar në mënyrë transparente rreth përlogaritjes së kostove dhe tarifave.
- Efektshmëri: sistemi i tarifimit duhet të jetë i thjeshtë dhe të përshtatet me të dhënat dhe informacionin e disponueshëm lidhur me grupet e ndryshme të paguesve potencialë të tarifës, si edhe sa më lirë që të jetë e mundur për koston e zbatimit për bashkinë.

Si një kusht paraprak për zbatimin e tarifave që mbulojnë koston, bashkitë duhet të jenë në gjendje të llogarisin kostot aktuale për menaxhimin e mbetjeve si edhe me përafërsi kostot në të ardhmen dhe zhvillimet e popullsisë/sasive të mbetjeve. Kjo mund të realizohet vetëm nëpërmjet sistemeve të duhura të monitorimit financiar dhe të performancës. Për këtë, bashkitë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre menaxhuese / administrative dhe në të njëjtën kohë të zbatojnë sisteme teknike që lejojnë procese të tilla monitoruese.

VIII Caktimi i Prioriteteve për Masat Rajonale të Investimit

Paralelisht, së bashku me identifikimin e masave të investimit, u përgatit edhe një metodologji për caktimin e prioriteteve për investimet e planifikuara. Faza e Caktimit të Prioriteteve ka në fokus çështjet e mëposhtme kryesore:

- Identifikimin e kriterëve për caktimin e prioriteteve për masat e investimit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake
- Identifikimin e treguesve dhe të dhënave burimore (të cilat janë në dispozicion ose mund të gjenerohen me përpjekje të arsyeshme) për matjen e kriterëve të përzgjedhura



- Hartimin e një metodologjie transparente dhe të kuptueshme për prioritizimin (bashkimi i kriterëve dhe vlerësimi i rëndësisë)

Janë përcaktuar pesë kriterë, kundrejt të cilave vlerësohet përparësia e një mase investimi. Secili kriter lidhet me një objektiv dhe përshkruhet nga një ose më shumë tregues. Këta tregues matin gjendjen dhe ndryshimet në terma sasiorë, cilësorë dhe përshkruar. Kriteret e përdorura për përcaktimin e përparësive janë:

- I. Ndikimi i investimit
- II. Shkalla e kontributit të projektit për një mjedis të pastër e të shëndetshëm
- III. Disponueshmëria e strukturave institucionale për funksionim të qëndrueshëm
- IV. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve
- V. Performanca dhe qëndrueshmëria financiare e shërbimeve vendore për menaxhimin e mbetjeve

Disponueshmëria e të dhënave, aktualisht, është një faktor kufizues për zhvillimin e sistemit të caktimit të prioritetëve. Tashmë gjendet informacioni për matjen e treguesve të Kriterëve I deri në III. Të dhënat për kriteret IV dhe V (performanca) duhet të shtohen në një fazë të mëvonshme, pasi të jenë ngritur sistemet përkatëse të monitorimit dhe raportimit në bashki.

Tre kriteret e para janë përdorur për prioritizimin e masave të investimit në zonat e mbetjeve, sepse vlerësimi mund të bëhet në bazë të informacionit që është në dispozicion. Pikët maksimale që duhet të arrihen janë 100.

Në tabelat e mëposhtme zbatohet sistemi i caktimit të prioritetëve për masat rajonale të investimeve në zonat e mbetjeve për fazën 1. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, çdo masë / projekt investimi merr një numër të caktuar pikësh, duke treguar përparësinë e tij. Projektet që i kanë siguruar tashmë fondet kanë përparësi më të lartë (100 pikë).

Sistemi i caktimit të përparësive nuk zbatohet për ndërtimin e qelizave të reja në vend depozitim. Kohëzgjatja e këtyre investimeve varet nga mbushja e vëllimit të qelizave ekzistuese të vend depozitimit përkatës.



Rezultatet e caktimit të prioriteteve të masave rajonale të investimit për fazën 1

Zona e Mbetjeve	Masa Investimi Rajonale në Fazën 1 (2018-2022)	Investimi [EUR]	Rezultatet e caktimit të prioriteteve	
			Pikët	Renditja
ZM Fier	Incinerim me skarë të lëvizshme	25,512,000	100	1
ZM Fier	Vend depozitim sanitar	3,000,000	100	1
ZM Tiranë-Durrës	IRM e papastër	1,650,000	100	1
ZM Tiranë-Durrës	Incinerim me skarë të lëvizshme	76,001,000	100	1
ZM Tiranë-Durrës	Vend depozitim sanitar	22,585,000	100	1
ZM Vlorë Veri	IRM e papastër	4,200,000	100	1
ZM Vlorë Veri	Vend depozitim sanitar	6,800,000	100	1
ZM Shkodër-Lezhë	Vend depozitim sanitar	3,467,000	85	8
ZM Shkodër-Lezhë	Stacione transferimi me rampë	800,000	85	9
ZM Vlorë Jug-Gjirokastrë	Vend depozitim sanitar	2,283,000	83	10
ZM Elbasan	Stacione transferimi me rampë	800,000	82	11
ZM Tiranë-Durrës	Stacione transferimi me rampë	1,594,000	68	12
ZM Vlorë Jug-Gjirokastrë	Stacione transferimi me rampë	600,000	67	13
ZM Fier	Stacione transferimi me rampë	800,000	56	14
ZM Kukës	Vend depozitim i kontrolluar	750,000	50	15
ZM Berat	Vend depozitim sanitar	3,673,000	48	16
ZM Berat	Stacione transferimi me rampë	400,000	48	17
ZM Dibër	Vend depozitim i kontrolluar	1,000,000	44	18

Rezultati i caktimit të prioriteteve gjatë të tre fazave është paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Rezultati i caktimit të prioriteteve për masat rajonale të investimit gjatë të tre fazave (pa ndërtimin e qelizave të reja në vend depozitim).

ZONA E MBETJEVE dhe MASAT E INVESTIMIT	Investimi [EUR]	KRITERET			Total pikët	Renditja
		Ndikimi i investimit	Kontributi për mjedis të pastër dhe të shëndetshëm	Disponueshmëria e strukturave institucionale rajonale		
ZM Berat						
Stacion transferimi me rampë	400,000	8	40	0	48	17
TMB me kompostim	5,067,000	8	0	0	8	23
Vend depozitim sanitar	3,673,000	8	40	0	48	16
ZM Dibër						
Vend depozitim i kontrolluar	1,000,000	4	40	0	44	18
ZM Elbasan						
Stacion transferimi me rampë	800,000	32	40	10	82	11
ZM Fier						
Stacion transferimi me rampë	800,000	36	20	0	56	14
Incinerim me skarë të lëvizshme	25,512,000				100	1
Vend depozitim sanitar	3,000,000				100	1
ZM Korçë						
TMB me tharje biologjike (LDPM)	11,100,000	16	0	20	36	19
ZM Kukës						
Vend depozitim i kontrolluar	750,000	10	40	0	50	15
ZM Shkodër-Lezhë						
Stacion transferimi me rampë	800,000	40	40	5	85	9
TMB me tharje biologjike (LDPM)	14,848,000	24	0	5	29	20
Vend depozitim sanitar	3,467,000	40	40	5	85	8
ZM Tiranë-Durrës						
Stacion transferimi me rampë	1,594,000	28	40	0	68	12
Ndarja e mbetjeve të përziera	1,650,000				100	1
Incinerim me skarë të lëvizshme	76,001,000				100	1
Vend depozitim sanitar	22,585,000				100	1
ZM Vlorë Veri						
Implant ndarje mbetje të përziera	4,200,000				100	1
TMB me kompostim	7,373,000	14	0	0	14	22
Vend depozitim sanitar	6,800,000				100	1
ZM Vlorë Jug-Gjrokastër						
Vend depozitim sanitar	2,283,000	28	40	15	83	10
Stacion transferimi me rampë	600,000	12	40	15	67	13
TMB me kompostim	6,207,000	12	0	15	27	21

Caktimi i përparësive kërkon një përditësim të rregullt (p.sh. një herë në vit para caktimit të buxhetit) me qëllim që të merren parasysh zhvillimet aktuale.



7.2 Shtojca 2: Raporti Hulumtues Përfundimtar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Përgatitjen e "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri"



Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë

KfW Entwicklungsbank
Palmengartenstr. 5 - 9
60325 Frankfurt a. M.
GERMANY

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Sheshi Skënderbej Nr. 5,
Tiranë
SHQIPËRI

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Përgatitjen e “Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri”

- Raport Hulumtues Përfundimtar -



24 Shtator 2018

IU INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

Julius-Reiber-Strasse 17
64293 Darmstadt
Germany

www.iu-info.de

COWI

Parallelvej 2
2800 Kongens Lyngby
Denmark

www.cowi.com

FLAG

Brigada 8, P. 6/2, K IV
Tirana
Albania

www.flag-al.org



TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	1
1.1	Vlerësimi Strategjik Mjedisor.....	1
2	Përshkrim i "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri"	3
3	Paraqitje e Përmbledhur e Situatës Ekzistuese të MMN-së në Shqipëri	6
3.1	Kuadri i Politikave dhe Rregullues	6
3.1.1	Kuadri Ligjor	6
3.1.2	Politikat dhe Planet në Nivel Kombëtar.....	6
3.2	Marrëveshje Institucionale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta	7
3.2.1	Niveli Kombëtar.....	7
3.2.1.1	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)	8
3.2.1.2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	9
3.2.2	Niveli Rajonal	10
3.2.3	Niveli Vendor.....	10
3.3	Shërbimet e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta	11
4	Paraqitje e Përmbledhur Aktorëve Kryesorë dhe Angazhimi i Tyre.....	13
5	Përshkrimi i Aspekteve Mjedisore Kryesore që do të Trajtohen në Studimin VSM	16
5.1	Sfera Gjeografike e Veprimit.....	16
5.2	Sfera Kohore e Veprimit.....	16
5.3	Pjesët e Studimit të Sektorit për t'u Vlerësuar	16
5.4	Aspektet Kryesore Mjedisore që Dalin nga Studimi i Sektorit.....	17
6	Përshkrimi i Sferës së Veprimit të Studimit Bazë Mjedisor për t'u Përgatitur në Studimin VSM.....	20
6.1	Burimet e të Dhënave Bazë	20
7	Rekomandim për Identifikimin e Ndikimit Specific dhe Metodologjitë Vlerësuese që do të Përdoren në Studimin VSM.....	24
7.1	Shqyrtimi i Alternativave	24



7.2	Identifikimi i Objektivave, Synimeve dhe Indikatorëve	25
8	Hapat e Ardhshëm	29
9	Shtojcat	30
9.1	Shtojca 1: Përmbledhje Ekzekutive e Studimit të Sektorit	31
9.2	Shtojca 2: Seminaret e Grupit të Punës Ndër-Ministror gjatë Përgatitjes së Studimit të Sektorit.....	32
9.3	Shtojca 3: Procesverbalet e Takimeve në Zonat e Mbetjeve	34
9.3.1	Shtojca 3.1: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Berat.....	35
9.3.2	Shtojca 3.2: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug - Gjirokastrë.....	36
9.3.3	Shtojca 3.3: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Fier.....	37
9.3.4	Shtojca 3.4: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Tiranë-Durrës	38
9.3.5	Shtojca 3.5: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Shkodër-Lezhë	39
9.3.6	Shtojca 3.6: Procesverbali i Takimit të Zonës së Mbetjeve Elbasan	40
9.4	Shtojca 4: Procesverbali i Takimit me OJQ	41

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Fazat e planit të investimit.....	5
Tabela 2	Aktorët kyç të përfshirë në procesin për përgatitjen e Studimit të Sektorit.....	14
Tabela 3	Elementët e Studimit të Sektorit të Propozuara për Vlerësim	17
Tabela 4	Elementët Mjedisorë dhe ndikimet potenciale	18
Tabela 5	Burimet e të dhënave bazë dhe shtrirja e vlerësimit	21
Tabela 6	Alternativat e shqyrtuara	25
Tabela 7	Projekt objektivat mjedisorë të VSM-së	26

LISTA E FIGURAVE

Figura 1	Fazat dhe raportet e Studimit të Sektorit	4
----------	---	---



LISTA E SHKURTIMEVE

AD	Tretje Anaerobike
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial
AKZM	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
ASIG	Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
CHP	Nxehtësi dhe Energji e Kombinuar
MNP	Mbetjet e Ndërtimeve dhe Prishjeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DLDP	Programi Decentralizimit dhe Zhvillimit Vendor
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Europian
EPR	Përgjegjësia e Zgjerruar e Prodhuesit
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
ESRI	Instituti Kërkimor i Sistemeve të Mjedisore
BE	Bashkimi Europian
FLAG	Fondacioni Shqiptar për Autonominë dhe Qeverisjen Vendore
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti i Paraaderimit
IPT	Mjet i Planifikimit të Investimit
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
PMIU	Planet e Menaxhimit të Integruar të Ujërave
IU	INFRASTRUKTUR & UMWELT
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim KfW Entwicklungsbank
LDP	Plani i Zhvillimit Vendor
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TMB	Trajtimi Mekanik Biologjik
MM	Ministria e Mjedisit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit



MRF	Objekt i Rikuperimit Material
MNB	Mbetje të Ngurta Bashkiake
MUD	Ministria e Zhvillimit Urban
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjetësimit dhe Kanalizimit
KKA	Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
PPP	Partneritete Publik Privat
QRM	Qendra Rajonale e Mjedisit
RDF	Lëndë Djegëse e Përftuar nga Mbetjet
ARM	Agjencitë Rajonale të Mjedisit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Anëtarësimit
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SECO	Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike i Zvicrës
ISHMP	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
MMN	Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta
ST	Stacion Transferimi
USAID	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UTM	Universal Transversal i Merkatorit
TVSH	Taksë mbi Vlerën e Shtuar
MPEE	Mbetje nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike
MM	Menaxhimi i Mbetjeve
QMM	Qendrat e Menaxhimit të Mbetjeve
ZM	Zona e Mbetjeve
ITUN	Impjant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura



1 Hyrje

KfW Entwicklungsbank mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të përmirësuar situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend. Midis të tjerave është rënë dakord për përgatitjen e një Studimi të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri. Partneri shqiptar i Projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Në kuadër të zhvillimit të "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri", do të përgatitet edhe një Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM).

INFRASTRUKTUR & UMWELT si Konsulenti Drejtues, në bashkëpunim me COWI dhe FLAG janë porositur për kryerjen e shërbimeve konsulente në lidhje me VSM-në.

1.1 Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Standartet ndërkombëtare që do të zbatohen për realizimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Studimin e Sektorit është *Direktiva 2001/42/KE për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara. (Direktiva VSM)*

Legjislacioni vendas për mjedisin që ka lidhje me procedurën e VSM-së është si më poshtë:

- Ligji 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" që ka ratifikuar Direktivën e BE-së 2001/42/KE, e njohur si Direktiva VSM, e cila kërkon që të ndërmerren një sërë planesh dhe programesh për mbarëvajtjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Qëllimi i përgjithshëm e këtij procesi është të harmonizojë kërkesat mjedisore me planet në proces përgatitjeje dhe me procesin e vendim-marrjes por edhe të rrisë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendim-marrjes.
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor përbën një nga kërkesat për miratimin e çdo plani hapësinor në Shqipëri, në bazë të Ligjit Nr. 107 / 2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin Territorial" dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe Ligjit 10440/2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"
- VKM nr.219 datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun si edhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor."
Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës, paragrafi 9 dhe Nenit 10 i Ligjit Nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor"



- VKM nr. 507, datë 10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis që do t'i nështrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor."

Objektivat e VSM-së janë të identifikojë, të përshkruajë dhe të vlerësojë:

- Ndikimet e mundshme të rëndësishme në mjedis me zbatimin e Studimit të Sektorit;
- Kufizimet më të rëndësishme mjedisore, të lidhura me burimet natyrore dhe ndryshimet klimatike, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e sektorit;
- Mundësitë e Studimit të Sektorit për të kontribuar në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, rritjes së qëndrësës klimatike të sektorit dhe popullsisë dhe nxitjes së zhvillimeve me nivele të ulëta karboni dhe kalimi drejt ekonomisë së gjelbër.

Institucioni përkatës për VSM-në është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Znj. Ornela Shoshi është pika e kontakti për çdo diskutim apo komunikim me MTM-në për procesin e VSM-së.

Për Studimin e Sektorit, VSM-ja përbëhet nga dy pjesë kryesore – një studim hulumtues dhe një Studim VSM-je. Rezultatet e studimit hulumtues janë të hartuara në këtë Raport Hulumtues.

Studimi hulumtues i VSM do të sigurojë:

- Një përshkrim të Studimit të Sektorit;
- Një përshkrim të shkurtër të politikave të sektorit të MMN-së, të kuadrit institucional dhe ligjor;
- Një përshkrim të shkurtër të sektorit të MMN-së;
- Një identifikim të aktorëve kryesore dhe angazhimin e tyre
- Një identifikim të ndërveprimeve kyçe midis dokumentit strategjik dhe mjedisit;
- Një tregues të qëllimit të studimit bazë mjedisor për t'u përgatitur;
- Një tregues për identifikimin e ndikimit kryesor dhe metodologjitë e vlerësimit që do të përdoren në studimin VSM.



2 Përshkrim i "Studimit të Sektorit mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri"

Gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime të dukshme në lidhje me hartimin e një kuadri regullues në përputhje me politikat e Bashkimit Europian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, zbatimi në nivelin rajonal apo vendor dhe arritja e synimeve të miratuara ka mbetur mbrapa. Pika kryesore mes planifikimit dhe zbatimit është aspekti financiar. Për këtë arsye objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

- përcaktimi i metodologjisë dhe teknologjisë së duhur për investimet e ardhshme në sektorin e MMN-së,
- përcaktimi i kostove dhe tarifave të duhura,
- sigurimi i një sistemi objektiv, të kontrollueshëm dhe transparent të caktimit të përparësive për investimet e infrastrukturës së MMN-së,
- sigurimi i një plani investimi të ndarë në faza për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN për një afat kohe të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin e tyre, si edhe me impjantet e trajtimit dhe/apo asgjësimit,
- propozimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe institucionale,
- propozimi i çdo mase tjetër shoqëruese.

Studimi i Sektorit udhëhiqet nga objektivat e Sektorit Kombëtar të MMN-së dhe veçanërisht nga dispozitat për shërbime të qëndrueshme të MMN në të gjithë vendin, për reduktimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, reduktimin e vend-depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si edhe për mbrojtjen e mjedisit.

Figura e mëposhtme tregon hapat kryesore të punës në Studimin e Sektorit si edhe raportet e projektit, të cilat janë dorëzuar pas çdo faze përkatëse të projektit.






Figura 1 Fazat dhe raportet për Studimin e Sektorit

Dokumenti strategjik që duhet t'i nështrohet VSM-së është rezultat i Fazës Përfundimtare të Studimit të Sektorit. Ai bashkon rezultatet e fazave të mëparshme. Pjesa kryesore e Studimit të Sektorit është një plan investimi i ndarë në faza, e cili u mundëson autoriteteve



të marrin vendime të shëndosha në lidhje me zhvillimet afat-gjate. Fazat e planit të investimit janë të përcaktuara siç tregohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1 Fazat e Planit të Investimit

Faza	Periudha
Faza 1 (afat-shkurtër)	2018 – 2022
Faza 2 (afat-mesme)	2023 – 2027
Faza 3 (afat-gjate)	2028 – 2032

Përmbledhja ekzekutive e Studimit të Sektorit është e bashkëngjitur në Shtojcën 1.



3 Paraqitje e Përmbledhur e Situatës Ekzistuese të MMN-së në Shqipëri

3.1 Kuadri i Politikave dhe Rregullues

3.1.1 Kuadri Ligjor

Legjislacioni shqiptar në lidhje me mjedisin në përgjithësi dhe menaxhimin e mbetjeve në veçanti ka ecur përpara si rezultat i transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e vendit. Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në përafrimin ligjor të kryer gjatë viteve të fundit. Kuadri është përforcuar dhe bashkërendimi i politikave në nivel qendror është përmirësuar.

Në Shqipëri, legjislacioni përbëhet nga ligje të krijuara nga Parlamenti, Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) dhe Udhëzimet e Rregulloret e ministrive. Të një rëndësie të veçantë për menaxhimin e mbetjeve janë ligjet e mëposhtme:

- Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
- Ligji për Vetëqeverisjen Vendore
- Ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore
- Ligji për Lejen Mjedisore
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Lidhur me VKM-të, të mëposhtme janë veçanërisht përkatëse:

- VKM për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
- VKM për Miratimin e Rregullave për Mbajtjen, Përditësimin dhe Publikimin e Statistikave për Mbetjet
- VKM për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim
- VKM për Landfill-et e Mbetjeve
- VKM për Incinerimin e Mbetjeve

3.1.2 Politikat dhe Planet në Nivel Kombëtar

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta Bashkiake në Shqipëri orientohet kryesisht nga detyrimet e bazuara në synimet dhe afatet kohore të përcaktuara në Direktivat e BE-së (si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Anëtarësimit), si edhe si pjesë e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve. Strategjia e MM dhe Plani i Veprimit është duke u përgatitur për momentin nga MTM, e cila është në proces të përgatitjes së projektit përfundimtar të



strategjisë për t'u kthyer në VKM. Objektivat specifike të strategjisë janë të sigurojë zgjidhje praktike për:

- Përbushjen e detyrimeve të veçanta të legjislacionit europian të KE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve
- Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM-të) në lidhje me sektorin e mbetjeve.
- Trajtimi në mënyrë të bashkërenduar dhe integruar i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat përballet vendi.

Marrëveshja e Stabilizim dhe Anëtarësimit (MAS) artikulon ambicjen e Shqipërisë për integrimin në BE dhe vendos objektiva afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Arritja e këtyre synimeve raportohet nëpërmjet një sërë raportesh vjetorë të BE-së për Shqipërinë. Zotimet në kuadër të MAS-it janë të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020 ose në Projekt Strategjinë Ndër-Sektoriale të Mjedisit (2015-2020)

3.2 Marrëveshje Institucionale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri janë të ndara ndërmjet niveleve kombëtare, rajonale dhe vendore. Përndarjet e këtyre funksioneve janë duke u rishikuar në kuadër të politikave kryesore që janë në zhvillim e sipër, d.m.th. në kuadër të *Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit*.

3.2.1 Niveli Kombëtar

Ligji 10463 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve është legjislacioni kyç që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve në organizatat e qeverisjes qendrore, përfshirë këtu Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë e saj të varura, Ministrinë e Infrastrukturë dhe Energjisë (MIE) – për momentin Partneri Shqiptar i Projektit për përgatitjen e Planit të Investimit për MIMN. Këtyre ministrive u janë caktuar detyra të veçanta nëpërmjet vendimeve specifike të Këshillit të Ministrave (shtator 2017). Kuadri ligjor është plotësuar më Ligjin 139/2015 për Vet-Qeverisjen Vendore, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e bashkive për menaxhimin e mbetjeve bashkiake.

Pamja institucionale në nivel qendror është propozuar për t'u rimodeluar me një autoritet qendror që përbush detyrat, të cilat i caktohen ministrive të ndryshme, të sugjeruara nga projekt dokumenti i tanishëm i strategjisë së menaxhimit të mbetjeve.



3.2.1.1 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)

MTM-ja është drejtuese për kuadrin e përgjithshëm rregullues dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve, dhe mbikëqyr plotësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme (shih më poshtë). Ajo është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve në vend. Së bashku me institucionet e tjera në varësi të saj, duke përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriatin e Shtetit të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria ka përgjegjësinë e përgjithshme për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Përgjegjësitë e veçanta të MTM-së, të rishikuara me ristrukturimin e përgjegjësive ministrore më shtator 2017 (VKM 509) përfshijnë të poshtë përmendurat:

- Hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, përfshirë standartet e trajtimit të mbetjeve, dhe pasojat që sjell në ajër, mjedis, në cilësinë e ajrit, për zhurmën, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimi i treguesve mjedisorë dhe cilësisë së ujit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis,
- Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare, Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale, si dhe zhvillimin e ligjeve dhe akteve të tjera nën-ligjore për të siguruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit, duke u përqendruar sidomos në zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, siç përcaktohet në Ligjin 10463 dhe akteve nën-ligjore pasuese,
- Lëshimin e lejeve për subjektet që veprojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përfshirë eksportin, dërgimin ndër-kufitar të mbetjeve të parrezikshme,
- Organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave përkatëse për çështje të ndryshme në lidhje me menaxhimin e mjedisit dhe përcakton e lejon ndërtimin e vendeve për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme, dhe subjekteve që transportojnë, asgjësojnë dhe trajtojnë mbetjet e rrezikshme,

Buxheti vjetor i caktuar për MTM-në për 2018, ka në qendër të tij programet për mbrojtjen e mjedisit dhe administrimin e pyjeve, përveç zhvillimit të turizmit.

MTM-ja ka caktuar Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve për çështje që kanë të bëjnë me mbetjet. Ai vepron si pjesë e Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit. MTM-ja për zbatimin dhe jetësimin e politikave mjedisore mbështetet nga: Agjencitë Kombëtare të Mjedisit (AKM-të) dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve (ISHPM) dhe nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM-të), me degë në të gjithë vendin që ndërveprojnë gjithashtu me autoritetet vendore.



Pavarësisht gamës së gjerë të përgjegjësive dhe autoritetit që i është dhënë këtyre institucioneve nga legjislacioni i tanishëm, opinioni i përgjithshëm është se ato funksionojnë me një numër të kufizuar personeli, me mungesa të pajisjeve bazë dhe të mjediseve të duhura, si dhe kanë kapacitete të pakta. Për këtë arsye, roli i tyre është paksa i kufizuar për mbledhjen e informacionit, i cili është shpesh i pasaktë dhe në kundërshtim me informacionin e dhënë nga institucionet e tjera dhe për përgatitjen e Raportit vjetor për Mbrojtjen e Mjedisit.

MTM-ja gjithashtu mbështet takimet e Komitetit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i krijuar me VKM 967, datë 25.10.2013 për bashkërendimin e politikave, përpjekjeve dhe burimeve në nivel kombëtar, për propozimin e masave legjislative dhe administrative për menaxhimin e mbetjeve dhe lëshon raporte vjetore për situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend. Komiteti mbështetet nga Grupi Kombëtar Këshillues (d.m.th. grup specialistësh teknikë) për Mbetjet e Ngurta.

3.2.1.2 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

Roli i MIE-së në sektorin e mbetjeve bazohet në Ligjin Nr. 10463 dhe në VKM nr. 504 që miratojnë përgjegjësitë e rishikuara në nivelin e qeverisë qendrore. Gjithashtu, vendimi parashikon transferimin e planifikimit territorial dhe të përcaktimit të vendndodhjes së landfill-eve dhe impjanteve të tjera të trajtimit të mbetjeve nga Ministria e mëparshme e Planifikimit Urban përfshirë edhe *Agjencinë Kombëtare për Planifikimin Territorial*. MIE është i vetmi institucion qendror qeveritar, i cili ka parashikuar në buxhetin e tij afat-mesëm, një program buxhetor për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane.

MIE mbulon investimet për infrastrukturën dhe zhvillimin e standarteve dhe teknikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve nga ndërtimet e prishjet, si edhe për ciklin e projektit në lidhje me ndërtimin (planifikimin e projektit, hartimin dhe zbatimin) e landfill-eve rajonale. Për më tepër, ministria bashkërendon dhe monitoron aktivitetin e vend-depozitimeve të mbetjeve, përdorimin e landfill-eve rajonale dhe impjanteve të incenerimit, dhe përcakton kriteret teknike për studimin dhe siguron mbylljen e vend-depozitimeve urbane.

Për shumë vite, ministria ka qenë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave për mbetjet bashkiake, dhe të ndërtimeve e prishjeve, duke qenë kështu burimi kryesor dhe i vetëm i informacionit për sasinë e mbetjeve të gjeneruara në vend.

Në bashkëpunim me MTM-në, MIE ka kompetencën e monitorimit të aktiviteteve përkatëse për asgjesimin dhe trajtimin e mbetjeve bashkiake dhe të ndërtimeve e prishjeve, përmes projektimit, ndërtimit dhe zbatimit të landfill-eve dhe incineratorëve.



Vendimet lidhur me procedurat për studimin dhe ndërtimin e incineratorëve të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës drejtohen dhe merren nga MTM-ja. Sektori i Programeve të Zhvillimit për Trajtimin e Mbetjeve Urbane dhe të Ngurta, i cili përbëhet nga gjashtë punonjës, ka përgjegjësitë e menaxhimit të mbetjeve në MIE.

Ministritë e tjera të përfshira në menaxhimin e mbetjeve përfshijnë si më poshtë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (në lidhje me përfshirjen e sektorit privat dhe industrisë së riciklimit),
- Ministria e Shëndetit (mbetjet e kujdesit shëndetësor),
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (mbetjet bujqësore),
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë (p.sh. mbetjet e minierave),
- Ministria e Mbrojtjes (mbetjet ushtarake),
- Ministria e Financave (çështjet financiare).

3.2.2 Niveli Rajonal

Këshillat rajonale janë niveli i dytë i qeverisjes vendore në Shqipëri, jo në mënyrë të drejtpërdrejt përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivelin vendor por ligjërisht ata janë caktuar për të siguruar kuadrin rajonal të politikave, nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Gjithsesi, këshillat janë përgjegjës për miratimin e planeve vendore përkatëse të menaxhimit të mbetjeve para se ato të hyjnë në fuqi (Neni 13, Ligji nr. 156/2013, ndryshuar me Ligjin 10463/2011). Këshillat rajonale kanë si funksion të tyre zhvillimin dhe zbatimin e politikave rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikatat kombëtare. Këshillat zhvillojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe raportojnë çdo vit për zbatimin e tyre tek MTM-ja (Neni 13, Ligji nr. 156/2013, ndryshuar me Ligjin 10463/2011). Roli i këshillave rajonale është rishikuar disa herë në vitet e fundit ndërsa Projekt Strategjia Kombëtare për MM sugjeron një rol të reduktuar të Këshillave Rajonale në menaxhimin e mbetjeve.

3.2.3 Niveli Vendor

Ligji Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NJQV-ve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi, si edhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përcaktohet si funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e menaxhimit të ofrimit të shërbimit në një mënyrë që i përshtatet më së miri kushteve të tyre specifike dhe të bashkëpunojnë me bashkitë e tjera për përcaktimin e tarifave të

shërbimit dhe tarifave, dhe të një mekanizmi për mbledhjen e të ardhurave, si edhe për ndërtimin e administrimin e objekteve për trajtimin e mbetjeve. Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 citohet akoma në lidhje me grumbullimin, transportimin dhe trajtimin e tanishëm të mbetjeve dhe standartet bashkëkohore duhet të përdoren akoma nga ta gjitha bashkitë.

Detyrat e veçanta të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë dhe këshillat rajonale janë të përcaktuara në ligjin Nr. 10463/2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i ndryshuar, dhe në disa akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Përgjegjësitë e drejtpërdrejta të NJQV-ve kanë të bëjnë vetëm me planifikimin dhe raportimin për menaxhimin e mbetjeve në juridiksionet e tyre përkatëse.

Në bashkitë shqiptare, menaxhimi i mbetjeve në përgjithësi është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.¹ Kontratat e pastrimit hartohen dhe nënshkruhen nga bashkitë, gjithashtu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996, "Për Largimin Publik të Mbeturinave". Modeli i këtyre kontratave nuk ofron standartet e menaxhimit të mbetjeve siç janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10463 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", i datës 22.09.2011, dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Instrumentet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në harmoni me planet përkatëse kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Në nivel vendor, shërbimet e MMN ose zbatohen nga bashkitë me personelin dhe me pajisjet e tyre ose nga kontraktorë privatë.

3.3 Shërbimet e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Pavarësisht përmirësimeve në lidhje me mbulimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në vitet e fundit, shërbimet e grumbullimit akoma nuk i mbulojnë të gjitha vendbanimet, sidomos në zonat bujqësore. Ndërsa qendrat urbane dhe periferike të qyteteve në përgjithësi janë mjaftueshëm pastër, në anë të rrugëve dhe në rrethina mund të shihen shpesh mbetje të shpërndara, si edhe pirqje mbetjesh veçanërisht ato ndërtimore. Arsytet për këtë situatë të pakëndshme janë të shumta, duke përfshirë gjendjen e keqe dhe numrin e pamjaftueshëm të pajisjeve të grumbullimit të mbetjeve (automjete dhe kontenierë). Shkalla e grumbullimit të mbetjeve në të gjithë vendin është 74%.

¹ Në përgjithësi drejtorja e shërbimeve publike, por ndonjëherë drejtorja e mjedisit ose drejtorja e planifikimit urban. Një bashki mund të funksionojë me një ndërmarrje pastrimi vendore përgjegjëse për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin. Është e rëndësishme të theksohet këtu se kuadri institucional i njësive të qeverisjes vendore është i shumëllojshëm, dhe se sektori përgjegjës që merret me mbetjet nuk përcaktohet gjithnjë qartë. Për këtë arsye, mbledhja e të dhënave të besueshme nga bashkitë përbën një sfidë.



Në Shqipëri, për momentin shkalla e përgjithshme e rikuperimit dhe riciklimit është përllëguar më pak se 10%. Përveç Projektit Eko Tirana, ku është prezantuar grumbullimi i diferencuar në fillim të vitit 2017 (por përsëri ka nevojë për një përmirësim thelbësor), mbetjet e riciklueshme grumbullohen kryesisht nga sektori jo formal. Megjithatë, industria e riciklimit në Shqipëri është e zhvilluar mirë dhe ka kapacitet të mjaftueshëm për marketing dhe për përpunimin e materialeve të riciklueshme të grumbulluara. Gjithsesi, është i dukshëm fakti, se një rritje e shkallës së riciklimit dhe rikuperimit mund të arrihet vetëm nëpërmjet angazhimit më të fuqishëm të bashkive, d.m.th. duke zbatuar grumbullimin e diferencuar sipas kërkesave ligjore. Por kostot e investimit dhe operimit të nevojshme për zbatimin e grumbullimit të diferencuar në mënyrë formale nga bashkia, në pjesën më të madhe të rasteve nuk mund të kompensohen nga të ardhurat për marketingun e grumbullimi të diferencuar të mbetjeve. Për rrjedhojë, duhet financim shtesë.

Projekt Strategjia e MM-së parashikon rikuperimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve (përfshirë mbetjet e ambllazheve) nëpërmjet Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP). Brenda kësaj skeme, prodhuesit, për shembull, do t'ju duhet të mbulojnë kostot e prezantimit të sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe menaxhimit të mbetjeve të ambllazheve. Detajet e sistemit PZP (si edhe kuadri rregullues) akoma duhet të përpunohen.

Nër përgjithësi mund të thuhet se asgjësimi i papërshtatshëm i mbetjeve është sfida më serioze e sistemit të tanishëm të MMN-së në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit janë zbatuar projekte të ndryshme me në qendër përmirësimin e landfill-eve në vend, p.sh. zbatimi e landfill-eve sanitare në përputhje me standartet e direktivës së BE-së për landfill-in. Për shkak të ekonomisë së shkallës, këto projekte kanë qenë kryesisht të planifikuara për disa bashki ose si objekte rajonale. Për më tepër, të nxitura nga MTM-ja, kanë filluar nisma të ndryshme për djegien e mbetjeve bashkiake.



4 Paraqitje e Përmbledhur Aktorëve Kryesorë dhe Angazhimi i Tyre

MIE² po drejton përgatitjen e Studimit të Sektorit. Meqenëse kjo Ministri është një nga dy ministrinë e linjës në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, MTM dhe Koordinatori Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta nga Kryeministria është gjithashtu i përfshirë nga afër në procesin e përgatitjes. Aktorë të tjerë të përfshirë janë Agjencia Kombëtare e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve (AKUK), gjithashtu ka kompetencën e menaxhimit të mbetjeve) si edhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial (AKPT).

Përfshirja e tyre bëhet në veçanti nëpërmjet takimeve të rregullta, ku paraqitet dhe diskutohet përmbajtja kryesore dhe sugjerimet për secilën fazë të Studimit të Sektorit (krahaso me Figurën 1). Në këtë mënyrë mbështetet dhënia e komenteve dhe miratimi i rezultateve të përkohshme dhe vendimet e duhura përgatiten bashkërisht. Pjesëmarrës të tjerë të shpeshtë në këto takime janë përfaqësues të GIZ-it, pasi ata janë duke punuar për strategjinë e re kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planin e veprimit në interes të MTM-së dhe të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, si donatori që po financon këtë projekt.

Procesi për përgatitjen e Studimit të Sektorit filloi më mars 2017. Që nga ajo kohë, takimet, veçanërisht me aktorët e sipërpërmendur, janë zhvilluar rregullisht. Megjithatë, për shkak të ristrukturimit të qeverisë ka pasur një pushim gjatë përgatitjes së Studimit të Sektorit nga Gushti-Tetor 2017. Pas fillimit të punës më nëntor 2017, u zhvillua një seminar dy ditorë më janar 2018, gjatë të cilit aktorët e sipërpërmendur patën mundësinë e diskutimit dhe mbledhjes së propozimeve për zonat e mbetjeve (zonat e mbulimit), të identifikimit të masave të MIMN në zonat e mbetjeve dhe të diskutimit të sistemit të përcaktimit të përparësive dhe kriterëve që do të përdoren. Pas seminarit të janarit e deri më sot janë zhvilluar takime të rregullta me aktorët kryesorë.

Në një fazë të mëtejshme të procesit për përgatitjen e Studimit të Sektorit janë zhvilluar takime me zonat e mbetjeve në bashkitë përkatëse, me qëllim marrjen e rezultateve dhe përfundimeve nga administrata përkatëse e bashkisë dhe e qarkut, në lidhje me caktimin të tyre në zonat e veçanta të mbetjeve, si edhe për sa i përket masave që janë të propozuara në Studimin e Sektorit për nivelin e bashkisë. Përveç takimeve të zonave të mbetjeve me përfaqësues të administratës së bashkisë dhe të qarkut u mbajt edhe një takim i ngjashëm me OJQ-të.

² Para ristrukturimit të Qeverisë në vjeshtë të vitit 2017, ishte Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU).



Për më tepër, Projekt Studimi i Sektorit është në dispozicion të të gjitha 61 bashkive në formën e dosjes.

Tabela e mëposhtme paraqet një listë të të gjithë aktorëve kyç, të cilët kanë qenë ose janë konsultuar gjatë zhvillimit të Studimit të Sektorit. Në Shtojcën 2, jepet një listë e seminareve dhe Grupit të Punës Ndër-Ministror. Shtojca 3 paraqet procesverbalet e takimeve të zonës së mbetjeve.

Tabela 2 Aktorët kyç të përfshirë në procesin për përgatitjen e Studimit të Sektorit

Aktorë kyçë	Lloji i angazhimit: takime dy palëshe, takime shumë palëshe, me shkrim
Institucione Shtetërore	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) (Agjencia Zbatuese e Projektit)	Takime dy dhe shumë palëshe, me shkrim
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)	Takime shumë palëshe
Koordinatori për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta nga Kryeministria	Takime shumë palëshe
Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale	Takime shumë palëshe
Ministria e Brendshme	Takime shumë palëshe
Agjencia Kombëtare e Ujësjetjes dhe e Kanalizimeve (AKUK)	Takime shumë palëshe dhe dy palëshe
Agjencia Kombëtare e Planifikimit Territorial (AKPT)	Takime shumë palëshe dhe dy palëshe
Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Takime shumë palëshe
Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura	Takime shumë palëshe
Instituti i Shëndetit Publik	Takime shumë palëshe
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë	Takime shumë palëshe
Administrat bashkiake dhe të qarkut	Takime shumë palëshe
Qarku Berat (Zona e Mbetjeve Berat)	Takime shumë palëshe
Bashkitë Berat, Ura Vajguore, Kuçovë, Skrapar, Poliçan	Takime shumë palëshe
Qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë (Zona e Mbetjeve Vlorë Jug – Gjirokastrë)	Takime shumë palëshe
Bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Dropull, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë	Takime shumë palëshe
Qarku Fier (Zona e Mbetjes Fier)	Takime shumë palëshe
Bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër	Takime shumë palëshe
Qarqet Tiranë dhe Durrës (Zona e Mbetjeve Tiranë-Durrës)	Takime shumë palëshe



Aktorë kyçë	Lloji i angazhimit: takime dy palëshe, takime shumë palëshe, me shkrim
Bashkitë Vorë, Kamëz, Tiranë, Kavajë, Krujë, Durrës, Shijak	Takime shumë palëshe
Qarqet Shkoder dhe Lezhe (Zona e Mbetjeve Shkodër-Lezhë)	Takime shumë palëshe
Bashkitë Malësi e Madhe, Shkodër, Vau-Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz, Lezhë, Mirditë, Kurbin	Takime shumë palëshe
Qark Elbasan (Zona e Mbetjeve Elbasan)	Takime shumë palëshe
Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas, Rogozhinë	Takime shumë palëshe
OJQ-të	Takime shumë palëshe
Grupi G & G Tiranë	Takime shumë palëshe
Shoqata e Komunitetit për Mjedisin	Takime shumë palëshe
Shoqata Shqiptare e Biologëve	Takime shumë palëshe
INCA	Takime shumë palëshe
Lëvizja Bells	Takime shumë palëshe
Partners Albania	Takime shumë palëshe
Universiteti Bujqësor	Takime shumë palëshe
QRM Shqipëri	Takime shumë palëshe
Shoqata për Politika të Reja për Mjedisin	Takime shumë palëshe
Shoqata e Juristëve për Mjedisin	Takime shumë palëshe
Shoqata e Bujqësisë Organike	Takime shumë palëshe
Ekolëvizja	Takime shumë palëshe
Qendra EDEN	Takime shumë palëshe
Organizata MILEU-CONTACT	Takime shumë palëshe
Donatorë ndërkombëtarë	
Banka Gjermane për Zhvillim KfW	Takime dy dhe shumë palëshe, me shkrim
GIZ	Takime dy dhe shumë palëshe, me shkrim
SECO	Takime dy dhe shumë palëshe, me shkrim
Programi IPA i Bashkimit Europian për Shqipërinë	Takime dy dhe shumë palëshe, me shkrim

Sa herë që është dhënë si këshillë, janë mbajtur edhe takime të tjera shumë palëshe dhe dy palëshe me aktorë të tjerë. Për më tepër, shkëmbimi i nevojshëm i informacionit gjithashtu bëhet me shkrim.

5 Përshkrimi i Aspekteve Mjedisore Kryesore që do të Trajtohen në Studimin VSM

5.1 Sfera Gjeografike e Veprimit

Objektivi i Studimit të Sektorit është përcaktimi i Planit Kombëtar të Investimit në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Si i tillë, vlerësimi do të përqendrohet në një nivel strategjik kombëtar dhe mbledhja e të dhënave bazë do ta pasqyrojë këtë.

5.2 Sfera Kohore e Veprimit

Gjatë vlerësimit do të shqyrtohen ndikimet afat shkurtra, mesme, dhe afat gjate. Plani Kombëtar i Investimit për sektorin e menaxhimit të mbetjeve është ndarë gjithashtu në masa afat shkurtra, mesme dhe afat gjata (shih Figurën 1). Si rredhojë, është propozuar që afatet kohore të vlerësimit të ndikimit duhet të jenë të ngjashme me afatet kohore të Planit të Investimit. Kjo do të thotë që, për qëllim të VSM-së, do të shqyrtohet një sferë veprimi afat shkurtër që mbulon vitet 2018-2022, një sferë veprimi afat mesme që mbulon vitet 2023-2027 dhe një sferë veprimi afat gjate që mbulon vitet 2028-2032.

5.3 Pjesët e Studimit të Sektorit për t'u Vlerësuar

Në lidhje me cilat pjesë të Studimit të Sektorit duhet të vlerësohen dhe me sa detaje duhet të merret një vendim. Qëllimi i Studimit VSM do të jetë për të dhënë një vlerësim domethënës për ato pjesë të Studimit të Sektorit që mund të sjellin ndikime të rëndësishme në mjedis. Duke e bërë këtë gjë, do të sigurohet se kërkesat e Direktivës VSM dhe rregulloret e tjera përkatëse për mjedisin po përmbushen me miratimin e Studimit të Sektorit.

Tabela e mëposhtme përcakton ato elemente të Studimit të Sektorit të propozuara për t'u vlerësuar si pjesë e VSM-së, dhe gjithashtu shpjegon arsyen se pse ato janë/nuk janë vlerësuar. Ky informacion mund të ndryshojë në bazë të komenteve të mundshme që do të vijnë për këtë Raport Hulumtues dhe për shtrirjen dhe përmbajtjen e Studimit të Sektorit.



Tabela 3 Elementët e Studimit të Sektorit të Propozuara për Vlerësim

Kapitulli	Vendimi dhe justifikimi
Kapitulli 0: Përmbledhje Ekzekutive	Jo. Në këtë kapitull jepet një përmbledhje e përmbajtjes thelbësore dhe pikat kyçe të Studimit të Sektorit dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për një vlerësim në vetvete.
Kapitulli 1: Hyrje	Jo. Ky kapitull jep një vështrim të sfondit dhe procesit për përgatitjen e Studimit të Sektorit.
Kapitulli 2: Situata e Tanishme e MMN	Jo. Në këtë kapitull përshkruhet situata e tanishme e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Përshkrimi i Studimit Bazë Mjedisorë mund të përfitojë nga disa prej informacioneve bazë që jepen në këtë kapitull.
Kapitulli 3: Alternativat Teknologjike për MMN	Jo. Ky kapitull shpjegon dhe krahason alternativat teknologjike për MMN.
Kapitulli 4: Zonat e Mbetjeve dhe Vendndodhjet për Masat Rajonale të Investimit	Po. VSM-ja do të hetojë caktimin e kufijve të zonave të mbetjeve dhe vendndodhjet për Qendrat e reja të mundshme të Menaxhimit të Mbetjeve.
Kapitulli 5: Plani i Investimit	Po. VSM-ja do të shqyrtojë planin e investimit në lidhje me objektet e reja rajonale dhe reziqet e mundshme që lidhen me ato.
Kapitulli 6: Caktimi i Përparësive për Masat e Investimit	Jo. Ky kapitull përshkruan metodologjinë për përcaktimin e përparësive për investimet e planifikuara. Rekomandimet e dala nga VSM-ja mund të ndikojnë në metodologjinë e caktimit të përparësive.
Kapitulli 7: Hapat e Ardhsëm	Jo. Në këtë kapitull shpjegohen hapat e nevojshme që duhet të merren për publikimin e Studimit të Sektorit si një plan detyrues për autoritetet publike.

5.4 Aspektet Kryesore Mjedisore që Dalin nga Studimi i Sektorit


VSM-ja do të identifikojë dhe do të vlerësojë ndikimet potenciale të rëndësishme në mjedis, nëse nuk zbuten, dhe ndikimet domethënëse të mundshme në mjedis, nëse nuk zbuten. Këto ndikime do të përfshijnë, midis të tjerave, ndikimet pozitive dhe negative, afat shkurtra, afat mesme dhe afat gjate, ndikime të përhershme dhe të përkohshme, si edhe ndikimet grumbulluese.

Ndikimet e ndërtimit dhe operacionale do të merren parasysh. Nëse e nevojshme, aspekti stinor do të merret parasysh në përcaktimin e ndikimeve përkatëse.

Ndikimet potenciale të rëndësishme në mjedis, nëse nuk zbuten, me zbatimin e Studimit të Sektorit, priten që të përfshijnë ato të cilat jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4 Elementët Mjedisorë dhe ndikimet potenciale

Elementi Mjedisor	Ndikime potenciale të rëndësishme, nëse nuk zbuten
Biodiversiteti dhe flora e fauna	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikim në zonat e mbrojtura • Ndikime në florën dhe faunën, si edhe në habitate (të ndjeshme)
Popullata dhe shëndeti i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Afërsia e Qendrave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale me qendrat e populluara • Përmirësime në mundësinë e përdorimit dhe në standardin teknik të objekteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve kontribuojnë në mbrojtjen më të mirë të mjedisit dhe shëndetit të njeriut • Ndikime të mundshme në turizëm dhe në përdorimin e tokës për qëllime rekreative • Ndikime në cilësinë e ajrit • Ndikime në tokë • Ndikime në cilësinë e ujit (ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësore) • Ndikime në rrjetet e trafikut dhe transportit • Potencial për bezdisje (zhurmë, erë e keqe etj.)
Toka dhe përdorimi i saj	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat për tokën për qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe për objektet e tjera rajonale • Ndikimi në praktikën e përdorimit të tokës • Ndikime në cilësinë e tokës për shkak të reduktimit të shllamit • Ndikime në cilësinë e tokës nga përdorimi i plehut të prodhuar në impiantet e kompostimit në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve • Ndikime në tokë të çdo incidenti që mund të ndodhë në vendndodhjen e qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale
Uji	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqërore dhe nëntokësore (p.sh. nga reduktimi i shllamit apo i mbetjeve në ujërat sipërfaqësore) • Ndikimet në gjendjen ekologjike të trupave ujore • Ndikimet në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore të çdo incidenti që mund të ndodhë në vendndodhjen e qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikimi i erës së keqe që krijohet në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve • Ndikimi i çlirimeve të ajrit nga transportimi i mbetjeve • Ndikimi i çlirimit të ajrit nga objektet rajonale të menaxhimit të mbetjeve • Shkarkimet e gazit serë nga transportimi i mbetjeve • Reduktimi i shkarkimit të gazit serë nëpërmjet asgjësimit të mbetjeve në qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe reduktimi i numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare



Elementi Mjedisor	Ndikime potenciale të rëndësishme, nëse nuk zbuten
Pasuritë materiale	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i burimeve (materiale për ndërtim dhe energji) për qendrat rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe për objektet e tjera rajonale • Ripërdorimi i materialit nga riciklimi i fraksioneve përkatëse të mbetjeve • Përdorimi i rrjeteve të transportit • Përdorimi i burimeve për funksionimin e qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale
Trashëgimi arkitektuale, arkeologjike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikime mbi trashëgiminë kulturore, arkitektuale dhe arkeologjike që janë në afërsi të qendrave rajonale të propozuara për menaxhimin e mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale • Potenciali i bezdisjes e paidentifikuar më parë afër ose brenda zonave të zhvillimit të qendrave rajonale të menaxhimit të mbetjeve dhe objekteve të tjera rajonale
Peisazhi	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikime në karakterin e përgjithshëm të peisazhit dhe tek receptorët e ndjeshëm

6 Përshkrimi i Sferës së Veprimit të Studimit Bazë Mjedisor për t'u Përgatitur në Studimin VSM

Një studim bazë mjedisor do të hartohet për Studimin e Sektorit. Kjo do të përfshijë

- një përshkrim të gjendjes së mjedisit për momentin
- një diskutim të problemeve/çështjeve kyçe që janë dukë dalë për momentin në nivel kombëtar dhe
- një përshkrim të zhvillimit të pritshëm të mjedisit nëse nuk do të zbatohet Studimi i Sektorit

Studimi VSM do të paraqesë një përshkrim të plotë të aspekteve përkatëse të të dhënave bazë mjedisore për vendin në lidhje me menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Të dhënat bazë do të pasqyrojnë natyrën strategjike të Studimit të Sektorit. Studimi bazë mjedisor do të paraqitet në Raportin për Mjedisin nën disa tituj të temave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe flora e fauna
- Popullata dhe shëndeti i njeriut
- Toka dhe përdorimi i saj
- Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë
- Pasuritë materiale
- Trashëgimi arkitektural, arkeologjik dhe kulturor
- Peisazhi

Nën secilën temë do të identifikohet gjendja aktuale e mjedisit për sa i përket menaxhimit të mbetjeve bashkiake së bashku me problemet / çështjet kryesore dhe zhvillimin e pritshëm të mjedisit nëse do të mungonte një Studim i Sektorit. Burimet e të dhënave që do të përdoren për të përpiluar gjendjen e tanishme të mjedisit janë paraqitur në nënkapitullin e mëposhtëm.

6.1 Burimet e të Dhënave Bazë

Do të ishte shumë e rëndësishme që gjendja e tanishme e mjedisit të përshkruhet duke përdorur të dhënat mjedisore, informacionin dhe raportet më të përditësuara. Nëse janë gjetur boshllëqe në të dhëna, për aspekte të veçanta të gjendjes së tanishme të mjedisit, rëndësia e boshllëqeve të atyre të dhënave do të sqarohet qartë. Përveç kësaj, do të

thuhet nëse këto boshllëqe mund të trajtohen në mënyrë të arsyeshme dhe realiste gjatë procesit të VSM-së.

Dokumentat kryesorë që do të referohen do të jenë

- Raporti për Gjendjen e Mjedisit dhe
- Rishikimi i Performancës Mjedisore

Synohet që të shfrytëzohen Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) nëse e mundur për të shpalosur dhe analizuar informacionin përkatës. Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje paraprake të secilës prej temave të VSM-së që do të përmblihen në studimin bazë VSM. Tabela gjithashtu përfshin një listë jo shteruese të burimeve të mundshme të të dhënave që do të përdoren për hartimin e studimit bazë, dhe përveç kësaj përmbledh shkallën paraprake të shtrirjes së vlerësimit në bazë të këtyre burimeve të dhënash në dispozicion. Duke pasur parasysh natyrën strategjike të Studimit të Sektorit, është pranuar se ka kufizime për sferën e një vlerësimi mjedisor dhe për këtë arsye është me përfitim që këto kufizime të përmblihen që në këtë fazë të hershme.

Tabela 5 Burimet e të dhënave bazë dhe shtrirja e vlerësimit

Temat e VSM	Burime Potenciale të Dhënash	Shtrirja Potenciale e Vlerësimi në bazë të Burimeve të të Dhënave
Biodiversiteti dhe flora e fauna	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat GIS për zonat e mbrojtura natyrore (ASIG dhe AKUK) • Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor 2015-2030 (AKPT) • Strategjia Kombëtare për Biodiversitetin • Rrjeti Kombëtar i Biodiversitetit të Shqipërisë (AKZM): raport i gjendjes për speciet, të dhëna për speciet, dhe webGIS, si edhe zonat e mbrojtura 	Sete të dhënash kombëtare dhe rajonale për aspekte në lidhje me biodiversitetin, florën dhe faunën janë në dispozicion.
Popullata dhe shëndeti i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • INSTAT Instituti Shqiptar i Statistikave • Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor 2015-2030 (AKPT) • Të dhënat GIS për zonat e banuara, zonat turistike, bimësinë – zonat bujqësore (MTM, ASIG, AKUK) 	Të dhënat dhe informacioni në shkallë vendi për dendësinë dhe shpërndarjen e popullsisë janë në dispozicion, dhe ndikimet e mundshme të Studimit të Sektorit mund të vlerësohen sipas informacionit në dispozicion. Tema e shëndetit të njeriut do të përmendet në lidhje me ndikimet e tërthorta nga cilësia e ajrit, zhurma, cilësia e ujit etj.

Temat e VSM	Burime Potenciale të Dhënash	Shtrirja Potenciale e Vlerësimi në bazë të Burimeve të Dhënave
Toka dhe përdorimi i saj	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat GIS për zonat e banuara, infrastruktura e transportit, bujqësia, infrastruktura ekzistuese teknike, kushtet gjeologjike dhe hidro-gjeologjike, zonat turistike (MTM, ASIG, AKUK) Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor 2015-2030 (AKPT) Raport i vendit për sipërfaqen tokës Shqipëri 	Të dhënat dhe informacioni në shkallë vendi janë në dispozicion për tokën dhe përdorimin e saj në nivel qarku / kombëtar. Kjo është e mjaftueshme për natyrën strategjike dhe sferën gjeografike të veprimit të Studimit të Sektorit.
Uji	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat GIS për rrugët ujore dhe trupat ujorë (AKUK) Informacion për zonat e përmbajtjes (jo në të gjithë vendin) Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor 2015-2030 (AKPT) Strategjia Sektoriale e Shqipërisë për Furnimizmin dhe Ujë të Pijshëm dhe Higjenës Master Plani i Shqipërisë për Furnizimin me Ujë të Pijshëm dhe i Kanalizimeve Raporti për Shqipërinë për ujërat larës 2017 	Të dhënat dhe informacioni në shkallë vendi ekziston në një shkallë të kufizuar (p.sh. informacioni për zonat e përmbajtjes nuk është për të gjithë vendin). Çështjet në lidhje me mbetjet dhe cilësinë e ujin do të identifikohen aq sa është e mundur.
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> Ndotja e ajrit – Gjendja dhe ndikimet (Shqipëri) Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike 	Të dhënat dhe informacioni në shkallë vendi/qarku janë në dispozicion. Kjo është e mjaftueshme për natyrën strategjike dhe sferën gjeografike të veprimit të Studimit të Sektorit.
Pasuritë materiale	<ul style="list-style-type: none"> Shqipëria– rikuperimi i burimeve materiale Shqipëria – menaxhimi i mbetjeve bashkiake Projekt Strategjia Kombëtare për MMN dhe Plani i Veprimit Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë – Statistika për Shqipërinë Plani i Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor 2015-2030 (AKPT) 	Informacioni në shkallë vendi për disa burime që mund të ndikohen nga Studimi i Sektorit është në dispozicion.

Temat e VSM	Burime Potenciale të Dhënash	Shtrirja Potenciale e Vlerësimi në bazë të Burimeve të të Dhënave
Trashëgimi arkitektuale, arkeologjike, kulturore dhe peisazhi	<ul style="list-style-type: none"> Të dhënat GIS për vendet e trashëgimisë kulturore (MTM, ASIG) Shqipëria – UNESCO Qendra e Trashëgimisë Botërore Nuk ka ndonjë informacion në shkallë vendi për peisazhin në dispozicion publikisht 	Të dhënat dhe informacioni në shkallë vendi për trashëgiminë kulturore janë në dispozicion, megjithatë, shkalla e të dhënave dhe informacionit janë të orientuara ndaj burimeve të veçanta të projekteve vendore. Gjithsesi, informacioni ekzistues është i mjaftueshëm për natyrën strategjike dhe sferën gjeografike të veprimit të Studimit të Sektorit.

7 Rekomandim për Identifikimin e Ndikimit Specifik dhe Metodologjitë Vlerësuese që do të Përdoren në Studimin VSM

7.1 Shqyrtimi i Alternativave

Si pjesë e procesit të VSM-së kërkohet një vlerësim i alternativave të arsyeshme. Për shkak të natyrës strategjike të Studimit të Sektorit dhe ndikimeve më të gjera në Fazën e Zhvillimit të Teknologjisë (shih Figurën 1) janë marrë parasysh alternativa të ndryshme të teknologjisë për menaxhimin e mbetjeve, ndër të tjera duke u përqendruar në

- Zhvillimin e alternativave të teknologjisë/metodologjisë për elementët MMN
- Vlerësimi i realizueshmërisë teknike, financiare dhe mjedisore të teknologjive të trajtimit të MMN-ve
- Krahasimi i alternativave për elementët e MMN

Alternativat janë shqyrtuar dhe diskutuar në lidhje me aspektet e mëposhtme:

- Ndërlikimet në kuadrin e politikave dhe rregullues
- Identifikimi i alternativave teknologjike në përputhje me politikat dhe të provuara
- Mundësia financiare e alternativës së provuar teknologjike

Pas heqjes së ndërlikimeve të kuadrin të politikave dhe rregullues, u identifikuan alternative teknologjike në përputhje me politikat. Alternativat teknologjike të paraqitura në Tabelën 6 mbulojnë një gamë të gjerë elementësh të mundshëm të MMN pjesë e qasjes së ciklit të jetës.



Tabela 6 Alternativat e shqyrtuara

	Mbetje të përzjera		Mbetje të Diferencuara	Mbetje Inerte
Pastrimi i Rugëve	Pastrimi i rrugës			Menaxhimi i Mbetjeve Inerte
Grumbullimi i Mbetjeve	Grumbullimi i mbetjeve		Grumbullim i diferencuar i mbetjeve	
Transportimi dhe transferimi	Transferimi dhe Transportimi			
Trajtimi Mekanik	MRF e pisët	Trajtimi Mekanik Biologjik (MBT)	MRF e pastër	
Trajtimi Biologjik	Tharje biologjike		Kompostim, Tretje	
Trajtimi Termal	Djegia, Peroliza, Gazifikim Trajtimi plazëm, Teknologjia Mbetje në Lëndë Djegëse			
Asgjesimi	Landfill sanitar, Rehabilitimi i landfill-it			

Qëllimi kryesor ishte identifikimi dhe përzgjedhja e teknologjive të provuara (përvoja afatgjate në ndërtim dhe funksionim) dhe në një hap tjetër u bë shqyrtimi i realizueshmërisë financiare (duke marrë parasysh harmonizmin me projekte ekzistuese ose të planifikuara të financuara nga donatorët). Teknologjitë e reja për prodhimin e energjisë nga mbetjet - si gazifikimi dhe peroliza - kanë qenë procese të njohura për një kohë të gjatë, por vetëm për lëndë djegëse të përcaktuara mirë, si qymyri apo druri. Përvoja në lidhje me trajtimin e mbetjeve bashkiake është ende shumë e kufizuar. Mund të përmblidhet se gazifikimi, peroliza, trajtimi plazëm dhe mbetje në lëndë djegëse nuk janë teknologji të provuar për një kohë të gjatë për trajtimin e mbetjeve bashkiake dhe për këtë arsye janë përjashtuar (të shkruara me ngjyrë të kuqe në tabelën e mësipërme).

7.2 Identifikimi i Objektivave, Synimeve dhe Indikatorëve

Një qëllim kryesor i studimit hulumtues është përcaktimi i detajeve të mjaftueshme për kuadrin e propozuar të metodologjive për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, që mundësojnë formimin e një këndvështrimi për këtë çështje. Propozohet që të përdoret një vlerësim i drejtuar për nga objektivat, i cili do të lejojë një vlerësim kundrejt Objektivave Mjedisore të VSM-së të përcaktuara për secilën nga fushat e çështjeve të identifikuara.

Seksionet e mësipërme kanë identifikuar karakteristikat mjedisore dhe çështjet kryesore mjedisore që lidhen me Studimin e Sektorit. Ky seksion përdor atë informacion për të përcaktuar një sërë projekt objektivash të VSM-së, treguesit dhe synimet përkatëse. Këto do të përdoren në studimin e VSM-së për të parashikuar ndikimet e mundshme të Studimit të Sektorit në mjedis. Përdorimi i këtyre objektivave do të sigurojë që, pas studimit hulumtues, studimi i VSM-së do të përqendrohet vetëm në ato çështje që janë më përkatëse dhe të rëndësishme.

Në tabelën e mëposhtme janë përcaktuar projekt objektivat e VSM-së që janë duke u shqyrtuar për të testuar ndikimet e mundshme të Studimit të Sektorit në mjedis. Kriteret e vlerësimit janë shembuj të çështjeve që do të merren parasysh. Duhet të theksohet se këto janë vetëm projekt objektiva dhe janë dhënë vetëm për qëllim të diskutimit në këtë fazë hulumtuese. Dhënia e mendimeve për projekt-objektivat, me qëllim përditësimin e tyre para studimit të VSM-së, do të vlerësohej.

Tabela 7 Projekt objektivat mjedisore të VSM-së

Lidhur me tema(t) e VSM-së	Objekti mjedisor dhe synimet	Projekt synimet e sugjeruara të VSM-së
Biodiversiteti, flora dhe fauna	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e biodiversitetit Mbrojtja e florës dhe faunës dhe habitateve të tyre natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e burimeve natyrore dhe biologjike Mbrojtja e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore
Popullata dhe shëndeti i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i cilësisë së jetës nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit Mbrojtja e shëndetit të njeriut nga ndikimet e dëmshme në mjedis që janë të afta, për nga natyra, përhapja apo kohëzgjatja, të shkaktojnë rreziqe, disavantazhe domethënëse apo shqetësime të rëndësishme për publikun e gjerë ose për lagjen (p.sh. nga ndotësit e ajrit, zhurma, substanca të rrezikshme dhe mikrobet)



Lidhur me tema(t) e VSM-së	Objekti mjedisor dhe synimet	Projekt synimet e sugjeruara të VSM-së
Tokat dhe përdorimi i tokës	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e funksioneve të shëndetshme dhe ekologjike të tokës Parandalimi i dëmtimit të tokës përfshirë, mbrojtjen e strukturës së dheut (erozioni, ngjeshjen e dheut) Rehabilitimi dhe riaftësimi i tokës së dëmtuar 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e aftësisë së tokës për të prodhuar, si dhe përmirësimi e rehabilitimi i saj. Mbajtja e nivelit natyror të lëndës organike dhe nivelit normal të treguesit fizik, kimik dhe zhdërvjellsisë së tokës bujqësore.
Uji	<ul style="list-style-type: none"> Gjendje e mirë ekologjike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore Gjendje e mirë kimike e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore, si dhe e ujërave nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së saj ekologjike Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore, si dhe e ujërave nëntokësore dhe përmirësimi i gjendjes së saj kimike
Cilësia e ajrit dhe faktorët klimatikë	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja dhe ruajtja e cilësisë së ajrit Parandalimi dhe reduktimi i ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshime në klimë 	<ul style="list-style-type: none"> Reduktimi dhe stabilizimi i shkarkimeve të gazeve serë Nxitja e përdorimit të energjisë së rinovueshme dhe efektshmërisë së energjisë
Pasuritë materiale	<ul style="list-style-type: none"> Shfrytëzim i kujdesshëm dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i cilësisë së burimeve natyrore Reduktimi i përdorimit të burimeve dhe përmirësimi i efektshmërisë së këtij përdorimi Shfrytëzim me përgjegjshmëri i burimeve natyrore
Trashëgimi arkitektural, arkeologjike dhe kulturore	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e trashëgimisë kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive të trashëgimisë kulturore
Peisazhi	<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja dhe restaurimi i vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i shumëllojshmërisë së peisazhit

Synimet do të merren parasysh në përgatitjen e bazës mjedisore dhe gjatë vlerësimit mjedisor, në mënyrë që të përmbushen objektivat mjedisore të VSM të Studimit të Sektorit.



Në bazë të përgatitjes së studimit bazë mjedisor, do të përcaktohen treguesit duke pasur parasysh disponueshmërinë e të dhënave dhe mundësinë e krijimit të lidhjeve të drejtpërdrejta midis ndryshimeve në mjedis dhe zbatimit të Studimit të Sektorit. Kjo do të thotë që treguesit do të zhvillohen gjatë studimit të VSM-së, duke përfshirë përgjigjet e komenteve të marra për këtë Raport Hulumtues.



8 Hapat e Ardhshëm

Me këtë dokument, Konsulenti bën një sugjerim për sferën e veprimit të studimit të VSM-së, i cili do të kryhet si hapi i ardhshëm.

Studimi i VSM-së do të përgatitet si më poshtë:

- Përkufizimi i bazës së studimit të VSM-së
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor i pjesës përkatëse të Studimit të Sektorit

Rezultatet përkatëse nga VSM-ja do të përfshihen në Studimin e Sektorit, përpara se të dy dokumentet të dorëzohen përfundimisht tek MIE dhe KfW.



9 Shtojcat



9.1 Shtojca 1: Përmbledhje Ekzekutive e Studimit të Sektorit




Bashkëpunimi Financiar i Gjermanisë me Republikën e Shqipërisë

KfW Entwicklungsbank
Palmengartenstr. 5 - 9
60325 Frankfurt a. M.
GERMANY

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Sheshi Skënderbej Nr. 5,
Tiranë
ALBANIA

Shërbime Konsulence për
Kryerjen e një Studimi Sektori mbi Nevojën për Investime
në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN)
në Shqipëri

- Përmbledhje e Draft Raportit të Studimit të Sektorit mbi MIMN -



15 Qershor 2018

INFRASTRUKTUR & UMWELT
Professor Böhm und Partner

Julius-Reiber-Strasse 17
64293 Darmstadt
Germany

www.iu-info.de

COWI

Parallelvej 2
2800 Kongens Lyngby
Denmark

www.cowi.com

FLAG

Brigada 8, P. 6/2, K IV
Tirana
Albania

www.flag-al.org



I Hyrje

Banka Gjermane për Zhvillim, KfW Entwicklungsbank mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të përmirësuar situatën e menaxhimit të mbetjeve në vend. Midis të tjerave është rënë dakord për përgatitjen e një Studim Sektori mbi Nevojën për Investime në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (MIMN) në Shqipëri. Partneri shqiptar i Projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri ka pasur një përparim të konsiderueshëm në lidhje me zhvillimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Megjithatë, zbatimi në nivel rajonal apo vendor dhe arritja e objektivave të rënë dakord ka mbetur ende mbrapa. Pika kryesore midis planifikimit dhe zbatimit është aspekti financiar. Pra, objektivat specifike të Studimit të Sektorit janë:

të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (MMN)

të përcaktojë kostot dhe tarifat e duhura

të ofrojë një sistem objektiv, transparent dhe të verifikueshëm për përcaktimin e prioriteteve për investimet në infrastrukturën e MIMN

të ofrojë një plan investimi për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MIMN të ndarë sipas fazave në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, reduktimin dhe riciklimin e tyre, si dhe impiantet për trajtimin dhe/ose depozitimin e mbetjeve

të propozojë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe institucionale

- të propozojë masa të tjera shoqëruese

Studimi i Sektorit është i orientuar nga objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si edhe për mbrojtjen e mjedisit.

II Situata e Tanishme e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime të dukshme në lidhje me hartimin e një kuadri rregullues. Për më tepër, mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve është zgjeruar



dhe janë ndërmarrë hapat e parë për ricklimin formal dhe përmirësimin e asgjesimit të mbetjeve.

Megjithatë, përparimi i përgjithshëm është i ngadaltë dhe në përgjithësi nuk janë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga politika dhe korniza ligjore. Pengesat kryesore dhe mangësitë e sektorit të MMN përfshijnë:

- Ndarje e paqartë ose jo-funksionale e përgjegjësive në nivel kombëtar,
- Organizim i paqartë ose jo-funksional i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel "rajoni",
- Politikat, planet dhe rregulloret ekzistuese (ende) nuk janë vënë në zbatim,
- Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe institucionale,
- Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime dhe vendgrumbullime të menaxhuara keq,
- Financim i pamjaftueshëm i shërbimeve të përparuara të menaxhimit të mbetjeve,
- Mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe e masave zbatuese.

Faktori më i rëndësishëm i suksesit për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri do të jetë financimi i qëndrueshëm i shërbimeve. Për momentin, janë ndërmarrë disa nisma të ndryshme në lidhje me këtë çështje, përfshirë këtu

- Përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e kostos dhe vendosjen e tarifës
- Qartësimin e përparësive dhe kriterëve për investimet në MMN
- Zgjerimin e bazës së të ardhurave, p.sh. nëpërmjet zbatimit të skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit.

III Alternativat Teknologjike për MMN

Shkurtimisht përshkruhen disa alternativa teknologjike të testuara që janë në përputhje me politikat dhe të mundshme nga ana financiare, si dhe krahasohen kundrejt kërkesave përkatëse institucionale, kriterëve teknike, rëndësisë socio-ekonomike, ndikimeve mjedisore dhe karakteristikave financiare. Përsa i përket rëndësisë së mundësisë financiare, në tabelën e mëposhtme jepet njëpërmbledhje e specifikimeve kryesore të elementëve të MMN. Meqenëse në Shqipëri mungon një përvojë afatgjatë për kostot e trajtimit të mbetjeve, kostot përkatëse janë marrë nga baza e të dhënave referuese të BE-së.

Përmbledhje e Specifikimeve Kryesore të Elementëve të MMN-së

Elementi i MMN	Prodhimi minimal	Lloji i Mbetjeve	Investimi specifik	Kosto Specifike Neto		Ekonomi e shkallës	Shenime
				likur me prodhimin votri	konvertuar për një sistem referues me 50,000 t/vt mbetje të grumbulluara		
Pastrimi i rugeve							
Pastrimi manual i rugeve	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	8.6 EUR/t (50,000 t/v)	10.5 EUR/t	10.5 EUR/t	e ulët	Kostot specifike të llogaritura në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara prej 50,000 t/vt
Pastrimi mekanik i rugeve	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	17.3 EUR/t (50,000 t/v)	11.3 EUR/t	11.3 EUR/t	e ulët	Kostot specifike të llogaritura në lidhje me sasinë e mbetjeve të grumbulluara prej 50,000 t/vt
Grumbullimi i mbetjeve							
Grumbullimi i mbetjeve të përzjera	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	44 EUR/t (25,000 t/v)	17.2 EUR/t	8.6 EUR/t	e mesme	Në bazë të llogaritjeve për Rajonin e Korçës
Grumbullimi i mbetjeve organike	Fleksibel*	Mbetje organike	36 EUR/t (15,000 t/v)	16.7 EUR/t	5.6 EUR/t	e mesme	Në bazë të llogaritjeve për Rajonin e Korçës
Grumbullimi i materialeve të lthata të riciklueshme	Fleksibel*	Materiale të lthata të riciklueshme	116 EUR/t (10,000 t/v)	35.4 EUR/t	7.1 EUR/t	e mesme	Në bazë të llogaritjeve për Rajonin e Korçës
Transferimi dhe transportimi i mbetjeve							
Stacione transferimi me rampë	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	17.2 EUR/t (50,000 t/v)	7.6 EUR/t	7.6 EUR/t	e mesme	Për një distancë mesatare transporti prej 50 km
Stacione transferimi me rampë me rripashë	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	18.8 EUR/t (50,000 t/v)	7.2 EUR/t	7.2 EUR/t	e mesme	Kursimet minimale kundrejt rrezikut të mosfunksionimit, për një distancë mesatare transporti prej 50 km
Impjanti i Rikuperimit të Materialeve (IRM)							
Impjanti për ndarjen e mbetjeve të përzjera	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	100 EUR/t (50,000 t/v)	8 EUR/t**	8 EUR/t**	e mesme	Cilësia e materialeve të riciklueshme e dobët në krahasim me një impjant rikuperimi Materialeve të pastër
IRM e pastër	Fleksibel*	Materiale të lthata të riciklueshme të grumbulluara të ndara	80 EUR/t (10,000 t/v)	25 EUR/t**	5 EUR/t**	e mesme	Pa kostot e grumbullimit të veçantë
Trajtimi Mekanik Biologjik (TMB)							
TMB me TA	> 10,000 t/v	Mbetje bashkiake të përzjera	291 EUR/t (50,000 t/v)	73 EUR/t**	73 EUR/t**	e lartë	Kërkesa të larta për trajtimin anaerobik të mbetjeve bashkiake të përzjera
TMB me stabilizim	> 25,000 t/v	Mbetje bashkiake të përzjera	252 EUR/t (50,000 t/v)	58 EUR/t**	58 EUR/t**	e lartë	Impjantet ekzistuese në Gjermani kanë një prodhim mesatar prej 150,000 t/vt
TMB me kompostim	> 10,000 t/v	Mbetje bashkiake të përzjera	194 EUR/t (50,000 t/v)	52 EUR/t**	52 EUR/t**	e mesme	Fushë e lartë kërkesë
Kompostimi (Rikuperimi i Materialeve)							
Kompostimi me kavale të	Fleksibel*	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	140 EUR/t (5,000 t/v)	20 EUR/t	2 EUR/t	e ulët	Trajtimi i mbetjeve ushqimore sjell kërkesa më të larta teknike.
Plotesisht automatik brenda impjantëve	> 10,000 t/a	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	200 EUR/t (25,000 t/v)	50 EUR/t	25 EUR/t	e lartë	Në bazë të Raportit për Studimin e Konceptit dhe Fizibilitetit për Rajonin Kakheli, Gjeorgji
Trajti Anaerobik (Rikuperimi i Energjisë)							
Trajti Anaerobik (TA)	Fleksibel*	Mbetje organike të grumbulluara të ndara	170 EUR/t (25,000 t/v)	50 EUR/t**	25 EUR/t**	e mesme	Në bazë të llogaritjeve për Studimin e Fizibilitetit për Rajonin Kakheli, Gjeorgji
Incinerimi i Mbetjeve (Rikuperimi i Energjisë)							
Incinerimi me skarë të lëvizshme	> 50,000 t/v	Mbetje bashkiake të përzjera	636 EUR/t (100,000 t/v)	123 EUR/t**	n e shumë e lartë	n e shumë e lartë	Impjant incinerimi me një trajtim të thjeshtë të gazit të lëshuar nga oxhaku dhe përdorimi i kombinuar i nxehtësisë dhe energjisë (CHP)
Vend depozitimi sanitar (Depozitimi i sigurtë i mbetjeve)							
Vend depozitimi sanitar	> 30,000 t/v	Mbetje bashkiake të përzjera	115 EUR/t (50,000 t/v)	24.7 EUR/t	24.7 EUR/t	e lartë	Për shkak të ekonomisë së shkallës, përmasat minimale të landërave sanitare duhet të jenë 100 t/ditë
Rehabilitimi i vend depozitimit	Fleksibel*	Mbetje bashkiake të përzjera	95.2 EUR/t (39,000 t/v)	95.2 EUR/t	122 EUR/t	e ulët	Kostot mesatare të bazuara në konceptin për rehabilitimin e vend-grumbullimeve për rajonin e Korçës
Menaxhimi i Mbetjeve Inerte							
Trajtim i me Njësi Lëvizëse	> 30,000 t/v	Mbetje inerte të ndërtimeve dhe prishjeve të objekteve	10 EUR/t (50,000 t/v)	5.4 EUR/t**	5.4 EUR/t**	e mesme	Kostot specifike pa marrë parasysh rrezikun dhe fitimin për operatorin privat
Trajtim me Njësi të Palëvizshme	> 100,000 t/v	Mbetje inerte të ndërtimeve dhe prishjeve të objekteve	19 EUR/t (100,000 t/v)	4.3 EUR/t**	8.6 EUR/t**	shumë e lartë	Rreziku dhe fitimi dhe kostot e transportimit për dëgjimin në impjant nuk janë të përfshira në kostot specifike
Vend depozitimi	> 2,000 t/v	Mbetje inerte	26 EUR/t (50,000 t/v)	8.0 EUR/t	8.0 EUR/t	e mesme	Llogaritja e kostos është bazuar në standardet e një vend depozitimi LC I.



IV Bashkëpunimi Ndërbashkiak për Menaxhim të Përparuar të Mbetjeve

Përcaktimi i Veprimtarive Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Identifikimi i Zonave të Mbetjeve

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë kanë përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Gjithësesi, disa elementë të një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje të një shkalle më të gjerë për të funksionuar me efikasitet dhe me kosto më të ulët. Meqenëse pjesa më e madhe e bashkive në Shqipëri janë shumë të vogla për një funksionim efikas të impianteve në shkallë të gjerë, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive e përkatësisht një përcaktim zonash ose i ashtuquajtur "rajonalizim".

Impiantet e një shkalle më të gjerë që u shërbejnë dy apo më shumë bashkive quhen "rajonale", edhe pse zona e mbetjeve (zona e mbulimit) e impiantit përkatës mund të jetë ndryshe nga kufijtë rajonalë.

Një kusht i domosdoshëm për identifikimin e impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve është përcaktimi i zonave përkatëse të mbetjeve. Për të përcaktuar këto zona mbetjesh, është e rëndësishme që, së pari, të qartësojmë cili element/impiant i MMN është

- **Rajonal:** zona e mbulimit/zona e shërbimeve përfshin më shumë se një bashki
- **Lokal:** zona e mbulimit/zona e shërbimeve zakonisht përfshin vetëm një bashki ose madje vetëm pjesë të një bashkie

Elementët e mëposhtëm do të konsiderohen si "rajonale":

- Transferimi dhe transportimi në distancë të largët (me mjete të tonazhit të lartë) pas transferimit
- Trajtimi i mbetjeve të pariciklueshme (përfshirë Trajtimin Mekanik Biologjik dhe Incinerimin)
- Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime sanitare

Elementë të tjerë mund të përfshihen në sferën e veprimtarive rajonale duke u bazuar në një analizë të kushteve aktuale kuadër. Në çdo rast, mund të përfshihet edhe sektori privat për veprimtari të ndryshme.

Stacionet e Transferimit për Transportim Eficient në Distancë të Largët

Me realizimin e impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve, do të zgjaten edhe distancat e transportimit nga burimi i gjenerimit të mbetjeve në vendet e ardhshme të

trajtimin dhe depozitimin të mbetjeve. Teksa në Shqipëri praktika e zakonshme është që mbetjet e grumbulluara në një bashki depozitohen në një vend depozitim (vendgrumbullim) në afërsi, në të ardhmen, për mbetjet e grumbulluara mund të jetë e nevojshme që të transportohen në një impiant rajonal të menaxhimit të mbetjeve në një distancë prej 50 ose madje edhe 100km. Siç u përmend edhe më parë, avantazhet financiare të impianteve në shkallë të gjerë për trajtimin e mbetjeve [të gjeneruara në zona më të mëdha të mbulimit (zona e mbetjeve)] duhen të jenë të balancuara me kostot shtesë për transportimin në distancë të largët, çka zakonisht trajtohet në studimet e detajuara të konceptit dhe fizibilitetit.

Për efekt të këtij plani investimi përdoret si standard matës një distancë transportimi prej më shumë se 30 km, për të treguar nëse nevojitet një stacion transferimi. Për rrjedhojë, plani i investimit tregon se ku janë të nevojshme stacionet e transferimit dhe paraqet kostot përkatëse të investimit. Vendndodhjet e sakta të stacioneve të transferimit duhet të identifikohen gjatë planifikimit të detajuar të menaxhimit të mbetjeve (p.sh. në planet vendore të menaxhimit të mbetjeve ose në studimet e konceptit dhe fizibilitetit të projekteve për MMN) ose në planifikimin bashkiak (p.sh. në planet vendore të zhvillimit).


Zonat e Mbetjeve për Bashkëpunim Ndërbashkiak

Për të gjithë Shqipërinë përcaktohen zonat e mbetjeve, kështu që të gjitha bashkive u është caktuar një impiant i veçantë rajonal i menaxhimit të mbetjeve (ekzistues ose i planifikuar). Për të përcaktuar zonat e mbetjeve (zonat e mbulimit) janë identifikuar fillimisht impiantet moderne ekzistuese dhe të planifikuara të asgjësimit të mbetjeve përfshirë dhe zonat e tyre të mbulimit. Më pas, zonat që kanë mbetur janë ndarë në zona të mbetjeve, të cilat mund të devijojnë nga kufijtë e qarkut, dhe kjo për shkak të:

- faktorëve ekonomikë (sasive të mbetjeve dhe ekonomisë së shkallës)
- logjistikës (distancave dhe gjendjes së rrugëve, sasive të mbetjeve që janë për t'u transportuar)

Të gjitha zonat e mbetjeve, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të reja janë të paraqitura në hartën e përgjithshme më poshtë.





Harta e zonave të mbetjeve dhe impianteve rajonale të menaxhimit të mbetjeve

Funksionimi i Qëndrueshëm i Impianteve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkitë kanë përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. Ligji Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton funksionet e bashkive si edhe përshkruan mënyrat se si duhet të menaxhohen shërbimet vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet një apo më shumë instrumenteve të mëposhtëm:

- Njësive të tyre organizative
- Ndërmarrjeve të shërbimeve publike
- Lidhjen e kontratave me palë të treta
- Përdorimit të instrumenteve të duhura të partneriteteve publike dhe private

Kreu V i Ligjit Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore e përmend bashkëpunimin ndërmjet bashkive. Neni 14, paragrafi 5 përcakton:

“Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta.

Ky “Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta” për shembull, mund të ngrihet si një shoqëri aksionare (sh.a), siç është Shoqëria “Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë”. Ligji parashikon, përveç bashkive, edhe për përfshirjen e “Institucioneve të Qeverisë Qendrore”. Për menaxhimin e shërbimeve Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta mund të përfshijë edhe firma të sektorit privat ose të krijojë Partneritete Privat-Publik (PPP).

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se Ligji Nr.139/2015 parashikon kuadrin e ngritjes së sipërmarrjeve, ku përveç bashkive të zonës përkatëse të mbetjeve, mund të përfshihen edhe partnerë të tjerë, si për shembull institucione shtetërore ose kompani private. Sikurse tregon përvoja e deritanishme në Korçë, ngritja e një kompanie të tillë rajonale është mjaft sfiduese dhe kërkon kohë.


Një zgjidhje tjetër që pajtohet me parashikimet e Ligjit Nr.139/2015 do të ishte rasti kur një bashki merr përsipër përgjegjësinë për impiantet rajonale dhe lidh kontrata dypalëshe me bashkitë e tjera në zonën e mbetjeve. Pika e dobët e këtij modeli është se njëra nga bashkitë duhet të ketë dëshirën dhe të jetë e aftë që të marrë përsipër gjithë riskun e impiantit rajonal. Për rrjedhojë, ky model konsiderohet si i vlefshëm vetëm në raste të veçanta.



V Hartëzimi GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik) dhe Identifikimi i Vendndodhjeve të Impianteve Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve

Për zonat e mbetjeve janë identifikuar vendndodhje të mundshme për vend depozitime sanitare dhe impiante të tjera të trajtimit të mbetjeve, por pa rënë dakord për vendndodhjen e saktë. Hapat e ndërmarrë për të arritur në identifikimin e këtyre vendeve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Hapat për identifikimin e vendndodhjeve për Qendrat Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve



Për identifikimin e vendndodhjeve të vendeve është përgatitur një bazë të dhënash GIS që mbulon të gjithë Shqipërinë. Në paraqitjen grafike negative, sipas kërkesave e standardeve të përcaktuara në legjislacion janë hartuar kriteret për përjashtimin e zonave të papërshtatshme.

Për territoret që mbetën (jo të përjashtuara) u krye një paraqitje grafike pozitive për identifikimin e zonave të përshtatshme për ngritjen e një qendre rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Rezultati i këtij veprimi janë zonat kandidate për qendrat e ardhshme të menaxhimit të mbetjeve, si edhe aspektet që duhet të merren parasysh në hetimet e mëtejshme për përzgjedhjen përfundimtare të vendeve për një projekt të mundshëm

investimi. Këto të dhëna dhe informacioni janë gjithashtu të disponueshme si shtresë dhe bazë të dhënash GIS.

VI Planifikimi i Investimeve


Instrumenti i Planifikimit të Investimeve – për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (IPI-MIMN)

Elementi thelbësor i planifikimit të investimeve është Instrumenti i Planifikimit të Investimeve – për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta (IPI-MIMN); investimet e ardhshme në nivel rajonal dhe vendor janë marrë parasysh duke përdorur këtë instrument ndërveprues.

Fasha e planifikimit është e ndarë në tre faza: Faza 1: 2018 - 2022, Faza 2: 2023 - 2027, Faza 3: 2028 - 2032.

Tabela më poshtë ilustron skemën bazë të IPI-MIMN për Shqipërinë.

Skema bazë për Instrumentin e Planifikimit të Investimeve për MIMN



Plani i Investimeve

Tabela më poshtë paraqet një përmbledhje të impianteve të reja rajonale të planifikuara, të cilat do të zbatohen gjatë tre fazave.

Implantet Rajonale/ Zonat e Mbetjeve	ZM Berat	ZM Dibrë	ZM Fier	ZM Elbasan	ZM Korçë	ZM Kukës	ZM Shkoder- Leribe	ZM Tiranë- Durrës	ZM Vlorë Veti	ZM Vlorë Jug- Gjirokastrë	Totali
FAZA 1 (2019 - 2022)											
Transportimi në Distanca të Larget											
Stacion transformimi me rampë	400 000		600 000	800 000			800 000	1,594 000		600 000	4,794,000
Stacion transformimi me rampë me rregullime											
Trajtimi i Mbetjeve											
Impant për ndryshim të mjetëve të përziera								1,860 000	4,700 000		6,560,000
Trajtimi mekanik biologjik me TA											
Trajtimi mekanik biologjik me stabilizim											
Trajtimi mekanik biologjik me kompostim											
Trajtimi Aerobik (TA)											
Incinerimi me shtatë të lëvizshme			25,512 000					76,001 000			101,513,000
Agjensimi i Mbetjeve											
Vend depozitimi kontrolluar		1,000 000									1,000,000
Vend depozitimi i shtuar	3,673 000		3,900 000				750 000				8,323,000
Totali për Fazën 1 (2019 - 2022)	4,073,000	1,000,000	29,112,000	800,000		750,000	4,267,000	101,830,000	11,900,000	600,000	153,432,000
FAZA 2 (2023 - 2027)											
Transportimi në Distanca të Larget											
Stacion transformimi me rampë											
Stacion transformimi me rampë me rregullime											
Trajtimi i Mbetjeve											
Impant për ndryshim të mjetëve të përziera											
Trajtimi mekanik biologjik me TA						11,100 000					11,100,000
Trajtimi mekanik biologjik me stabilizim	5,067 000										5,067,000
Trajtimi mekanik biologjik me kompostim											
Trajtimi Aerobik (TA)											
Incinerimi me shtatë të lëvizshme											
Agjensimi i Mbetjeve											
Vend depozitimi kontrolluar											
Vend depozitimi i shtuar			4,567 000	4,342 000	3,377 000		5,479 000			2,522 000	20,287,000
Totali për Fazën 2 (2023 - 2027)	5,067,000		4,567,000	4,342,000	14,477,000		20,327,000		7,373,000	2,522,000	84,315,000
FAZA 3 (2028 - 2032)											
Transportimi në Distanca të Larget											
Stacion transformimi me rampë											
Stacion transformimi me rampë me rregullime											
Trajtimi i Mbetjeve											
Impant për ndryshim të mjetëve të përziera											
Trajtimi mekanik biologjik me TA											
Trajtimi mekanik biologjik me stabilizim											
Trajtimi mekanik biologjik me kompostim											
Trajtimi Aerobik (TA)											
Incinerimi me shtatë të lëvizshme											
Agjensimi i Mbetjeve											
Vend depozitimi kontrolluar		421 000					238 000				659,000
Vend depozitimi i shtuar	7,131 000		4,368 000	4,732 000	3,577 000		5,873 000		3,458 000	2,747 000	27,484,000
Totali për Fazën 3 (2028 - 2032)	7,131,000	421,000	4,968,000	4,732,000	3,577,000		5,873,000		3,458,000	2,747,000	28,193,000

Përmbledhje e kostove të përlogaritura të investimit për impiantet e reja rajonale për zonën e mbetjeve sipas fazave të planifikimit [Euro]

Në tabelën tjetër jepen kostot e përlogaritura të investimit (për investimet vendore dhe rajonale) për secilën zonë mbetjeje dhe për nismën në nivel kombëtar për zbutjen e rrezikut të vendgrumbullimeve të mbetjeve.



Përmbledhje e kostove të përlogaritura të investimit për zonë mbetjeje sipas fazave të planifikimit [EURO]

Zona e Mbetjeve (ZM)	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Total
ZM Berat	5,817,000	7,455,000	6,696,000	19,968,000
<i>Kostot e investimit rajonal</i>	<i>4,073,000</i>	<i>5,067,000</i>	<i>2,131,000</i>	<i>11,271,000</i>
<i>Kostot e investimit vendor</i>	<i>1,744,000</i>	<i>2,388,000</i>	<i>4,565,000</i>	<i>8,697,000</i>
ZM Dibër	1,773,000	3,012,000	1,910,000	6,695,000
<i>Kostot e investimit rajonal</i>	<i>1,000,000</i>		<i>421,000</i>	<i>1,421,000</i>
<i>Kostot e investimit vendor</i>	<i>773,000</i>	<i>3,012,000</i>	<i>1,489,000</i>	<i>5,274,000</i>
ZM Fier	32,103,000	8,696,000	14,988,000	55,787,000
<i>Kostot e investimit rajonal</i>	<i>29,112,000</i>	<i>4,567,000</i>	<i>4,968,000</i>	<i>38,647,000</i>
<i>Kostot e investimit vendor</i>	<i>2,991,000</i>	<i>4,129,000</i>	<i>10,020,000</i>	<i>17,140,000</i>
ZM Elbasan	3,587,000	6,698,000	10,730,000	21,015,000
<i>Kostot e investimit rajonal</i>	<i>800,000</i>	<i>4,342,000</i>	<i>4,732,000</i>	<i>9,874,000</i>
<i>Kostot e investimit vendor</i>	<i>2,787,000</i>	<i>2,356,000</i>	<i>5,998,000</i>	<i>11,141,000</i>
ZM Korçë	4,923,000	20,500,000	6,870,000	32,293,000
<i>Kostot e investimit rajonal</i>		<i>14,477,000</i>	<i>3,577,000</i>	<i>18,054,000</i>
